



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



RAPORTI VJETOR I REZULTATEVE TË OKB-SË NË MAQEDONINË E VERIUT NË VITIN

2023

MARS 2024



United
Nations





UNITED NATIONS NORTH MACEDONIA



FALËNDERIM

Ky dokument është prodhuar nga Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara (ZKP) në Maqedoninë e Veriut në emër të Ekipit të vendit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut. ZKP dëshiron të falënderojë të gjitha palët e interesuara për kontributin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti

Versioni i fundit i këtij dokumenti është i disponueshëm në faqen e internetit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në northmacedonia.un.org.

Për informata shtesë, ju lutemi kontaktoni: **UN RCO North Macedonia** rc-northmacedonia@un.org

Foto e kopertinës: Vizatimi fitues i Garës së Vizatimit për Fëmijë që u organizua në prag të Ditës së OKB-së 2023, si pjesë e fushatës për të Drejtat e Njeriut (HR75). ©ZKP OKB

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të cilitdo vendi, territori, qyteti ose zone ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e vijave kufitare ose kufijve të tij.

Të dhënat financiare janë të përkohshme dhe mund të ndryshojnë sipas certifikimit financiar.

Përmbajtja

PARATHËNIE	4
EKIPI I VENDIT I KOMBEVE TË BASHKUARA NË VITIN 2023.....	5
PARTNERËT KRYESORË TË OKB-SË PËR ZHVILLIM.....	6
ZHVILLIMET KRYESORE NË VEND DHE RAJON NË VITIN 2023.....	7
MBËSHTETJA E SISTEMIT PËR ZHVILLIM TË OKB-SË PËR PRIORITETET E ZHVILLIMIT KOMBËTAR	8
REZULTATET PËR VITIN 2023*	10
REZULTATI 1: PROSPERITETI GJITHËPËRFSHIRËS	10
REZULTATI 2: SHËRBIME CILËSORE PËR TË GJITHË.....	13
REZULTATI 3: MJEDISI JETËSOR I SHËNDETSHËM	18
REZULTATI 4: QEVERISJA E MIRË	22
FINANCIMI I QZHQ-VE DHE PARTNERITETI.....	25
KOHERENCA, EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I OKB-SË.....	26
VLERËSIMI DHE MËSIMET E NXJERRA	28
FINANCIMI DHE MOBILIZIMI I BURIMEVE.....	29
OKB-JA NË MAQEDONINË VERIORE NË VITIN 2024.....	31
SHTOJCAT	32

** Për një prezantim të bazuar në storje të rezultateve të detajuara të vitit 2023 për çdo agjenci të OKB-së, ju lutemi shihni Shtojcën e raportit*



Foreword



Bashkërisht do t'i përkushtohemi kërkimit të zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe partneritetet e bazuara në besimin e ndërsjellë dhe dobisë së plotë për të gjithë, në frymën e solidaritetit global, për të ardhmen e përbashkët të brezave të tanishëm dhe të ardhshëm."

Deklarata Politike e Samitit të QZHQ 2023



Gjatë vitit 2023, Kombet e Bashkuara (OKB) dhe Maqedonia e Veriut vazhduan ndërtimin e bashkëpunimit dhe partneritetit tashmë të fortë, përkundër rrethanave të vështira të shkaktuara nga kriza e vazhdueshme e energjisë dhe çmimeve, që u përkeqësuan edhe më tej si rezultat i luftës kundër Ukrainës me efekt të dëmshëm në standardin e jetesës së njerëzve.

Partneriteti në rritje të vazhdueshme vjen kryesisht si rezultat i përkushtimit të vendosur të vendit për zhvillim të qëndrueshëm dhe multilateralizëm, të demonstruar përmes kryesimit të suksesshëm të OSBE-së nën moton "Për njerëzit bëhet fjalë" dhe angazhimeve të vendit për Agjendën 2030 të shtjelluara në Samitin e QZHQ 2023.

Në vitin 2023, vendi përfundoi me sukses procesin e shqyrtimit të anëtarësimit në BE duke marrë të dhëna dhe këshilla të vlefshme për reformat që mbeten për t'u realizuar për t'u bërë një shoqëri plotësisht funksionale që i mbështet standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Më shumë se 5.000 qytetarë, nga të cilët 1,000 të rinj dhe mbi

200 ekspertë kombëtarë, me ndihmën e OKB-së, kontribuan në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit njëzetvjeçare, duke përcaktuar vizionin e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit që përfshin prioritetet e anëtarësimit në BE.

Korniza e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025 (KBZHQ), si dokument kryesor strategjik për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut, është e lidhur fort me këto prioritetet. Kjo sigurohet nëpërmjet një procesi planifikimi dhe rishikimi të ndërmarrë së bashku me palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare, nën drejtimin strategjik të Komitetit të Përbashkët Drejtues, me përkushtim të fortë ndaj hapjes dhe transparencës.

Zbatimi i Planeve të Përbashkëta të Punës për vitin 2023 kontribuoi në shumë arritje të rëndësishme për vendin, duke përfshirë krijimin e vendeve cilësore të punës dhe aftësive, në zhvillim më të fuqishëm bujqësor dhe rural, në shërbime sociale moderne që e rrisin përfshirjen e grupeve të cenueshme, në monitorim dhe menaxhim më të mirë të ndryshimeve klimatike, mjedisit jetësor dhe burimeve natyrore.

Rosana Duxhak

Koordinatorë e Përhershme e OKB-së në Maqedoninë e Veriut



Gjithashtu rezultoi me intensifikimin e bashkëpunimit me mekanizmat ndërkombëtarë dhe evropianë të të drejtave të njeriut, si dhe me kapacitete të zgjeruara të institucioneve shtetërore dhe të komunave për një hartim dhe zbatim konsultativ të politikave të përgjegjshme gjinore, të bazuara në të drejtat e njeriut.

Në vitin 2023, së bashku me partnerët tanë, shënuam 75-vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Konsultimet e gjera dhe dialogjet, duke përfshirë Qeverinë, Parlamentin, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqërinë civile, trajtuan sfidat kryesore për të drejtat e njeriut dhe veprimet që duhen ndërmarrë. Ky proces gjithëpërfshirës dhe idetë kyçe që dolën prej tij rezultuan në premtime të reja të forta për të drejtat e njeriut nga qeveria dhe nga aktorë të tjerë kombëtarë. Ai gjithashtu siguroi përgatitje solide për Rishikimin e 4-të Periodik Universal të vendit nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në vitin 2024. Për më tepër, Maqedonia e Veriut tani është afër arritjes së çrrënjësjes së plotë të problemit të njerëzve pa shtetësi.

Ky raport i përmbledh rezultatet tona kryesore gjatë gjithë vitit, të arritura së bashku me partnerët tanë kombëtarë, me mbështetjen e fortë financiare dhe politike nga donatorët tanë, globalisht dhe në vend. Ai gjithashtu vë në dukje përpjekjet tona të përbashkëta për të lehtësuar efektet e krizës, veçanërisht për ata që janë më të prekur.

Në këto tre vite, që kur filloi zbatimi i KBZHQ-së, ne kemi punuar brenda një konteksti të tendosur ekonomik, me kriza të njëpasnjëshme dhe të ndërlydhura që ndikuan në punën tonë zhvillimore. Por, ky raport, sikurse edhe ata të mëparshmit, do të demonstrojë se ne ishim në gjendje të mësojmë dhe të përshtatemi për të mbetur relevant dhe të dobishëm, duke u qëndruar besnikë vlerave dhe parimeve të OKB-së dhe angazhimit tonë të fortë për të mos lënë askënd pas.

Qëllimi ynë kryesor është të krijojmë një botë të denjë për të gjithë ne dhe për të gjithë brezat e ardhshëm.

Bujar Osmani

Ministër i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut

Ekipi i vendit i OKB-së



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



Raporti Vjetor i Rezultateve për vitin 2023

21

agjenci të OKB-së janë përfshirë në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut

Kombet e Bashkuara në Maqedoninë e Veriut i realizojnë aktivitetet e tyre në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit, angazhimet për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, agjendën e anëtarësimit në BE dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) të Agjendës 2030.

OKB-ja ka punuar për të arritur prioritetet e përcaktuara në Kornizën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së 2021-2025, të krijuar së bashku me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, përmes ofrimit të asistencës teknike, zhvillimit të kapaciteteve, shkëmbimit të njohurive dhe programeve inovative pilot.

Gjithsej 21 agjenci të Kombeve të Bashkuara u përfshinë në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut, duke punuar së bashku me Ekipin e Kombeve të Bashkuara për Vendin (UNCT) dhe nën udhëheqjen e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së (KP), përfaqësuesit të caktuar të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për operacionet e zhvillimit në vend. 16 nga këto agjenci kishin prezencë fizike në Maqedoninë e Veriut, ndërsa pesë prej tyre aktivitetet i realizuan nga distanca. Ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023 përfshinte personel dhe staf mbështetës prej më shumë se 283 personash, të vendosur në vend, si dhe ekspertë nga e gjithë bota.

FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit *
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Prezikut nga Fatkeqësitë *
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore *
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara *
UNEP	Programi për Mjedisin Jetësor i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara *
UNFPA	Fondi për Popullsinë i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
UNIDO	Organizata për Zhvillimin Industrial e Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra për Drogën dhe Krimin e Kombeve të Bashkuara
UNOPS	Zyra për Shërbime të Projekteve e Kombeve të Bashkuara
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara *
ZKP e OKB-së	Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara
UN Women	Agjencia për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave e Kombeve të Bashkuara
WB	Grupi i Bankës Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

* nuk ka pranë fizike, nuk është nënshkruese e KBZHQ-së




Partnerët kryesorë të OKB-së për zhvillim

Gjatë vitit 2023, OKB-ja vazhdoi të punojë ngushtë me mbi 260 partnerë – qeverinë kombëtare dhe autoritetet lokale, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, sektorin privat, komunitetin akademik dhe të gjithë aktorët e tjerë – për të siguruar rëndësinë dhe ndikimin e veprimit të saj për njerëzit në

Maqedoninë e Veriut. Një listë e detajuar e palëve të interesuara me të cilat OKB-ja ka zhvilluar partneritetet në vitin 2023 është dhënë në aneks.

Partnerët që dhanë kontribute bujare në aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në 2023*

Të dhënat e datës 9 mars 2024, bazuar në shpenzimet efektive në vitin 2023, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2023, në miliona \$



* Public contributors to pooled, vertical and thematic funds that supported UN activities in North Macedonia in 2021, indicated in alphabetical order.

Zhvillimet kryesore në vend dhe konteksti rajonal

Polarizimi politik mbi agjendën legjislativë, besimi i ulët në institucione dhe kriza e vazhdueshme ekonomike që ndikoi fuqishëm në standardin e jetesës mbetën ndër karakteristikat kryesore që e shënuan vitin e kaluar.

Megjithëse shqyrtimi nga BE-ja i të gjitha grupeve u finalizua në fillim të dhjetorit, fillimi i negociatave të anëtarësimit mbetet i kushtëzuar nga përmbushja e parakushteve të vendosura në Kornizën Negociatore, gjegjësisht ndryshimet e kërkuara të Kushtetutës. Kjo i thelloi ndarjet politike dhe shoqërore dhe vazhdoi të zvogëlojë mbështetjen për anëtarësimin në BE.

Cilësia e procesit legjislativ u përkeqësua më tej për shkak të përdorimit në rritje të procedurave të shkurtuara në Kuvend, veçanërisht për të kapërcyer bllokadat e shpeshta nga opozita. Megjithatë, në disa raste, si për shembull për ndryshimet në Kodin Penal, shkurtimi i procedurës u konsiderua shumë i diskutueshëm. Besimi i njerëzve në sistemin e qeverisjes dhe sundimin e ligjit vazhdoi të gërryhej për shkak të korrupsionit të përhapur dhe llogaridhënies së pamjaftueshme.

Finalizimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe e miratuar me konsensus është një moment i rëndësishëm që do të sigurojë një kornizë vizionare afatgjatë, duke unifikuar prioritetet e anëtarësimit në BE dhe QZHQ-të. Ky proces gjerësisht gjithëpërfshirës është gjithashtu një nga shembujt e rrallë të përfshirjes dhe pjesëmarrjes së më shumë partive.

Kryesia e OSBE-së e Maqedonisë së Veriut zbatoi nisma shumëpalëshe dhe rajonale drejt rindërtimit të dialogut dhe sigurisë në rajonin e OSBE-së. Vendi mbajti marrëdhënie konstruktive me vendet e tjera që synojnë t'i bashkohen BE-së dhe me mori pjesë në nisma të tjera, duke përfshirë Dialogun e Forumit të Prespës në nivel të lartë, nismën e Ballkanit të Hapur, procesin Bërdo-Brioni dhe procesin e Berlinit.


U intensifikua bashkëpunimi me mekanizmat ndërkombëtarë dhe evropianë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me Raportuesin Special të OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër terrorizmit. Konsultimet e gjera me Qeverinë, Parlamentin, Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) dhe OSHC-të me rastin e Rishikimit të katërt Universal Periodik nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ishin një hap pozitiv përpara. Organet monitoruese të Këshillit të Evropës, GREVIO dhe GRETA, kanë publikuar raporte vlerësimi për dhunën me bazë gjinore dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Integrimi i rekomandimeve mbetet sfidues. Në aspektin pozitiv, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje është funksionalizuar me aktet e nevojshme nënligjore në vitin 2023.

Rimëkëmbja ekonomike u dëmtua nga rritja e çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve, të cilat u intensifikuan për shkak të luftës në Ukrainë, duke prekur në mënyrë disproporcionale familjet më të varfra. Rritja e vitit 2023 mbetet e përmbajtur, me ç'rast IFN-të parashikojnë që ajo të jetë 1,8% dhe 2,3%, ndërsa rritja në vitin 2024 pritet të jetë pak më e lartë, varësisht nga intensifikimi i investimeve kapitale.

Përkundër masave të Qeverisë, çmimet erritura mbeten problem akut për ekonominë e Maqedonisë së Veriut dhe standardin e jetesës. Politika monetare vazhdoi me shtyrësimin, duke pasur nevojë për konsolidim fiskal më ambicioz dhe politika fiskale të kujdesshme, por kjo është e pasigurt duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme. Janë ndërmarrë reforma të mëdha në fushën e buxhetit dhe politikës tatimore. Megjithatë, të drejtat e punëtorëve pak u përkeqësuan për shkak të disa ndryshimeve të fundit rregullatore.

Pavarësisht përmirësimit të lehtë të të dhënave për tregun e punës, në bazë të analizave të fundit demografike gërryerja e kapitalit njerëzor mbetet ndër sfidat kryesore. Përveç rritjes së rregullt të pensioneve, Garancisë për të Rinjtë dhe paketës së re në vlerë prej 662 milionë eurosh me 26 masa kundër krizës të zbatuara në fund të vitit 2023, gjatë vitit nuk ka pasur ndryshime të mëdha në mbrojtjen sociale. Sistemi shëndetësor vazhdoi të kishte vështirësi me mungesën e burimeve dhe stafit mjekësor, ndërsa besimi i qytetarëve në shëndetin (publik) u dëmtua seriozisht për shkak të akuzave serioze të hetuara nga prokurori publik, gjë që shkaktoi edhe protesta sociale. Nga ana pozitive, u përmirësua qasja në shërbimet gjinekologjike në zonat me shërbime të pamjaftueshme me buxhet të trefishuar në vitin 2023, së bashku me një rritje të butë të përqindjeve kombëtare (2022) për vaksinat e rregullta të fëmijërisë (ndonëse ende nën objektivat për imunitetin e tufës). Ka pasur disa përparime në arsim, kryesisht në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët tani ndjekin shkollat e rregullta fillore, si dhe me rritjen e rrogave dhe kapaciteteve të punonjësve të arsimit. Megjithatë, rezultatet e fundit të PISA-s treguan rezultate të përkeqësura në mënyrë alarmante. Komunitatet vazhdojnë të preken fuqishëm nga rritja masive e shpenzimeve për energji elektrike dhe

Indeksi i Çmimeve të Konsumit i Maqedonisë së Veriut



Përqindja tremujore e rritjes së PBB-së për vitin 2023



Source: SSO, 2023

ngrohje dhe nga zvogëlimi i numrit të popullsisë. Kjo ka çuar në një ngadalësim të investimeve lokale dhe riorganizim të këshillave komunalë.

Në fushën e ndryshimeve klimatike, mjedisit jetësor dhe burimeve natyrore, ndryshimet pozitive në tranzicionin drejt energjisë së gjelbër kanë filluar të jenë të dukshme përmes investimeve në burimet e rinovueshme të cilat kanë ulur gjithashtu varësinë nga energjia. Po ashtu, është paralajmëruar mbështetje e mëtejshme nga BE-ja. Qeveria miratoi Udhërrëfyesin për Tranzicion të Drejtë dhe nënshkroi partneritet me institucionet financiare ndërkombëtare në CoP28 në Dubai për një zbatim ambicioz të Kontributeve të Përcaktuara Kombëtare. Edhe pse ndotja e ajrit është ulur deri diku, niveli i PM 10 dhe PM 2,5 gjatë dimrit mbetet shumë i lartë në zonat urbane, kryesisht për shkak të burimeve të papërshtatshme të ngrohjes, transportit dhe industrisë. Pavarësisht harmonizimit legjislativ në fushën e menaxhimit të mbeturinave, zbatimi mbetet një sfidë serioze për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare dhe ndërgjegjësimit të dobët të publikut. Megjithatë zonat e


mbrojtura zyrtare u rritën ndjeshëm, menaxhimi efektiv dhe mbrojtja e tyre është e kufizuar. Gjithashtu, nevojitet fokus i mëtejshëm për mbrojtjen e liqeneve dhe lumenjve kryesorë. Vendi po përballlet me rritje të shfaqjes së zjarreve, megjithatë kapaciteti për t'iu përgjigjur zjarreve dhe për të menaxhuar rreziqet nga vërshimet po përmirësohet vazhdimisht.

Vazhdojnë lëvizjet e përziera të migracionit në kufijtë e Maqedonisë së Veriut me 14,000 ardhje të parregullta të regjistruara deri në fund të vitit 2023, që paraqet një rënie të konsiderueshme nga 27,000 ardhjet e parregullta në vitin e kaluar. Më shumë se 74,000 refugjatët ukrainas kanë hyrë në vend që nga shkurti i vitit 2022, nga të cilët 405 kanë marrë qëndrim të përkohshëm për arsye humanitare. Vendi bëri përpjekje vendimtare për të zhdukur problemin e njerëzve pa shtetësi duke i dhënë çdo fëmijë të lindur në vend të drejtën e regjistrimit të menjëhershëm në librin amë të të lindurve, pavarësisht nga shtetësia e prindërve apo statusi personal i tyre. Si rezultat i kësaj, 511 persona pa shtetësi morën letërnjoftimet e tyre të para. Për 275 personat e mbetur procedura është në zhvillim e sipër.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ) 2023

Human Development Index (HDI)										Change in HDI rank	Average annual HDI growth			
HDI rank	Country	Value								2015 - 2021	1990 - 2000	2000 - 2010	2010 - 2021	1990 - 2021
		1990	2000	2010	2015	2018	2019	2020	2021					
78	North Macedonia	--	0,675	0,738	0,762	0,779	0,784	0,774	0,770	5	--	0,90	0,39	--

Mbështetja e OKB-së për prioritetet e zhvillimit kombëtar përmes KBZHQ-së



Kjo pjesë e thekson kontributin dhe rezultatet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023 dhe rezultatet nga puna me partnerët në katër fusha – prosperiteti gjithëpërfshirës, shërbimet cilësore për të gjithë, mjedisi i jetësor të shëndetshëm dhe qeverisja e mirë.

Në kuadër të KBZhQ-së për periudhën 2021-2025, OKB-ja dhe partnerët trajtojnë tre prioritete strategjike kombëtare dhe dëshirojnë të kontribuojnë në katër rezultatet e synuara.

Duke u mbështetur në traditën e fortë të punës së OKB-së në Maqedoninë e Veriut, KBZhQ-ja mbështet kalimin nga zbatimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve drejt një mbështetjeje më të synuar të OKB-së, si një organizatë që mundëson dhe ofron këshilla paraprake për sa i përket politikave, inovacionit dhe ekspertizës.

Veprimi i OKB-së është i bazuar fuqishëm në të drejtat e njeriut, duke i dhënë përparësi grupeve më të cenueshme. Veprimi i OKB-së gjithashtu bazohet në dëshmi, gjë që kërkon kapacitete të përforcuara statistikore, mbledhje më të mirë të të dhënave të ndara dhe përmirësim të koordinimit dhe ndarjes së informacionit në të gjitha nivelet. Të gjitha aktivitetet kryhen së bashku me autoritetet kombëtare dhe lokale, shoqërinë civile, sektorin privat, partnerët ndërkombëtarë dhe palët e tjera të interesuara.

Në të katër rezultatet, programet janë të lidhura fort me gjashtë tranzicionet kryesore, dhe ato mund të kenë efekt

katalitik dhe shumëfishues në të gjithë QZHQ-të: (1) sistemet ushqimore; (2) qasja në energji dhe përbalueshmëria; (3) lidhja digjitale; (4) arsimi; (5) vendet e punës dhe mbrojtja sociale; dhe (6) ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit dhe ndotja. Veprimet kolektive të OKB-së në nivel të vendit racionalizohen në kuadër të Planeve të Përbashkëta të Punës, veçanërisht nëpërmjet ndërhyrjeve të bazuara në të dhëna që i mbështesin politikat dhe kornizat rregullatore; identifikohen projektet kombëtare që janë të realizueshme financiarisht dhe tërheqëse për tregun dhe zhvillohet një portfol i tyre; promovohen dhe mundësohen qasje inovative dhe më gjithëpërfshirëse për financimin e zhvillimit dhe ngrihen kapacitetet në nivelin e nevojshëm për të ndihmuar të gjitha palët e interesuara për t'i zbatuar këto tranzicione dhe për t'i bërë ato të qëndrueshme.

Reporti Vjetor i Rezultateve për vitin 2023

2023 Global Sustainable Development Report, offers Member States an analysis and recommendations to “unlock the rapid and deep transitions needed to deliver the Goals by 2030”



Gjashtë tranzicione që mund të kenë efekte katalitike dhe shumëfishuese në të gjithë QZHQ-të

Rezultatet e vitit 2023

REZULTATI 1

Prosperiteti gjithëpërfshirës



Deri në vitin 2025, standardi i jetesës së të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut është përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimit produktiv, të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ

Kontribuon në



- Rritje e përpjekjeve dhe e qëndrueshme ekonomike me një standard më të mirë jetese
- Zhvillimi i bujqësisë
- Përfshirja sociale (kujdesi për të gjitha kategoritë e cënueshme) dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor.
- Administratë moderne, shërbime të digitalizuara



- Themelet në rend të parë: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria
- Grupi 1: Aspektet themelore: (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 23, 24)
 - Grupi 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 10, 19, 20, 26)
 - Grupi 4: Agjencia e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 27)
 - Grupi 5: Burimet, bujqësia dhe kohezioni (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 11, 12)

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2023

\$6,027,282

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Ekonomisë; Ministria e Kulturës; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike; Ministria e Transportit dhe Lidhjeve; Agjencia e Punësimit; Agjencia për Kadastër të Patundshmëri; Agjencia për Rini dhe Sport; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik; Agjencia Kombëtare për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë; Inspektorati Shtetëror i Punës; Enti Shtetëror i Statistikave; Organizatat e punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut; Federata Kombëtare e Fermerëve; Rrjeti i Zhvillimit Rural; Sindikatat; Këshilli Ekonomik dhe Social i Maqedonisë së Veriut; Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit; Komunitat e Gostivarit, Prilepit, Shtipit dhe Shuto Orizant



2,420 individuals were capacitated in entrepreneurial and business skills through the Self-employment program.
Photo credit UNDP

Në vitin 2023, OKB-ja kontribuoi për arritjen e rezultateve të rëndësishme në fushën e Prosperitetit Gjithëpërfshirës, siç është reduktimi i ekonomisë informale. Fatkeqësisht, inflacioni që po zgjat dhe prodhimi ekonomik i ulët e përkeqësuan edhe më tej standardin e jetesës së njerëzve, pavarësisht masave kundër krizës të ndërmarra nga qeveria.

Në këtë fushë, OKB-ja mbështeti autoritetet për të krijuar ndërmarrje të qëndrueshme si gjeneruese të punësimit. Gjithsej

946 NVM u krijuan ose përfituan nga mbështetja dhe programet e mentorimit përmes platformës online: www.bizz4all.mk duke u fokusuar në digitalizimin, marketingun digjital, menaxhimin e shitjeve në internet, hyrjet e reja në treg dhe transformimin e gjelbër për t'iu përshtatur kërkesave të tregut në zhvillim. Për më tepër, 2.420 individë u aftësuan në aftësitë sipërmarrëse dhe afariste përmes programit për Vetëpunësim. Prej tyre, 19 persona me aftësi të kufizuara me sukses filluan biznesin e tyre. Përmes qasjes inovative, 115 NVM morën bashkëfinancim

për investime të gjelbra në energji efikase dhe burime të rinovueshme të energjisë, duke punësuar 186 persona të cilët u trajnuan për të përdorur teknologjitë më të fundit. Në total, masat aktive të tregut të punës, të mbështetura nga OKB-ja, çuan në krijimin e 645 vendeve të punës me orar të plotë dhe 497 me orar të pjesshëm, veçanërisht nëpër NVM dhe OJQ në 50 komuna. Gjithashtu, 223 persona morën një shumë të caktuar kompensimi gjatë trajnimeve, me ç'rast gjithsej 1.365 persona përfituan nga mbështetja financiare gjë që që u ndihmoi atyre të dalin nga varfëria shumëdimensionale.

Partnerët socialë, si Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë (OPM) dhe Konfederata e Biznesit të Maqedonisë (KBM) u aftësuan nga OKB-ja për të aplikuar metodologji pjesëmarrëse dhe të bazuara në të dhëna në vlerësimin e mjedisit të biznesit. KBM-ja u fokusua në digjitalizimin, për të promovuar dhe për të avokuar për një mjedis biznesi më të favorshëm që e mbështet transformimin digjital të kompanive. OPM-ja përdori një qasje metodologjike të përshtatur për vlerësimin e ndikimeve të krizës energjetike mbi kompanitë, për të avokuar për masa shpesh zbutëse, duke përfshirë subvencionet për energji.

2,324

Romë përfituan nga shërbimet aktive për punësim

Tre institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile u mbështetën për të fituar qasje në burimet financiare për sektorin kulturor dhe kreativ nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, e cila u përdor për të nxitur politika efektive kulturore, për të forcuar bashkëpunimin kulturor rajonal, për të promovuar lëvizshmërinë dhe qarkullimin e artistëve dhe mallrave kreative dhe për të mbrojtur trashëgiminë kulturore.

OKB-ja investoi përpjekje të konsiderueshme për të mos lënë askënd pas duke lehtësuar vende të punës për gratë dhe njerëzit e cenueshëm. Gjithsej 2.324 romë përfituan nga shërbimet aktive për punësim, ku mentorët romë luajtën një rol vendimtar. Si rezultat i kësaj, u punësuan 353 romë (327 me orar të plotë; 26 me orar të pjesshëm) dhe 384 romë të kthyer morën dokumente identifikimi që u mundësoi atyre të regjistronin fëmijët në shkollë dhe të kenë qasje në sistemin e mbrojtjes sociale, ndërsa 57 të kthyer filluan të zyrtarizojnë arsimin e tyre fillor dhe 37 përfundimisht siguruan punësim formal.

Në sektorin e ekonomisë së kujdesit, 639 të papunë (85% gra) e rritën aftësinë e tyre për punësim duke fituar aftësi dhe përvojë pune në ofrimin e shërbimeve të ndryshme të kujdesit në shtëpi për mbi 9.517 persona (5.131 gra dhe 432 persona me aftësi të kufizuara) në 50 komuna. Si rezultat i kësaj, 514 gra përfituan nga njohja e punës së papaguar dhe u punësuan (89 me orar të plotë dhe 425 me orar të pjesshëm). Për të krijuar një mjedis të favorshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit, OKB-ja gjithashtu asistoi Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për të krijuar protokolle, standarde dhe udhëzime për ofrimin e shërbimeve, ndërsa 23 OJQ u ndihmuan për t'u bërë ofrues të licencuar të shërbimeve të kujdesit.

OKB-ja punoi gjithashtu në iniciativa për të forcuar gratë dhe personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë mbështetjen e vajzave në STEM dhe fuqizimin e studenteve në inovacion dhe teknologji. Përmes partneritetit publiko-privat në Komunën e Gostivarit u krijua një qendër shumëfunktionale, e cila ofron Arsim dhe Formim Profesional (AFP) për të përmirësuar jetesën e të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara. Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara u sensibilizuan për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) për të ngritur zërin e tyre dhe t'i rritur mundësitë e tyre në shoqëri. Mjetet ndihmëse (KIKO dhe HANA të zhvilluara në IOS për sintezën e të folurit) u vunë në dispozicion për rreth 5.000 persona me dëmtime të shikimit dhe aftësi të kufizuara, ndërkohë që për

herë të parë u zhvilluan politika gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara në Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Rimëkëmbjen, ndërsa institucionet publike u aftësuan në mënyrë adekuate për t'i zbatuar ato. Në panairin "Sporti për të gjithë" u organizua një debat publik i nivelit të lartë, ku u shfaqën aktivitete të ndryshme sportive gjithëpërfshirëse, adaptive dhe konvencionale që do të rrisnin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sport.

8,038 persona

u punësuan nëpërmjet Garancisë për të Rinjtë

Për të rritur aftësinë për punësim të të rinjve, OKB-ja mundësoi mësim të ndërsjellë dhe bashkëpunim trekëndor midis ministrive të linjës, shërbimeve publike të punësimit dhe aktorëve të tjerë relevantë nga rajoni dhe BE-ja, duke u ndihmuar autoritetet të miratojnë një Plan të ri Zbatimi të Garancisë për të Rinjtë (2023-2026), që është në përputhje me Rekomandimin e Këshillit të BE-së. Ky plan prezanton gjithashtu një aplikim inovativ të një modeli statistikor të profilizimit për segmentimin e klientëve në Agjencinë e Punësimit (AP). Si rezultat i këtyre aktiviteteve, në vitin 2023 u regjistruan gjithsej 23.619 persona (11.675 gra) të rinj për Garancinë për të Rinjtë, nga të cilët 8.038 (4.109 gra) u punësuan. Prej tyre, 2.786 (1.616 gra, 190 romë dhe 186 persona me aftësi të kufizuara) u regjistruan për Garancinë për të Rinjtë me mbështetjen e OKB-së përmes OJQ-ve rinore ombrellë të angazhuara për të lehtësuar kontaktin dhe aktivizimin e tyre. Pothuajse 200 persona, nga të cilët të paktën 20 gra dhe mbi 70 të rinj fituan aftësitë që kërkohen në tregun e punës, të tilla si aftësi digjitale, aftësi profesionale të sektorit të tekstilit, aftësi për teknologjinë e Modelimit Informatik të Ndërtesave (BIM), duke përfshirë 15 kurse të hartuara me përpikëri, të përshtatura për t'i plotësuar nevojat si të nxënësve të shkollave të mesme ashtu edhe të universiteteve, të ofruara nga Qendra iCan.

Për të lehtësuar mundësitë për migrim për motive punësimi, autoritetet shfrytëzuan hulumtimin e përbashkët të OKB-së dhe OSBE-së, i cili synon të kuptojë faktorët kompleksë që i formojnë qëndrimet e njerëzve ndaj migrimit dhe emigrantëve, duke i shfrytëzuar mësimet e nxjerra nga iniciativat e komunikimit.

OKB-ja punoi gjithashtu në përmirësimin e politikave dhe mjedisit rregullator dhe në aftësimin e institucioneve. Nisur nga kjo, vendi vazhdoi një proces tërësisht gjithëpërfshirës dhe konsultativ të hartimit të Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Punës, me synimin për harmonizimin e plotë me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së të punës. Pas 15 vitesh, u nënshkrua Marrëveshja e parë e Përgjithshme Kolektive për Sektorin Publik. Një mjet i zhvilluar nga OKB-ja u përdor për vetë-vlerësimin e mekanizmave për zgjidhjen e kontesteve të punës, në bazë të të cilit u zhvillua Plani i Veprimit 2023-2025 për përmirësimin e procesit të zgjidhjes miqësore të kontesteve.

Në vitin 2023, OKB-ja vazhdoi të punojë për reduktimin e informaliteteve dhe forcimin e cilësisë së punës. Më 14 qershor 2023, pas rekomandimit të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe Qeverisë, që u ndihmua nga OKB-ja, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ratifikoi Konventën nr. 190 të ONP-së për Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës. Gjithashtu, një inspektor i lartë i cili mori pjesë në Akademinë e Inspektorit të Punës të OKB-së ua shpërndaun njohuritë e tij 25 inspektorëve të punës nga Inspektorati i Punës.

Fokusi u vendos edhe në futjen e masave të reja për fuqizimin e grave, digjitalizimin dhe tranzicionin e gjelbër të NVM-ve. Për shembull, një risi u prezantua në Planin Operativ të Punësimit 2023, i cili tani përfshin një "masë të gjelbër", me metrikë që e gjurmon reduktimin e emetimeve të gazrave serrë në kompanitë e përfshira me këtë masë. OKB-ja gjithashtu ofroi një grup gjithëpërfshirës të rekomandimeve për politikatat dhe planet

praktike për tranzicion të drejtë për Pellagoninë, e cila është e varur nga thëngjilli.

Në bazë të një analize të hollësishme të bazuar në prova, u zhvillua një kornizë gjithëpërfshirëse për formulimin e Strategjisë së parë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore dhe të Ushqyerjes së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë përcaktimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial të koordinimit të sigurisë ushqimore, të udhëhequr nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Gjithashtu, u krye një analizë dhe u ofrua mbështetje për çështjet që lidhen me tokën e braktisur bujqësore, e cila përbën rreth 32 për qind të tokës bujqësore të punëshme në vend, për të kontribuar për ndryshimet në Ligjin për Tokën Bujqësore, Ligjin për Privatizimin e Tokës në Pronësi Shtetërore dhe ligjet e tjera të ngjashme.

Në kontekstin e rritjeve të vazhdueshme të çmimeve të ushqimeve, për të kontribuar në vendimmarrje, OKB-ja ofroi analiza dhe masa në adresimin e sfidave të pasigurisë ushqimore, veçanërisht të lidhura me qasjen dhe përballueshmërinë e ushqimit. Në përgjigje të sfidave të shumëanshme të paraqitura nga COVID-19 dhe goditjeve të tjera të mundshme, u forcuan kapacitetet në sistemet e informacionit mbi çmimet dhe tregun dhe monitorimin e politikave për mallrat ushqimore dhe zinxhirët e vlerës, duke përfshirë një mjet kombëtar të dedikuar, i cili është një burim dinamik, që ofron informacion në kohë reale për çmimet vendore të artikujve esenciale ushqimore. U aktivizua gjithashtu lidhja (linku) me Mjetin global për monitorimin dhe analizën e çmimeve të ushqimit të FAO-s.

Agjencia e Punësimit (AP) filloi të përdorë modelin statistikor të profilizimit, i cili do të përmirësojë informacionin për përcaktimin e kohës dhe intensitetit të mbështetjes për punëkërkuuesit në rrezik për t'u bërë të papunë afatgjatë, edhe atë me kosto efektive. Për më tepër, AP-ja ishte në gjendje të ofronte më shumë shërbime online për kompanitë, gjë që e përmirësoi komunikimin e përgjithshëm midis kompanive, punëkërkuësve dhe AP-së, si dhe efikasitetin e masave aktive të tregut të punës.

Gjithsej 50 zyrtarë nga institucionet kombëtare dhe komunat u fuqizuan për të komunikuar dhe për të ofruar shërbime për anëtarët e diasporës me qëllim të hartëzimit dhe lehtësimit të transferimit të aftësive dhe njohurive nga diaspora. Për të lehtësuar tregtinë, Drejtoria e Doganave dhe institucione të tjera të ngjashme përfituan nga ngritja e kapaciteteve duke vendosur në përdorim sistemin me një sportel për shërbimin e klientëve.

Për ta forcuar ekonominë rurale të qëndrueshme dhe konkurruese, OKB-ja mbështeti autoritetet në tre aspekte specifike. Së pari, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) u ndihmua për të përmirësuar Sistemin Kombëtar të Shëndetit të Kafshëve dhe Sigurisë Ushqimore në përputhje me standardet e BE-së, për të siguruar një zgjidhje moderne, të qëndrueshme dhe afatgjatë, që do të mundësojë regjistrim, analizë dhe shfrytëzim efikas të të dhënave jetike të kafshëve gjatë gjithë ciklit jetësor të kafshës.

742 ha tokë bujqësore

me rrjet rrugor dhe kullim të përmirësuar

Së dyti, pas një analize të hollësishme të OKB-së, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave inicioi përgatitjen e Strategjisë së re Kombëtare për Tokën Bujqësore.

Konsolidimi i tokës për periudhën 2024-2034 u mbështet me ngritjen e kapaciteteve për konsolidimin e tokës. Programi Kombëtar për Konsolidimin e Tokës u avancua më tej me hartimin e Planit të Rishpërndarjes së Tokës dhe projektimin teknik të përmirësimit të infrastrukturës bujqësore për 156 hektarë në fshatin Çiflik, me ç'rast u konsultuan 404 pronarë tokash. Poashtu, në fshatin Dabjani filloi puna për përmirësimin e kullimit dhe të rrjeteve rrugore për 742 hektarë tokë bujqësore, nga e cila përfituan 85 pronarë tokash bujqësore. U kryen aktivitete të ndryshme komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet nga konsolidimi i tokës dhe për të nxitur interesin nga komunitetet e tjera lokale në Maqedoninë e Veriut, si dhe u ofrua mbështetje nga BE-ja dhe OKB-ja për të përmirësuar Programin Kombëtar për Konsolidimin e Tokës.

Në fund, për të përmirësuar barazinë gjinore në zonat rurale, Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit (FSHBU) dhe OKB-ja ndihmuan Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) të aplikonte buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në hartimin e politikave, duke dyfishuar buxhetin e alokuar për masa më të përgjegjshme specifike gjinore (Masa 115) që synojnë gratë prodhuese të produkteve bujqësore. Fakulteti gjithashtu rriti përgjegjshmërinë gjinore të politikave rurale dhe bujqësore duke përditësuar Indeksin e Fuqizimit të Grave dhe duke vlerësuar ndikimin e masave ekzistuese të politikave për mbështetjen e grave prodhuese të produkteve bujqësore.



Në fshatin Dabjani filloi puna për përmirësimin e kullimit dhe rrjeteve rrugore për 742 hektarë tokë bujqësore, nga e cila përfituan 85 pronarë tokash bujqësore. Fotografia: FAO

REZULTATI 2

Shërbime cilësore për të gjithë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuara në të drejta – qasje në kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtjen e nevojshme sociale dhe e mbrojtjen e fëmijëve - të përfshira në sisteme rezistente ndaj situatave emergjente

Kontribuon në



- Gjithëpërfshirja sociale (kujdes për të gjitha kategoritë e cenushme) dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor
- Sistem modern arsimor
- Sistem shëndetësor i qëndrueshëm dhe modern
- Rinia në fokus



- Grupi 1: Aspektet themelore (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 18, 23, 24)
- Grupi 2: Tregu i brendshëm (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 28)
- Grupi 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 19, 26)

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2023

Reporti i Kështjës së Përcaktimit të Resultateve për vitin 2023

\$3,312,296

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Financave; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Drejtësisë; Byroja për Zhvillimin e Arsimit; Fondi i Sigurimit Shëndetësor; Drejtoria e E-Shëndetësisë; Enti Kombëtar i Shëndetit Publik; Enti Shtetëror i Statistikave; Shoqatat Profesionale; Shoqata për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim; Organizatat e Shoqërisë Civile; Shoqata për Edukim dhe Hulumtim Shëndetësor; Fakulteti i Mjekësisë Shkup



Përfaqësimi i shëndetit mendor të popullatës së re u trajtua duke hartuar një raport të detajuar të hartëzimit mbi shërbimet e shëndetit mendor me rekomandime për përmirësime, si dhe me krijimin e një Grupi Kombëtar Multisektorial të Punës për Shëndetin Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve. Fotografia: OBSH

Në kuadër të Rezultatit “Shërbime cilësore për të gjithë”, OKB-ja gjatë vitit 2023 mbështeti shërbimet thelbësore në fushën e shëndetësisë, arsimin dhe mbrojtjes sociale, dhe ndihmoi në eliminimin e çdo forme të dhunës, veçanërisht të dhunës gjinore dhe të dhunës në familje. Fatkeqësisht, pavarësisht nga disa zhvillime pozitive, të tilla si rritja minimale e shkallës së vaksinimit dhe rritja e shkallës së ndjekjes së programit të edukimit në fëmijërinë e hershme nga fëmijët e moshës midis 36-59 muaj, këto shërbime vazhduan të jenë tepër të ngarkuara dhe, në disa raste, madje kishin rezultate përkeqësuese.

Në fushën e shëndetësisë, fokusi u vendos në kujdesin shëndetësor parësor, duke zhvilluar protokolle klinike për gjendjet më të përhapura që trajtohen me kujdes ambulator dhe duke aftësuar 803 profesionistë shëndetësorë, 623 mjekë dhe 179 farmacistë në modelet dhe protokollat e reja, gjë që çoi gjithashtu në një proces më të lehtë të ruajtjes së këtyre barnave. Gjithashtu, u mblodhën dëshmi kritike përmes analizës së kostos së përfitimit për investimet në shërbimet e patronazhit (vizitave në shtëpi).

Përfaqësimi i shëndetit mendor të popullatës së re u trajtua duke përgatitur një raport të detajuar për hartëzimin e shërbimeve të shëndetit mendor me rekomandime për përmirësime, si dhe me krijimin e një Grupi Kombëtar Multisektorial të Punës për Shëndetin Mendor të Fëmijëve dhe të Adoleshentëve. Rreth 550 profesionistë në Shkup, Tetovë, Manastir, Prilep, Veles dhe Strumicë u trajnuan për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për çrregullime mendore dhe të sjelljes, të cilët pritet të ndihmojnë 65.000 fëmijë dhe adoleshentë.

Duke pasur parasysh shqetësimet në rritje të shëndetit mendor, 649 profesionistë të shkollave morën mentorim dhe u njohën me strategji dhe aktivitete praktike për të punuar me fëmijët, ndërsa 521 punonjës të shërbimeve profesionale në shkolla u aftësuan për t’iu përgjigjur kërcënimeve me bomba në shkolla. Për të siguruar mbështetje në nivel të gjithë sistemit, u krye analiza e mangësive dhe ajo u përdor për hartimin e Planit të parë Kombëtar të Veprimit për shëndetin mendor të adoleshentëve në vend, i pasuar nga një program i ri këshillimi për prindërit dhe nxënësit që mund të shfaqin sjellje të dhunshme ose që,

për arsye të ndryshme, nuk e arrijnë potencialin e tyre të plotë akademik.

Për Modelin e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues (ShSR), të prezantuar fillimisht nga OKB-ja, me klinika të lëvizshme gjinekologjike, vazhdimisht sigurohen shuma më të mëdha për financim. Si rezultat i kësaj, në kuadër të Programit Kombëtar të Ekzaminimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, 53.340 gra që nuk ishin ekzaminuar në 3 vitet e kaluara, u ekzaminuan në vitin 2023, që është një rritje prej shtatëfish vetëm nga viti 2022. Kjo u mbështet edhe me trajnime gjithëpërfshirëse që përfshinë më shumë se 1.200 nxënës të moshës midis 15 dhe 18 vjeç. Për më tepër, duke u bazuar në analizën e Sjelljes Shëndetësore tek Fëmijët e Moshës Shkollore, OKB-ja avokoi për futjen e Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual në procesin arsimor, në mënyrë që të rinjtë të marrin informacion të përshtatshëm për moshën dhe të besueshëm për vendimet kritike të jetës. Për më tepër, lideret femra kontribuan në fushatat e ndërgjegjësimit, të shoqëruara me debate dhe zhvillim strategjish në nivel komunal.

U rishikua dhe auditua Plan i Kryesor për Kujdesin Perinatal 2020-2030, duke ofruar rekomandime të bazuara në prova për të adresuar gabimet dhe barrierat e sistemit, duke përfshirë edhe ato që janë rezultat i ndryshimit të dinamikës demografike. Rreth 60 profesionistë shëndetësorë që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat më të cenushme në vend në të gjitha maternitetet, u aftësuan në metodat e planifikimit të familjes dhe metodat moderne kontraceptive.

Në bashkëpunim me BE-në, OKB-ja mbështeti Ministrinë e Shëndetësisë në një fushatë të gjerë derë më derë për imunizim të mëvonshëm, duke mbuluar 40 komuna, duke administruar mbi 5.000 doza të vaksinave rutinë që nuk janë marrë në kohën e duhur, 2.630 vaksina të gripit sezonal dhe të KOVID-19. Institucionet u pajisën edhe me procedura të standardizuara të zgjeruara për trajtimin e vaksinave dhe u aftësuan për promovimin e vaksinimit dhe shëndetit në punë, si dhe për procedura më të mira të raportimit për imunizimin në formatin

digjital. Një analizë e shërbimeve të imunizimit identifikoi boshllëqet dhe sfidat kryesore, dhe u dorëzua një propozim për të optimizuar burimet dhe rrjetin e pikave të vaksinimit.

Ministria e Shëndetësisë u forcua me krijimin e ekipit për Analizë të Politikave, që është me rëndësi kritike në hartimin e politikave shëndetësore të bazuara në të dhëna. U avancua edhe Sistemi i Infermierisë duke futur pozitën e Infermieres kryesore në nivel të qeverisë në Ministri. Fillori zhvillimi i Strategjisë së parë të Burimeve Njerëzore për Shëndetësi. Në vitin 2023, sistemi i llogarive kombëtare shëndetësore të Maqedonisë së Veriut u shpall si më i avancuari në Rajonin Evropian të OBSH-së (jashtë BE-së dhe OECD-së).

OKB-ja gjithashtu inicioi një vlerësim mbi barrierat shëndetësore në zonat rurale, të largëta dhe të vogla urbane në Maqedoninë e Veriut për të identifikuar strategjitë për barazi shëndetësore në të gjithë vendin. Përveç kësaj, u krye një Hulumtim cilësor për aspektet e sjelljes dhe kulturës së përdoruesve të duhanit dhe një analizë mbi kostot e konsumit të duhanit për të forcuar kontrollin e përdorimit të duhanit.

6,000 mësues

u aftësuan për mësimdhënie me cilësi të lartë

Po ashtu, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Arsimit u promovua iniciativa për shkollat promovuese të shëndetit, në përputhje me standardet globale.

Duke adresuar problemin e rënies së rezultateve të mësimit, OKB-ja avokoi dhe investoi në reformën e vazhdueshme të plan-programeve mësimore, kryesisht duke mbështetur harmonizimin e Konceptit të Arsimit Fillor me rezultatet kombëtare të mësimit dhe standardet e vlerësimit. Marrja përsipër e Kuvendit nga fëmijët, organizuar në Ditën Botërore të Fëmijëve, u dha një mundësi shumë të dukshme fëmijëve dhe



Në bashkëpunim me BE-në, OKB-ja mbështeti Ministrinë e Shëndetësisë në një fushatë të gjerë derë më derë për imunizim të mëvonshëm duke mbuluar 40 komuna, dhe duke administruar mbi 5.000 doza rutinë që nuk janë marrë në kohën e duhur, dhe 2.630 vaksina të gripit sezonal dhe të KOVID-19. Fotografia: OBSH



Marrja përsipër e Kuvendit nga fëmijët, organizuar në Ditën Botërore të Fëmijëve, u dha një mundësi shumë të dukshme fëmijëve dhe të rinjve për të shprehur shqetësimet e tyre për mungesën e qasjes në arsim dhe cilësinë e arsimit dhe për të avokuar për miratimin e shpejtë të ndryshimeve në ligjet e nevojshme. Fotografia: UNICEF

të rinjve për të shprehur shqetësimet e tyre për mungesën e qasjes në arsim dhe cilësinë e arsimit dhe për të avokuar për miratimin e shpejtë të ndryshimeve në ligjet e nevojshme.

OKB-ja vazhdoi t'i ofrojë mbështetje teknike Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe dhjetë komunave model në zhvillimin e një vizioni afatmesëm për transformimin e rrjetit të shkollave fillore dhe përmirësimin e shpërndarjes së burimeve të kufizuara. Në këtë kontekst, OKB-ja avokoi te komunitet për të transformuar hapësirat e lira të shkollave fillore në hapësira për mësim parashkollor për të mbështetur optimizimin e rrjetit shkollor. Në vitin 2023, Byroja për Zhvillimin e Arsimit u fuqizua për të marrë pronësinë dhe menaxhimin e plotë të platformës kombëtare arsimore EDUINO. Afro 6.000 mësues u aftësuan për mësimdhënie me cilësi të lartë dhe u pajisën me burime mësimore me cilësi të madhe për aktivitete jashtëmësimore, për mësim përmes përvojës dhe mundësi për angazhimin e komunitetit. Me mbështetjen e OKB-së, në arsimin parashkollor, 109 edukatorë të trajnuar nga i gjithë vendi, i trajnuan 1.097 edukatorë të tjerë, duke i njohur ata me mësimin social dhe emocional të fëmijëve (MSE) dhe me strategji të ndryshme praktike që mund të zbatohen në punën e tyre. Përveç kësaj, u vizituan 30 institucione parashkollore (38%) për të analizuar zbatimin e programit MSE në praktikë dhe për të theksuar fushat që kërkojnë vëmendje të mëtejshme. U zhvillua programi i trajnimit për punonjësit parashkollorë për stile jetese të shëndetshme për të adresuar tendencat në rritje të obezitetit dhe mbipeshës që në fëmijëri.

OKB-ja gjithashtu mbështeti qasjen në shkollë për grupet e cenueshme, duke vendosur ndërmjetës romë në secilën komunë për të përmirësuar përgatitjen për shkollë dhe rezultatet e zhvillimit në fëmijëri të hershme të fëmijëve romë, të moshës tre deri në gjashtë vjeç. Është dhënë sugjerimi për ndryshimin e Ligjit për Arsimin Fillor për të siguruar vazhdim të arsimimit në institucionet korrektuese dhe certifikim të tij. Përveç kësaj, 1.283 mësimdhënës u sensibilizuan për të punuar me fëmijët refugjatë, emigrantët dhe azilkërkuesit dhe 42 punonjës nga pesë qendrat burimore u trajnuan për të lehtësuar përfshirjen e fëmijëve refugjatë, emigrantë dhe azilkërkues në arsim. Për të mbështetur përfshirjen e hershme të fëmijëve me vështirësi

në komunikim, 25 profesionistë në pesë qendrat burimore u aftësuan për të zbatuar komunikimin alternativ dhe augmentativ (KAA) në vitin 2023, dhe KAA-ja u fut si temë në Programin për Zhvillimin Profesional të Asistentëve Arsimorë. Kjo u mbështet me 11 ngjarje të hapura lokale të organizuara në institucionet parashkollore, për të njohur prindërit dhe profesionistët me përfitimet nga KAA-ja. Që nga shtatori i vitit 2023, të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara regjistrohen në shkollat e rregullta fillore. Për të lehtësuar këtë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës krijoi një grup pune për bashkëpunim të udhëhequr nga OKB-ja, që ka për detyrë të japë rekomandime për të ofruar mbështetjen e nevojshme për mësimdhënësit në zhvillimin dhe zbatimin e programit të modifikuar.

Në fushën e mbrojtjes sociale, një analizë funksionale e Qendrave për Punë Sociale identifikoi boshllëqet dhe sfidat kryesore në strukturën organizative, shpërndarjen e burimeve dhe kapacitetin e fuqisë punëtore, gjë që inicioi një integrim më të mirë në menaxhimin e rasteve dhe krijimin e një moduli të avancuar për menaxhimin e rasteve të inkuorporuar në platformën elektronike për edukimin e profesionistëve të punës sociale.

OKB-ja i mbështeti edhe prindërit. Aplikacioni për prindërim "Bebbo" arriti në 16.700 përdorues deri në fund të vitit 2023 dhe u ofroi prindërve dhe kujdestarëve informacion mbi kujdesin ndaj fëmijëve dhe ushqimin e shëndetshëm, kujdesin për veten dhe këshilla të ekspertëve për menaxhimin e stresit, duke mbështetur kështu mirëqenien e fëmijëve. Linja Kombëtare e Ndhmës për Prindërit, e cila tani menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme nga një punonjës social dhe psikoterapist kombëtar, kontaktoi 219 prindër/kujdestarë, vetëm në gjysmën e parë të vitit, ndërsa dhjetë nëna i përforcuan aftësitë e prindërimit pozitiv përmes programit të prindërimit përkëdhelës në internet. Kjo u mbështet me një promovim gjithëpërfshirës për qasjen e prindërimit pozitiv në media (sociale), kopshte dhe shkolla fillore. Në partneritet me Klinikën Universitare të Psikiatrisë dhe Entin për Veprimtari Sociale, 60 profesionistë nga qendrat për punë sociale dhe shtëpitë e grupeve të vogla, fituan njohuri mbi mbështetjen psikosociale për fëmijët në sistemin e mbrojtjes sociale. Gjithashtu, 47 profesionistë të sistemit të

ЕФЕКТИТЕ НА КРИЗАТА СО ХРАНА И ЕНЕРГИЈА ВРЗ ДЕЦАТА И СЕМЕЈСТВОТА



OKB-ja punoi me Entin Shtetëror të Statistikave dhe ministritë e linjës për të sjellë më afër konceptin e varfërisë shumëdimensionale të fëmijëve, duke përfshirë edhe përmes llogaritjes së indeksit shumëdimensional të varfërisë së fëmijëve. Fotografia: UNICEF

mbrojtjes sociale i fituan të njëjtat njohuri përmes Platformës Digjitale për Mësim të menaxhuar nga Enti, së bashku me 1.430 profesionistë të tjerë që përfituan nga kjo platformë në fusha të rëndësishme për fëmijët.

12,500 persona

morën mbështetje të ndryshme në Qendrat e Përkohshme të Tranzitit

Një rekomandim politikash i bazuar në fakte për hapat e nevojshëm për futjen në përdorim të një sistemi të ri multidisiplinar, të orientuar nga familja, të ndërhyrjes në fëmijëri të hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vonesa në zhvillim, u zhvillua në mënyrë pjesëmarrëse, së bashku me draft standardet dhe procedurat. Për këtë qëllim, 54 profesionistë u fuqizuan në ofrimin e shërbimeve të ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme të orientuara drejt familjes. Standardet dhe normat për ofruesit e licencuar të shërbimeve të këshillimit dhe përshtatja e modeleve për përcaktimin e çmimeve u përmirësuan duke futur mekanizma për sigurimin e cilësisë gjatë ofrimit të shërbimeve për fëmijët. Për më tepër, me mbështetjen e OKB-së, nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale u miratua Rregullorja e bazuar në të drejtat e njeriut për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar sipas KNF-së, së bashku me një regjistër elektronik të fëmijëve dhe të rinjve që janë vlerësuar.

OKB-ja punoi gjithashtu me Entin Shtetëror të Statistikave dhe ministritë e linjës për të ngritur vetëdijen për konceptin e varfërisë shumëdimensionale të fëmijëve, duke përfshirë edhe përmes llogaritjes së indeksit shumëdimensional të varfërisë së fëmijëve. Për më tepër, analiza e OKB-së mbi efektet e rritjes së çmimit të energjisë dhe të ushqimeve të fëmijët e cenueshëm kontribuoi dhe ndikoi në disa nga masat kundër krizës të qeverisë, si për shembull ndihmën shtesë për prindërit e vetëm-përfittues të ndihmës minimale të garantuar dhe ndryshimet në modelin e përcaktimit të çmimit të energjisë elektrike që është

i dobishëm për familjet më të varfra dhe familjet me shumë fëmijë.

Më shumë se 12.500 emigrantë, refugjatë dhe azilkërkues në dy Qendrat e Përkohshme të Tranzitit, shumica dërrmuese e të cilëve janë burra, morën mbështetje mjekësore, mbështetje psiko-sociale, kthim vullnetar të asistuar dhe riintegrim, mbështetje arsimore, ndërmjetësim kulturor, aktivitete rekreative, ndihmë gjuhësore dhe mbështetje të tjera duke u bazuar në nevojat e tyre, duke rritur kështu qasjen e tyre në shërbimet e pritjes dhe mbrojtjes. Gjithashtu, 110 azilkërkues në Qendrën e Pranimit në Vizbeg përfituan nga përkrahja psiko-sociale e mbështetur nga OKB-ja, 85 persona mësuan gjuhën maqedonase dhe morën pjesë në ngjarje të ndryshme që kontribuan në përfshirjen e tyre në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut. Falë avokimit të OKB-së, në vitin 2023 u miratuan ndryshimet e Ligjit për të Huajt, duke mundësuar që të gjithë refugjatët e mbetur nga Kosova, pavarësisht nga statusi i tyre aktual, të aplikojnë për qëndrim të përhershëm. 194 personat e mbetur në vend morën ndihmë juridike dhe këshillim.

OKB-ja ndihmoi më tej Qeverinë për përfshirjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve, duke krijuar një modul trajnimi për Edukim Digjital dhe Modernizim, që synon të përmirësojë aftësitë didaktike të punonjësve të Entit për Veprimtari Sociale dhe të përmirësojë përmbajtjen digjitale të përshtatur për ofruesit e shërbimeve profesionale brenda sistemit të mbrojtjes sociale. Gjithashtu, u rishikuan procedurat standarde të rishikuara operative (PSO) për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë dhe të huajt e cenueshëm dhe pritet të miratohen në fillim të vitit 2024. U iniciuan dy PSO-të shtesë për policinë kufitare, për Sistemet e hyrjes për personat që kanë për mbrojtje dhe për Paraburgimin gjatë emigracionit dhe pritet të finalizohen dhe të miratohen në fillim të vitit 2024, që është një përparim i madh në menaxhimin e lëvizjeve të përziera të emigracionit dhe qasjes në territor.

Me qëllim të funksionalizimit të plotë të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,



U organizuan ngjarje në komunitet për të shprehur mirënjohje për profesionistët që ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë për viktimat dhe të mbijetuarit e DHBGJ-së. Fotografia: UNFPA

OKB-ja ndihmoi autoritetet që të zhvillojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të miratojnë një Protokoll të ri për një përgjigje multi-sektoriale të përqendruar te viktimat ndaj dhunës ndaj grave/dhunës në familje (DHNG/DHF), si dhe të krijojnë listën e parë të 33 trajnerëve të certifikuar për DHBGJ/DHF nga të gjitha institucionet dhe OSHC-të dhe të lëshojnë në përdorim Sistemin e përmirësuar për Menaxhimin e Informacionit të DHBGJ, duke u bazuar në modelin e mbledhjes së të dhënave të integruara. Si një nga hapat e parë, këta trajnerë të certifikuar ua përcollën njohuritë e tyre më shumë se 25 profesionistëve nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në bazë të vlerësimit të kryer me mbështetjen e OKB-së, tre linjat SOS i zgjeruan operacionet e tyre përmes takimeve të rregullta mujore të koordinatorëve dhe operatorëve për të shkëmbyer informacione (konfidenciale) dhe për të reaguar sipas nevojës, dhe u trajnuan 20 operatorë dhe koordinatorë nga tre organizata. Për më tepër, gjithsej 16 profesionistë u trajnuan dhe u certifikuan sipas standardeve të zhvilluara dhe kurrikulës arsimore për punë me kryerësit e veprave të dënueshme me ligj, e më pas u mbështetën me mentorim të ofruar nga OSHC-të më me përvojë. Gjithashtu u finalizua programi për riintegrimin e viktimave. Në bashkëpunim me një OSHC lokale, OKB-ja mbështeti një program mentorimi social, lehtësoi punësimin e 13 grave të mbijetuara dhe rriti aftësinë për punësim për gjithsej 15 gra.

U bë ngritja e vetëdijes përmes një sërë fushatash komunikimi me një shtrirje të fortë mes të mbijetuarve të DHBGJ-së, veçanërisht nga grupet e cenushme, grupet e pakicave etnike dhe të rinjtë. Fushata "Ka ndihmë për një jetë pa dhunë" dhe ngjarjet e ngjashme në komunitet trajtuan pengesat kryesore për të raportuar dhunën siç është turpi, frika dhe keqkuptimet. Gjithashtu, u organizuan ngjarje në komunitet për të shprehur mirënjohje për profesionistët që ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë për viktimat dhe të mbijetuarit e DHBGJ-së. Me Institutin e Studimeve të Komunikimit (ISK) u

zhvilluan dhe u publikuan produkte të llojllojshme komunikimi, jo vetëm për të promovuar shërbimet e disponueshme për viktimat e DHBGJ-së, por edhe për të ofruar një analizë mbi raportimin etik të gazetarëve për DHBGJ-në. Në mediat sociale u zhvillua fushata BodyRight dhe u përgatit një fjalor i lokalizuar për të rritur ndërgjegjësimin rreth dhunës me bazë gjinore me përdorim të teknologjisë, duke arritur në 27.554 persona, me fokus të veçantë tek njerëzit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, u ofrua mbështetje për të vlerësuar qasshmërinë e 23 objekteve të ofruesve të shërbimeve dhe për të fuqizuar punonjësit shëndetësorë që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, si dhe u harmonizua "Udhëzuesi për Parandalimin dhe Reagimin ndaj DHBGJ-së ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara" me kornizën më të fundit ligjore.

Modeli i bashkëpunimit me shumë palë u kopjua në komunat e Gostivarit dhe Shuto Orizares, ndërsa OSHC-të nga tri komunitete u trajnuan për ta kopjuar atë më tej në komunitetet pakicë etnike, duke përfshirë komunitetin shqiptar dhe rom. Për më tepër, me përkrahje të OKB-së dhe me financim komunal, një OSHC nga Gostivari hapi strehimoren e parë në rajon dhe një OSHC nga Shuto Orizareja hapi qendrën e parë këshilluese për mbështetje psiko-sociale në këtë komunë romë. Ky koncept u promovua më tej gjatë fushatës "16 ditë aktivizëm", me punëtori edukative në zonat rurale të të dy komunave.

Gjithashtu, aktivitetet e komunikimit u shfrytëzuan për të ngritur vetëdijen për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, të cilat u kurorëzuan me ngjarjen e nivelit të lartë, "Fuqia e Zgjedhjes: Realizimi i Autonomisë Trupore për Gratë dhe Vajzat", me folës rajonalë dhe globalë dhe pjesëmarrës të shquar nga vendi dhe rajoni.

Gjatë vitit 2023, në bashkëpunim me INTERPOL-in dhe ECPAT International, OKB-ja inicioi gjithashtu një projekt hulumtues, duke u bazuar në metodologjinë e "Pengimit të dëmtimit", që synon të sigurojë prova gjithëpërfshirëse mbi shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet duke mbledhur të dhëna ndërsektoriale.

REZULTATI 3

Mjedisi jetësor i shëndetshëm



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze klimatike, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes menaxhimit të mirë të mjedisit jetësor dhe nga komunitetet rezistente ndaj fatkeqësive.

Kontribuon në



- Mbrojtja e mjedisit jetësor, zhvillimi i gjelbër dhe i qëndrueshëm
- Tranzicioni i energjisë dhe qëndrueshmëria



- Grupi 1: Aspektet themelore (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 18, 23, 24)
- Grupi 2: Tregu i brendshëm (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 28)
- Grupi 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 19, 26)
- Grupi 4: Agjenda e lidhja e qëndrueshme (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 27)
- Grupi 5: Burimet, bujqësia dhe kohezioni (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 11, 12)

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2023

\$9,534,030

Partnerët e zhvillimit:

Kabineti i Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Çështjet Ekonomike, Koordinimin e Sektorëve Ekonomikë dhe Investime; Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Kulturës; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Enti Kombëtar i Shëndetit Publik; Qendra e Menaxhimit të Krizave; Drejtoria për Shpëtim dhe Mbrojtje; Drejtoria e E-Shëndetësisë; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Enti Shtetëror i Statistikave; Fondacioni Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm; Organizatat e shoqërisë civile; Lidhja e Vlerave Natyrore dhe Njerezve - Zyra; Shoqata Ekologjike e Maqedonisë; Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë; Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit; Fakulteti i Shkencave Pyjore; Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore; Instituti i Bujqësisë; Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor; Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Hulumtim; komunat në të gjithë vendin



U përfundua hartëzimi i organizatave rinore dhe modeli për themelimin e Qendrave Rinore Klimatike në Shkup dhe Ohër, duke hedhur bazat për trajnime të synuara dhe bashkëpunim brenda Rrjetit Rinor Rajonal të sapokrijuar. Fotografia: UNDP

Për të mbështetur zhvillim dhe zbatimin e politikës kombëtare për ndryshimet klimatike, u ndërmorën aktivitete përgatitore për të lehtësuar funksionalizimin e Këshillit Koordinues Kombëtar për Veprimin Klimatik (KKKVK) në përputhje me Ligjin e ri për Veprimin Klimatik, i cili pritet të miratohet në vitin 2024. Përveç kësaj, u përfundua hartëzimi i organizatave rinore dhe modeli për themelimin e Qendrave Rinore Klimatike në Shkup dhe Ohër, duke hedhur bazat për trajnime të synuara dhe bashkëpunim brenda Rrjetit Rinor Rajonal të sapokrijuar. Në prag të COP28 u organizuan ngjarje në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor dhe Presidentin e vendit për të paraqitur qëndrimet e tyre për COP (ministtrat e Mjedisit, Ekonomisë dhe Shëndetësisë) dhe për të hapur një dialog me organizatat rinore për pritshmëritë e tyre nga COP 28.

Në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, u bënë hapa të rëndësishëm për të mundësuar qasje më të madhe në mjete financare për klimën. OKB-ja e lehtësoi qasjen e Maqedonisë së Veriut në Fondin e Gjelbër të Klimës (FGJK) përmes projekteve që synojnë rritjen e kapaciteteve kombëtare për qëndrueshmërinë ndaj klimës. Ndërkohë, Instrumenti i Financimit të Gjelbër (IFGj),

filloi me ofrimin e financave për NVM-të drejt tranzicionit të gjelbër, duke mbështetur investimet në teknologjitë e energjisë së rinovueshme (ER) dhe efikasitetit të energjisë (EE). Dy banka private (Sparkasse dhe ProCredit) dhe një kompani për qira financiare (Sparkasse Leasing) tani ofrojnë kredi nga IFGJ-ja për NVM-të në Maqedoninë e Veriut, të shoqëruara me komponentin e grantit ex-post dhe asistencë teknike falas për teknologjitë e ER dhe EE. Instrumenti i Financimit të Gjelbër i kombinon financimet nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, Fondi i Përbashkët i QZHQ-së, BERZH-i dhe disa banka komerciale.

OKB-ja vazhdoi të luajë një rol kyç në avancimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin ekologjik, duke përfshirë 1.038 mësime ndërmjet të gjithë vendin dhe 35.722 fëmijë nga shkollat fillore dhe çerdhet. Duke u mbështetur në kurrikulën tashmë të integruar për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike në klasat e zgjedhura të shkollës fillore dhe Rrjetin e krijuar më parë për Mësim përmes Përvojës, u ofruan mundësi për mësim praktik, duke integruar edukimin për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore. Më tej, u krijua një Laborator Biohacking dhe Kamp Inovacioni për të rinjtë, për të nxitur interesin e të rinjve në hulumtime dhe shkencë mbi qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin. Për më tepër, 141.134 njerëz u përfshinë dhe u angazhuan në fushata për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe 623 biznese fillestare (start-up) dhe NVM morën mbështetje mentoruese për teknologji të pastra miqësore me klimën.

Iniciativat e OKB-së që kishin për qëllim të rrisin masat për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike për të mundur rezistencë bujqësore, u fokusuan në përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së cilësisë së farës. U vlerësua Sistemi Kombëtar i Farës dhe u zhvillua një grup gjithëpërfshirës rekomandimesh. U krye një vlerësim i sistemeve shtetërore të ujitjes dhe kullimit në zonën e Radovishtit për të ndihmuar autoritetet të identifikojnë

fushat për përmirësim dhe modernizim. Për të përmirësuar sigurinë ushqimore, OKB-ja i dha mbështetje Strukturës Kombëtare të Kodeksit në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë përkthimin e Manualeve të Kodeksit Alimentarius dhe lehtësimin e pjesëmarrjes në takimet ndërkombëtare në lidhje me mbetjet e preparateve veterinarë në ushqim.

Vazhduan përpjekjet për të trajtuar shterimin e ozonit dhe kontrollin e substancave, të tilla si ftohësit, me fokus në menaxhimin e mbeturinave, rishikimin e legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve. Në vitin 2022, u rimëkëmbën 10.681 kg ftohës dhe u ricikluan 14.082 kg ftohës. U hartuan akte nënligjore për sistemin e qëndrueshëm të certifikimit të ftohësve dhe 55 përfaqësues nga Drejtoria Doganore, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor u fuqizuan për të zbatuar kontrollin dhe monitorimin e substancave të Protokollit të Montrealit. Gjithashtu, u përfunduan hapat përgatitorë për skemën e granteve për pajisje të rimëkëmbjes dhe riciklimit për subjektet/dyqanet e servisimit.

Për sa i përket menaxhimit të integruar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të burimeve natyrore, OKB-ja në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe përfaqësuesit e institucioneve anëtare të Këshillit Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm, iniciuan aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës (MQT) dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve (MQP). Vazhdoi puna për zhvillimin e Strategjisë dhe Ligjit për Mbrojtjen e Tokës, duke përfshirë analizën e kornizës ligjore dhe institucionale, dhe me përditësimin e Planeve Lokale të Veprimit për Mjedisin Jetësor, si dhe me analizën për shfrytëzimin e tokës dhe vlerësimin e ekosistemeve të pyjeve dhe kullotave për komunat e synuara. OKB-ja bashkëpunoi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe institucionet akademike për të nisur një projekt që forcon Shërbimin Pyjor të Maqedonisë dhe rolin e tij në ekonomi dhe



U vlerësua Sistemi Kombëtar i Farës dhe u zhvillua një grup gjithëpërfshirës rekomandimesh. Fotografia: FAO

zhvillimin rural. Aktivitetet kryesore përfshinin përmirësimin e monitorimit të dëmtimit të pyjeve, planifikimin e restaurimit dhe diskutimet për bashkëpunimin rajonal. Hartimi i vlerësimeve të politikave për dëmet e pyjeve në Maqedoninë e Veriut, si dhe investimet e mundshme në ripyllëzimin ishin komponentët kryesorë të mbështetjes së OKB-së. U miratua Programi Ombrellë për Mbështetjen e Zhvillimit të Planeve Financiare të Biodiversitetit (BIOFIN), i cili pritet të sjellë mjete dhe instrumente të reja që do të përmirësojnë financimin e zonave të mbrojtura.

Rrëqebulli Euroaziatik dhe nëngrupi i rrezikuar në mënyrë kritike i Rrëqebullit të Ballkanit, u renditën nën shtojcat (II dhe I, respektivisht) të Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (CMS/Konventa e Bonit), falë nismës nga shumë vende të udhëhequr nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe e mbështetur nga OKB-ja.

Një ekip ekspertësh të pavarur i mandatuar nga OKB-ja filloi të punojë në përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit për Planin Urbanistik Bregdetar për Rajonin e Ohrit. Studimi i Fizibilitetit duhet të ofrojë një bazë për vendimmarrje të informuar mbi planifikimin urban, si dhe një kornizë më koherente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit të Ohrit duke përdorur mjete digjitale inovative.

Me mbështetjen e OKB-së, u organizuan seminare rajonale mbi menaxhimin e mbeturinave, ndryshimet klimatike dhe politikat dhe praktikat e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në Rishikimet e Performancës Ekologjike (RPE) në Shkup për të përmirësuar shkëmbimin e përvojave ndërmjet përfaqësuesve nga institucionet relevante në rajon.

Për sa i përket ndotjes së ajrit, pas një rënie të niveleve mesatare vjetore të grimcave në vitin 2021 dhe 2022, PM10 është rritur

lehtë në vitin 2023 në 37,44 µg/m³, por ende nën vlerën bazë të KBZHQ-së prej 51,32 µg/m³. Kjo rritje e lehtë nga nivelet e vitit 2022 shpjegohet me kthimin në nivelet e aktivitetit para Kovidit dhe vlera mbetet nën objektivin pesëvjeçar prej 40 µg/m³. Iniciativa të reja shumëvjeçare kanë filluar në vitin 2023 në tetë qytete në mbarë vendin (Shkup, Manastir, Kumanovë, Tetovë, Kavadar, Strumicë, Gostivar dhe Strugë). Për të vlerësuar burimet dhe nivelin e ndotjes së ajrit në këto qytete, është iniciuar mbledhja dhe monitorimi i të dhënave për cilësinë e ajrit ambiental gjatë katër stinëve. Gjithashtu, u instalua stacioni i parë për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe stacioni meteorologjik në Strugë, si dhe u ofruan pajisje teknike bazë për komunat, ndërsa punonjësit komunalë dhe inspektorët lokalë u trajnuan për monitorimin e cilësisë së ajrit. Për herë të parë në vend, monitorimi i cilësisë së ajrit në ambiente të mbyllura kryhet në dhjetë shkolla dhe kopshte, në përputhje me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Platforma e ndotjes së ajrit është përmirësuar për të siguruar të dhëna në kohë reale nga monitorimi i cilësisë së ajrit.

Ndërgjegjësimi për ndotjen e ajrit u përforcua edhe përmes aktiviteteve të ndryshme për ndryshim të sjelljes në bashkëpunim me OShC-të, Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë dhe të rinjtë. Për sa i përket të rinjve, 980 të rinj u angazhuan në aktivitete për ndotjen e ajrit në partneritet me Agjencinë për Rini dhe Sport. Këshillat rinorë në tri komuna hartuan plane të detajuara pune për përmirësimin e cilësisë së ajrit, kurse programi i Ambasadorëve për ajër të pastër prodhoi produkte mediatike dhe angazhoi politikëbërësit. OKB-ja inicioi një rishikim të gjelbërimit të kurrikulave të AFP-së në partneritet me Qendrën e Arsimit dhe Formimit Profesional, duke promovuar zhvillimin e aftësive të gjelbra te nxënësit. Një studim i fushëveprimi mbi ndërlidhjet ndërmjet ndotjes së ajrit dhe lëvizshmërisë



Rrëqebulli Euroaziatik dhe nëngrupi i rrezikuar në mënyrë kritike i Rrëqebullit të Ballkanit, u renditën nën shtojcat (II dhe I, respektivisht) të Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (CMS/Konventa e Bonit), falë nismës nga shumë vende të udhëhequr nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe e mbështetur nga OKB-ja. Fotografia: UNEP/Dime Melovski

njerëzore në Tetovë ofroi dëshmi për përmirësimin e planifikimit hapësinor dhe masave zbutëse. OKB-ja mbështeti hartëzimin dhe analizën e politikave, legjislatcionit dhe strategjive ekologjike në Maqedoninë e Veriut, duke mbështetur përpjekjet për pajtueshmëri me programin e lëvizshmërisë njerëzore të UNFCCC-së.

Në përgjithësi, përpjekjet bashkëpunuese dhe iniciativat për ngritjen e kapaciteteve kanë kontribuar në avancimin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, megjithëse mbeten sfida në arritjen e kapaciteteve optimale institucionale dhe përputhshmërisë me Kornizën e Sendait për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë. Rreziku nga fatkeqësitë është ulur dhe vlerësuar si i ulët (Rezultati i Indeksit të Rrezikut INFORM për Maqedoninë e Veriut në vitin 2023 është 2,5, pak më poshtë nga 2,6 vlera bazë e KBZHQ-së). Disa rezultate u arritën nga ekipi i OKB-së në vitin 2023 në ndërtimin e rezistencës ndaj fatkeqësive përmes zbatimit të masave të kombinuara jo-strukturore dhe strukturore. Së pari, mbështetja e OKB-së në përditësimin e studimit të vendit për Reduktimin e Rrezikut të Fatkeqësive (RRF) për Maqedoninë e Veriut kulmoi me rekomandimet kryesore për të forcuar RRF-në në sektorin e bujqësisë. Këto përfshijnë integrimin e RRF-së në kornizat ligjore, përmirësimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, optimizimin e sistemeve të informacionit, adresimin e dobësive, harmonizimin e metodologjive të vlerësimit dhe promovimin e sigurimeve bujqësore. Së dyti, u zhvillua Plani Kombëtar i Veprimit për Sigurinë Shëndetësore 2024-2025, duke përforcuar menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në sektorin shëndetësor të Maqedonisë së Veriut.

Masat e shtuara të biosigurisë në laboratorët e shëndetit publik sigurojnë ndërhyrje mjekësore në kohë dhe krijojnë mjedise më

të sigurta të kujdesit shëndetësor. Së treti, Indeksi nënkombëtar i Rrezikut INFORM për Evropën Juglindore, i fokusuar në Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut u përditësua në një përpjekje bashkëpunuese të udhëhequr nga OKB-ja, IPPF E JL, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Maqedonisë së Veriut dhe partnerë të tjerë. Indeksi ndihmon në identifikimin e zonave me rrezik të lartë, duke lehtësuar menaxhimin proaktiv të rrezikut nga fatkeqësitë dhe duke ofruar udhëzime për shpërndarjen e burimeve. Së katërti, rehabilitimi i 6 km të lumit Sateska, duke përfshirë automatizimin e një objekti të portës së kanalit, dhe devijimi i lumit në shtratin e tij natyror do të përmirësojë rezistencën e pellgut të Drinit ndaj vërshimeve dhe do të mbrojë Liqenin e Ohrit nga ngarkesa e sedimentit. Së pesti, u stabilizuan shtatë rrëshqitje prioritare të tokës në rajonin e Pollogut duke ulur kështu rrezikun për komunitetet lokale. Së fundi, 623 nëpunës shtetërorë nga institucionet relevante në nivel qendror dhe lokal u mbështetën për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për financimin e rrezikut, integrimin gjinor dhe teknikat e shpëtimit nga vërshimet, ndërkohë që Departamenti i hidrologjisë i HydroMet ka rritur njohuritë në modelimin hidrologjik. Investimet për zbutjen e rrezikut nga vërshimet, falë menaxhimit të rrezikut nga vërshimet ose planeve të tjera përkatëse për RRF, u rritën në 5,5 milionë dollarë amerikanë.

Për sa i përket mbeturinave, në vitin 2023 u pastruan dy pellgje të kompleksit të vjetër të industrisë kimike (OHIS). Kjo rezultoi në një pastrim prej 1.250 tonësh mbetjesh heksaklorocikloheksan (HCH) dhe tokë të kontaminuar me HCH. OKB-ja filloi Raportin Rajonal të Monitorimit të Mbeturinave Elektronike për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë një profil të vendit të mbeturinave elektronike për Maqedoninë e Veriut, duke ofruar statistika të mbeturinave elektronike dhe duke nxitur diskutime mbi implikimet e tyre.



Për sa i përket mbeturinave, në vitin 2023 u pastruan dy pellgje të kompleksit të vjetër të industrisë kimike (OHIS). Kjo rezultoi në një pastrim prej 1.250 tonësh mbetjesh heksaklorocikloheksan (HCH) dhe tokë të kontaminuar me HCH. Fotografia: UNOPS

REZULTATI 4

Qeverisja e mirë



Deri në vitin 2025, njerëzit në gjithë vendin përfitojnë nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikat e bazuara në dëshmi, të parashikueshme dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë; nga kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi i efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme.

Kontribuon në



- Sundimi i ligjit, qeverisja e mirë dhe anti-korrupsioni
- Promovimi i demokracisë dhe lirisë
- Integrimi në BE
- Decentralizimi dhe zhvillimi i barabartë rajonal
- Administratë moderne, shërbime të digjitalizuara
- Një shoqëri për të gjithë



- Grupi 1: Aspektet themelore (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 18, 23, 24, 32)
- Grupi 2: Tregu i brendshëm (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 1, 28, 10)
- Grupi 3: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 16, 17, 19, 25, 26)
- Grupi 4: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 15, 27)
- Grupi 5: Burimet, bujqësia dhe kohezioni (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 11, 22, 33)
- Grupi 6: Marrëdhëniet e jashtme (Kapitujt e legjislacionit të BE-së: 30)

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2023

\$ 11,636,683

Partnerët e zhvillimit:

Kabineti i Presidentit, Kuvendi, Kabineti i Kryeministrit, Kabineti i Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Çështjet Ekonomike, Koordinimin e Sektorëve Ekonomikë dhe Investimeve; Kabineti i Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Qeverisjen e Mirë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Financave; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Kulturës; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Vetëqeverisjes Lokale; Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut; Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; Agjencia për Rini dhe Sport; Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale; Byroja për Zhvillim Rajonal; Drejtoria Doganore; Gjyqësori; Prokuroria Publike; Prokuroria Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin; Drejtoria e të Ardhurave Publike; Sekretariati për Çështje Evropiane; Enti Shtetërori Revizionit; Enti Shtetëror i Statistikave; Avokati i Popullit; Komisioni për Promovimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi; Komisioni Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandës së Emigrantëve, Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore; Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë; Forumi Arsimor Rinor, Fakulteti Juridik Justiniani i Parë, La Strada, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Instituti i Politikave Evropiane; Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Maqedonisë; Koalicioni i OJQ-ve Kundër Dhunës ndaj Grave; Grupet Blue Print; Aksioni Zdruzhenska; Shoqata e Punonjësve Financiarë; Shoqata e Gazetarëve; Organizatat dhe Grupet e Personave me Aftësi të Kufizuara; Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore; Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar; Interpoli; Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë; Qyteti i Shkupit; Komunitat e Aerodromit; Manastirit; Gjorçe Petrovit; Makedonski Brodit; Bogdancit; Bogovinës; Qendrës; Çashkës; Dellçevës; Gazi Babës; Gjevgjeli; Gostivarit; Karposhit; Kavadarit; Kisela Vodës; Koçanit; Kriva Pallankës; Kumanovës; Makedonska Kamenicës; Mavrovë-Rostushës; Novacit; Ohrit; Shtipi; Nagoricanit të Vjetër; Strugës; Strumicës; Sveti Nikoles; Tetovës; Velesit; Vinicës dhe të tjerë.

Common principles of cooperation for all three models

Confidentiality statements (Non Disclosure Acts), signed by public servants and civil society, are a key element of the negotiations structure. Confidentiality statements (Non Disclosure Acts) should be composed of clear and concise information on the rights for all participants of the process, indicating procedures, structure and nature of confidential information that will be covered by that document.

Impartial and non-partisan working ethics within the Working Groups.

Duke punuar ngushtë me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, OKB-ja mbështeti ndryshime transformuese në fusha kyçe të rëndësishme për anëtarësimin e vendit në BE dhe arritjen e QZHQ-ve, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe qasjen në drejtësi, barazinë gjinore, sundimin e ligjit dhe kohezionin social. Fotografia: UNOPS

work within the Working Groups.
work in the good faith.

Duke punuar ngushtë me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, OKB-ja mbështeti ndryshime transformuese në fusha kyçe të rëndësishme për anëtarësimin e vendit në BE dhe arritjen e QZHQ-ve, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe qasjen në drejtësi, barazinë gjinore, sundimin e ligjit dhe kohezionin social. Politikat largpamëse dhe të drejtuara nga të dhënat u zhvilluan në një proces gjerësisht gjithëpërfshirës dhe transparent, duke angazhuar palët e interesuara relevante, veçanërisht njerëzit që kanë mbetur pas dhe të rinjtë. Si rezultat i kësaj, 11 politika

kombëtare dhe 113 ligje dhe akte nënligjore janë miratuar ose rishikuar në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

Ligji për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2024-2044 (SKZH) i miratuar me votë konsensuale në Kuvend, i hapi rrugën miratimit të SKZH-së. E zhvilluar brenda dy vitesh pas konsultimesh me një spektër të gjerë aktorësh dhe ekspertësh kombëtarë, SKZH-ja përcakton vizionin afatgjatë për një zhvillim të qëndrueshëm,



42 përfaqësues të pushtetit qendror dhe 277 të atij lokal u aftësuan për hartimin e politikave dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Fotografia: UN Women

gjithëpërfshirës, të gjelbër dhe transformues të vendit për njëzet vitet e ardhshme.

Ukrija struktura e menaxhimit të SKZH-së dhe u përgatit programi i parë për zbatimin e saj.

OKB-ja gjithashtu mbështeti zhvillimin dhe konsultimet për dy dokumente të rëndësishme të politikave - Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2023-2030 që bazohet në qasjen e bazuar në të drejtat dhe barazinë gjithëpërfshirëse, dhe Strategjinë e re Kombëtare për të Rinjtë 2023-2027 që promovon aktivizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje në mënyrë të përgjegjshme ndaj gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar.

OKB-ja promovoi angazhimin e Qeverisë, Kuvendit, Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe shoqërisë civile, për të kontribuar në ciklin e katërt të Rishikimit Periodik Universal të vendit. Për herë të parë, u organizuan konsultime të hapura dhe gjithëpërfshirëse duke përfshirë një spektër të gjerë palësh të interesuara, të cilat siguruan perspektiva dhe angazhime të ndryshme për të avancuar të drejtat e të gjithë njerëzve, duke rezultuar me një numër të shtuar të parashtrësave për RPU. OKB-ja gjithashtu mbështeti vizitën në vend të Procedurës Speciale për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në luftën kundër terrorizmit. Vazhduan të rriten aftësitë e partnerëve kombëtarë për t'u përfshirë në dhe për të ndjekur mekanizma të tjerë të të drejtave të njeriut. Duke përkujtuar Ditën e OKB-së dhe 75-vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Konferenca e katërt Vjetore e OKB-së mbledhi së bashku qeverinë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të bërë një vlerësim dhe për të diskutuar zgjidhjet për sfidat në lidhje me diskriminimin, dezinformimin, lajmet e rreme dhe gjuhën e urrejtjes që e dobësojnë barazinë dhe të drejtat e njeriut.

733 persona në qendrat e tranzitit dhe qendrën e azilkerkuesve morën këshillim dhe përfaqësim ligjor. U hartua një Udhëzues për ndihmën juridike falas të financuar nga shteti në procedurat e azilit, si dhe dy module bazë trajnimi për mbrojtjen e refugjatëve ndërkombëtarë për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët. Pesë ekupe të lëvizshme lokale kontaktuan me 562 njerëz të cenusëm në rrezik të trafikimit të qenieve njerëzore, duke kontribuar në identifikimin dhe ndihmën e katër viktimave dhe 39 viktimave të mundshme, kryesisht gra dhe vajza. Raporti i Vështrimeve të QZHQ për Maqedoninë e Veriut zbuloi tendencat e lidhura me

QZHQ-të për vendin, prioritetet e tij aktuale si dhe ndërlidhjet midis qëllimeve të ndryshme. Fuqizimi i grave dhe barazia gjinore mbetën në vend të lartë në agjendën e OKB-së. U miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024, së bashku me Profilin gjinor të vendit dhe Platformën e të dhënave gjinore që promovon të dhëna dhe analiza të ndara sipas gjinisë. 50 nëpunës administrativë i rritën kapacitetet e tyre për të integruar perspektivën gjinore në dokumentet e politikave që lidhen me BE-në në disa fusha specifike sektoriale. 42 përfaqësues të pushtetit qendror dhe 277 të atij lokal u aftësuan për hartimin e politikave dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Një qendër shtesë këshilluese për të mbijetuarit e DHBGJ-së u hap në Gostivar dhe u trajnuar policia lokale. Integrimi gjinor u intensifikua në praktikatat e auditimit duke u fokusuar në përfshirjen në punë të grave rurale dhe në decentralizimin.

Në fushën e drejtësisë u siguroi një mbrojtje më e fortë e fëmijëve në konflikt ose në kontakt me ligjin. Për të mbështetur reformën për drejtësinë për fëmijët, OKB-ja mbështeti një plan të ri veprimi dyvjeçar për zbatimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna 2020-2025. Në Kuvend u diskutua propozim-ligji për Drejtësinë për Fëmijët dhe analiza mbështetëse e shpenzimeve të tij. 69 profesionistë, duke përfshirë gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës të arsimit përmirësuan njohuritë e tyre mbi një qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve dhe që e merr parasysh traumën e përjetuar, ndërsa 100 profesionistë u trajnuan për riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e këtyre fëmijëve të cenusëm. Është bërë një vlerësim gjithëpërfshirës i kornizës ligjore kombëtare dhe kapaciteteve për drejtësinë ekologjike, veçanërisht në lidhje me të drejtat e grupeve të cenushme dhe prioritetet e përcaktuara që janë integruar në SKZH.

Përgjigja e drejtësisë penale ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit u përforcua për shkak të legjislacionit penal më të harmonizuar dhe praktikave gjyqësore, përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar, ngritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimit të përvojave. 340 profesionistë i rritën aftësitë e specializuara të nevojshme për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar krimet e rënda, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore në internet, krimet seksuale digjitale, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e emigrantëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, kontrollin e kufirit, armët e zjarrit të paligjshme, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e viktimave. PSO-të e reja përmirësuan regjistrimin, profilizimin dhe referimin në kufi.

Duke kontribuar në iniciativat e vendit kundër korrupsionit, OKB-ja ndihmoi në zhvillimin e Programit të parë Kundër Korrupsionit (2024-2025) për ndërmarrjet publike dhe subjektet tregtare. Mbi 400 nëpunës civilë dhe zyrtarë i ngritën kapacitetet e tyre për mbikëqyrjen, parandalimin e korrupsionit, integrimin gjinor dhe sigurinë kibernetike. Gazetarët u sensibilizuan për dezinformimin gjinor dhe Udhëzimet për integritetin e mediave.

Në bashkëpunim me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, OKB-ja vazhdoi të mbështesë kapacitetet e Sekretariatit për Çështjet Evropiane (SÇA) dhe digjitalizoi mjetin kryesor në mbështetje të negociatave për anëtarësim në BE – Programin Kombëtar për Miratimi e Legjislacionit të BE-së (Acquis Communautaire) - (PKML). Vëllimi i legjislacionit të Maqedonisë së Veriut është rritur për pesë herë në vitin 2023 krahasuar me vitin 2018. OKB-ja kontribuoi në hartimin e 16 ligjeve apo ndryshimeve të ligjeve dhe 87 rregulloreve apo akteve nënligjore. U ofrua mbështetje metodologjike për dy udhërrëfyesit për hapjen e grupit të parë - Udhërrëfyesi për Sundimin e Ligjit që përmban prioritetet për veprim për arritjen e përputhshmërisë së plotë në Kapitujt 23 dhe

24 dhe Udhërrëfyesi për Raportin e Administratës Publike. Efikasiteti fiskale dhe disiplina në mallrat dhe shërbimet publike u përmirësuan duke u bazuar në njohuritë e shtuara të 84 përfaqësuesve nga Ministria e Financave, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Enti Shtetëror i Revizionit.

144 palë të interesuara kombëtare i rritën njohuritë e tyre për politikën progresive, duke u bazuar në dëshmi dhe të dhëna. U bë një rillogaritje e vlerësimeve të përgjithshme të popullsisë ndërmjet dy rrethëve të fundit të regjistrimit të popullsisë, duke ofruar njohuri mbi ndryshimet demografike dhe ndikimin socio-ekonomik për 50 vitet e ardhshme. Rillogaritja e vlerësimeve të përgjithshme të popullsisë u bë përpara se të llogariteshin parashikimet e popullsisë. Gjithashtu, u bë rillogaritja e treguesve kryesorë statistikorë si PBB-ja për kokë banori, treguesit e bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore, treguesit e QZHQ-së. U hartua Strategjia e Politikave Demografike 2024-2044 dhe u pilotua Moduli i parë i Migracionit në Anketën e Fuqisë Punëtore duke ofruar baza për parashikime demografike. Rreth 170 përfaqësues të partnerëve kombëtarë mësuan për përfitimet e përdorimit të remitancave dhe të dhënave të mëdha si një burim të dhënash gjithëpërfshirës dhe novator. Rreth 200 përfaqësues të partnerëve qeveritarë dhe joqeveritar; u trajnuan për përdorimin e këtyre metodave inovative. Është rritur përdorimi i të dhënave që kanë të bëjnë me fëmijët që janë në kontakt me ligjin dhe fëmijët viktimë në institucionet e drejtësisë.

OKB-ja vazhdoi të mbështesë decentralizimin duke përmirësuar mjedisin ligjor, shërbimet digjitale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Si rezultat i kësaj, rekomandimet e BE-së për përmirësimin e kornizës normative dhe financiare për komunitetet lokale u integruan në Planin e Veprimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizimin për periudhën 2024-2026. Udhëzimet Metodologjike për Planin e Integruar të Zhvillimit Lokal u përafrauan me parimin e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së, duke theksuar ndjeshmërinë gjinore dhe planifikimin e integruar strategjik. Transformimi digjital është mbështetur me përgatitjen e Vlerësimit të Gatishmërisë Digjitale dhe Hendekut Digjital, i cili ofroi njohuri mbi gjendjen aktuale të gatishmërisë së institucioneve dhe fushat prioritare për ndërhyrje ose investim. Pesë komuna të tjera (gjithsej 24) tani përdorin bashkëpunimin ndërkomunal për të ofruar shërbime digjitale për mbi 470.000 njerëz. Pjesëmarrja e qytetarëve u rrit në dhjetë komuna, ku mbi 2.600 qytetarë u përfshinë në 40 forume në bashkësi. Gjithashtu, tre komuna të reja i institucionalizuan forumet në bashkësi si pjesë e statuteve të tyre. 1.150 këshilltarë dhe palë të tjera të interesuara kishin qasje në platformën për mesim elektronik. Përveç

34 komunave të mëparshme, 10 komuna të tjera i rritën transparencën dhe llogaridhënien e tyre me zgjidhje të TI-së. U forcuar kapacitetet e 36 OSHC-ve për mbikëqyrjen e pushtetit lokal dhe zbatimin e projekteve.

Duke bashkëpunuar me komunitetet lokale, të rinjtë dhe organizatat lokale, OKB-ja kontribuoi në forcimin e kohezionit social dhe narrativeve pozitive. U mbështetën katër këshilla rinore komunale, ndërsa dhjetë iniciativa lokale inkurajuan pjesëmarrjen e të rinjve dhe narrativet konstruktive. 1.500 gra u fuqizuan për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vendimmarrje në nivelin lokal. OKB-ja punoi ngushtë me tetë vetëqeverisje lokale dhe OSHC në 30 projekte për grupet e cenushme që promovojnë gratë në turizmin rural, digjitalizimin dhe përfshirjen e të rinjve në mbrojtjen e mjedisit jetësor. OKB-ja bashkëpunoi me pesë OSHC për të avancuar dialogun ndëretnik dhe zgjidhjen e konflikteve. Për më tepër, OKB-ja mbështeti iniciativat e shumta rinore kundër dhunës, ngacmimit kibernetik, dezinformimit, keqinformimit dhe gjuhës së urrejtjes. Këto iniciativa u zhvilluan në shkolla, media sociale, në ngjarjen "Fëmijët 'pushtojnë' Kuvendin" dhe platforma të tjera lokale. Narrativet pozitive ndaj refugjatëve, njerëzve pa shtetësi dhe personave të tjerë të cenusshëm u promovuan nga storjet e gazetarëve të rinj dhe artistëve të njohur që kanë ndryshuar qëndrimet e publikut për përfshirjen e tyre në shoqëri.



Dhjetë komuna të tjera (gjithsej 24) tani përdorin bashkëpunimin ndërkomunal për të ofruar shërbime digjitale për mbi 470.000 njerëz. Fotografia: UNDP

Financimi i QZHQ-ve dhe partneritetet

OKB-ja zbatoi disa ndërhyrje në lidhje me rritjen e financimit të QZHQ-ve në vitin 2023, si nga burimet publike ashtu edhe nga ato private, dhe forcoi partneritetet me aktorë të ndryshëm.

Për sa i përket financimit të QZHQ-ve, përpjekjet e OKB-së në vitin 2023 u fokusuan në: i) optimizimin e shpërndarjes së financave publike drejt QZHQ-ve, nëpërmjet integritetit të QZHQ-ve në buxhetim dhe forcimit të transparencës buxhetore, ii) futjen e instrumenteve financiare novatore për të nxitur financat private; dhe iii) rritjen e transparencës së rrjedhave financiare private dhe reduktimin e evazionit fiskal.

Për të përafuar më tej financat publike në nivel kombëtar me QZHQ-të, kanë filluar diskutimet për një Kornizë të integruar të Financimit në Strategjinë njëzet-vjeçare Kombëtare të Zhvillimit me ekspertë dhe hartues të politikave si pjesë e procesit të përgatitjes së SKZH-së. Korniza e Integruar e Financimit e SKZH-së duhet të ofrojë udhëzime për qasjet e financimit për ofrimin optimal të SKZH-së, duke përfshirë përdorimin e synuar të burimeve novatore të financimit. Më tej, masat institucionale sistematike për integrimin e financimit për QZHQ 5 ose buxhetimin e përgjegjshëm gjinor u mbështetën nga OKB-ja. U miratuan aktet nënligjore për themelimin e Qendrës së parë Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor si njësi e veçantë organizative në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Gjithashtu, si pjesë e reformës së menaxhimit të financave publike, Ministria e Financave hartoi një akt nënligjor për aplikimin sistematik të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në buxhetin e shtetit dhe 13 ministri të linjës dhe tetë agjenci shtetërore kanë krijuar programe sektoriale.

U forcuan kapacitetet e Entit Shtetëror të Revizionit për QZHQ, për t'i shpenzuar paratë për diçka që ia vlen dhe për revizionin gjinor. Si rezultat i kësaj u përgatit Revizioni i parë i QZHQ-ve në vend. Një revizion i thelluar specifik gjinor i QZHQ 5 u krye nga Enti Shtetëror i Revizionit në partneritet me OKB-në, me fokus tematik në përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, një komponent i objektivit 5.4 të QZHQ-së dhe një çështje kyçe në rajon. Për më tepër, OKB-ja mbështeti aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për Entit Shtetëror të Revizionit mbi praktikën e revizionit, revizionet për shpenzimet e parave për diçka që ia vlen dhe revizionin e QZHQ-ve. OKB-ja gjithashtu lehtësoi miratimin e Strategjisë së Kontabilitetit Aktual dhe Planit të Veprimit (2023-2027) dhe ngritjen e fuqishme të kapaciteteve për këtë gjë. Strategjia e Kontabilitetit Aktual ofron një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për kalimin në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit aktual, rritjen e transparencës financiare dhe rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies në menaxhimin e buxhetit. Këto aktivitete janë hapa të rëndësishëm në sigurimin e mbikëqyrjes efektive të shpenzimeve publike dhe forcimin e llogaridhënies së institucioneve për avancimin e QZHQ-ve. OKB-ja e mbështeti vendin me disa iniciativa drejt përmirësimit të cilësisë dhe transparencës së financimit për komunat, si dhe përgjegjshmërisë gjinore. Së pari, Ministria e Financave u mbështet nga OKB-ja në zhvillimin e Kriterëve të përmirësuar për ndarjen e fondeve nga buxhetet qendrore në ato lokale (dotacionet bllok dhe ato kapitale), e po ashtu u mbështetën Raportet e rregullta për Decentralizimin Fiskal. Synimi i Kriterëve të propozuara është përmirësimi i shpërndarjes transparente dhe efikase të fondeve për komunat dhe rritja e buxhetimit të programeve për financim më të synuar të prioriteteve të zhvillimit lokal. Për më tepër, zyrtarët dhe punonjësit komunalë, duke përfshirë kryetarët e komunave, u trajnuan për menaxhimin efektiv të financave publike transparencën dhe standardet e llogaridhënies, planifikimin e

buxhetit dhe ekzekutimin e buxhetit. Së dyti, në vitin 2023, dhjetë komuna të reja (gjithsej 56 nga 81) filluan të raportojnë përmes e-Tabelës me të dhëna për Ekzekutimin e Buxhetit Komunal – një mjet transparence i OKB-së i disponueshëm përmes ueb-faqes së Ministrisë së Financave. Së treti, iniciativat e përgjegjshme gjinore u përfshinë në buxhetet komunale, përmes miratimit të dokumenteve strategjike përkatëse në shtatë komuna dhe krijimit të 89 programeve sektoriale komunale.

Për të rritur vëllimin e rrjedhave të financimit të disponueshme për QZHQ-të, OKB-ja gjithashtu mbështeti masat për reduktimin e evazionit tatimor, me fokus në reduktimin e pagesave me para në dorë dhe ekonominë informale dhe përmirësimin e çmimeve të transferimeve. Një Plan Strategjik për të Minimizuar Pagesat me Para në Dorë u mbështet nga OKB-ja, që promovon metodat e pagesave digjitale dhe transparente. OKB-ja punon gjithashtu në forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave për monitorimin dhe zbulimin e ekonomisë informale (duke përfshirë matjen e ekonomisë informale) dhe përforcimin e mekanizmave kontrollues. Ngritja e vetëdijes së publikut për ekonominë informale u bë përmes ueb-faqes www.vnesiboja.mk. Drejtoria e të Ardhurave Publike u mbështet për të publikuar raportet e saj të para të çmimeve të transferimit për tre kompani ndërkombëtare. Një Propozim-ligj i ri për Këmbimin Automatik për Qëllime Tatimore u përgatit nga Ministria e Financave me mbështetjen e OKB-së.

Për sa i përket partneriteteve, OKB-ja vazhdoi përfshirjen e gjerë të grupeve të ndryshme të palëve të interesuara, me iniciativa konkrete për forcimin e mëtejshëm të partneriteteve me të rinjtë dhe sektorin privat. Për angazhimin më të madh të të rinjve nga qeveria, OKB-ja mbështeti përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë 2023-2027. Më shumë se 1.000 të rinj dhe aktorë të lidhur me të rinjtë nga i gjithë vendi morën pjesë në përgatitjen e Strategjisë. U krijuar një Grup Rinor në kuadër të Ekipit të Kombeve të Bashkuar në vend (UNCT) për koordinim të brendshëm dhe u mor vendim për krijimin e një Grupi konsultativ rinor të OKB-së për konsultim sistematik të të rinjve nga UNCT-ja. Të dy Grupet duhet të mundësojnë një angazhim të përfunduar dhe sistematik të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në integrimin e të rinjve dhe përbushjen e Strategjisë së OKB-së për të rinjtë 2030. Më tej, u krijuan partneritete me disa partnerë të rinj të sektorit privat, duke përfshirë kompanitë nga sektori farmaceutik, ndërtimor dhe bankar. Gjithashtu, OKB-ja organizoi konsultimin e rregullt vjetor për KBZHQ-në me partnerët relevantë qeveritarë, të organizatave të shoqërisë civile dhe ndërkombëtarë (Punëtorja vjetore e OKB-së për Planin e Përbashkët të Punës për Palët e Interesuara), në të cilën u diskutua edhe Rishikimi Afatmesëm i KBZHQ-së 2021-2025.



Për sa i përket shfrytëzimit të financimit të QZHQ-ve përmes financave inovative, në vitin 2023 Fondi i Financimit të Gjelbër (FFGJ) filloi të japë kredi për NVM-të nëpërmjet bankave dhe një kompanie për dhënie me qira (leasing). FFGJ është një instrument financiar që ndërthur financime nga Qeveria, institucionet financiare ndërkombëtare, stitucionet financiare private dhe nga partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet një fondi global mirëbesimi me shumë qëllime që synon të përshpejtojë arrijten e gjashtë QZHQ-ve (QZHQ-të 5, 7, 10, 11 dhe 13). Fotografia: UNDP

Koherenca, efektiviteti dhe efikasiteti i OKB-së

Në partneritet të fortë me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në vitin 2023, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut vazhdoi zbatimin e reformës së sistemit të zhvillimit të OKB-së, u fokusua në arritjen e koherencës, efektivitetit dhe efikasitetit më të madh të punës së saj në vend, përmes planifikimit, monitorimit dhe raportimit të përbashkët të koordinuar.

Harmonizimi dhe koherenca programore

Instrumentet kryesore për të funksionalizuar KBZHQ-në në një mënyrë koherente janë Planet e Përbashkëta të Punës të bazuara në rezultate, të fokusuara në veprimin kolektiv të OKB-së drejt rezultateve dhe qëllimeve të përbashkëta të subjekteve të saj. Plani i tretë vjetor i Maqedonisë së Veriut u zhvillua në praktikën e krijuar të konsultimit kuptimplotë me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe u rishikua gjatë vitit.

Përveç kësaj, Ekipi i Kombeve të Bashkuara i vendit (UNCT) kreu një rishikim afatmesëm të zbatimit të KBZHQ-së duke përfshirë një vlerësim të treguesve, dhe i cili arriti në përfundimin se, përkundër ndikimit të fortë nga krizat pasuese dhe mungesës së qasjes në të dhëna cilësore, KBZHQ-ja mbetet e vlefshme dhe e rëndësishme, dhe zbatimi duhet të vazhdojë pa ndryshime të rezultateve dhe me vetëm disa përmirësime të mundshme. Për më tepër, në gjysmën e parë të vitit, UNCT-ja dorëzoi raportin e vitit 2022 për 28 tregues globalë nga korniza për matjen e kontributit të OKB-së në arritjet e QZHQ-ve, gjë që e bëri Maqedoninë e Veriut të jetë në mesin e 20 adoptuesve të hershëm të UNCT-ve, pasqyrat e shkurta të të cilëve u prezantuan në ECOSOC 2023.

Përpjekjet e përkushtuara për të zhvilluar programe të përbashkëta të agjencive të shumta të OKB-së, vazhduan me gjashtë programe të përbashkëta që ishin në zbatim gjatë vitit 2023, duke përfshirë financat e gjelbra, sipërmarrjen e gjelbër, të rinjtë dhe kohezionin social në rajon, politikën e migracionit, fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar dhe përgjigjen e politikave ndaj kriza të shumta. Edhe pse nuk ishte një projekt i përbashkët formal, ndihma e OKB-së për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2024-2044 përmes një procesi konsultativ dhe largpamës, demonstroi një bashkëpunim të fortë të subjekteve të OKB-së në një mënyrë koherente për aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të vendit.



Transparenca dhe llogaridhënia

Përshkrimi i Planeve të Përbashkëta të Punës dhe një tabelë e detajuar me të gjitha detajet operative, jo vetëm që u ndanë me partnerët, por edhe u publikuan në ueb-faqen e OKB-së, duke kontribuar për një transparencë më të madhe të punës së OKB-së dhe një koordinim më të mirë me partnerët. Përveç kësaj, OKB-ja përgatiti dhe publikoi ndryshimet dhe zhvillimet kryesore kontekstuale që shërbejnë si udhërrëfyes për planet e përbashkëta të punës së OKB-së dhe si burim për hartimin e politikave kombëtare (Përditësimi i Analizës së Përbashkët të Vëndit 2023).

Informacioni për kornizën e financimit – kyç për llogaridhënien dhe transparencën e OKB-së përmes ofrimit të një referimi të vetëm dhe pasqyrës së situatës së financimit të KBZHQ-së dhe burimeve financiare të nevojshme, të disponueshme dhe të parashikuara, duke përfshirë shumën, burimin, kohëzgjatjen dhe sekuencën – vazhdoi të mblidhej dhe përfshihej rregullisht në Planet e Përbashkëta të Punës në vitin 2023. Janë investuar përpjekje të konsiderueshme për të siguruar cilësinë e të dhënave financiare, kontrollin e kryqëzuar dhe vërtetimin brenda OKB-së dhe me të gjithë donatorët.

Përditësimet e rregullta mbi punën, aktivitetet dhe rezultatet e arritura sigurohen përmes ueb-faqes së OKB-së (<https://northmacedonia.un.org>) dhe mediave sociale, si dhe përmes Buletinit të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili është një bulletin tremujor, që u dërgohet mbi 2.000 partnerëve.

Përveç kësaj, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut gjithashtu vazhdoi të forcojë përhapjen e UN-INFO, si platformë kryesore digjitale e UNCT-së për planifikimin, monitorimin dhe raportimin në internet mbi kornizat e rezultateve të përbashkëta, strategjitë dhe mjetet e tjera të koordinimit operacional. UN-Info u promovua gjithashtu si një "pikë e përbashkët" ku ofrohen të gjithë informatat mbi punën e OKB-së në vend, e disponueshme në ueb-faqen e përbashkët të OKB-së në vend.

Qeverisja e përbashkët dhe koordinimi

Struktura e brendshme e qeverisjes së KBZHQ-së, e efektshme dhe e rregulluar, vazhdoi të rrisë koherencën dhe përfundimin e punës së OKB-së përgjatë rezultateve dhe mandateve të KBZHQ-së, si dhe zbatimin në nivel vendi të reformës së Sistemit të Zhvillimit të OKB-së, duke mbështetur gjithashtu proceset globale si Samitin e QZHQ 2023. Në mars të vitit 2023, Komiteti i Përbashkët Drejtues (KPD) ofroi udhëzime strategjike dhe miratoi Planet e Përbashkëta të Punës 2023. Kjo u pasua me ndërveprim dhe koordinim të vazhdueshëm dhe të rregullt dypalësh dhe shumëpalësh ndërmjet subjekteve të OKB-së dhe ministrive dhe institucioneve të tjera partnere.



Duke përkujtuar Ditën e OKB-së dhe 75-vjetorin e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, Konferenca e katërt Vjetore e OKB-së mbledhi së bashku qeverinë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të bërë një vlerësim dhe për të diskutuar zgjidhjet për sfidat në lidhje me diskriminim, dezinformim, lajmet e rreme dhe gjuhën e urrejtjes që e dobësojnë barazinë dhe të drejtat e njeriut. Fotografia: UN RCO

Katër Grupet e Rezultateve të KBZHQ (GR), me përfaqësues të subjekteve në nivel teknik vazhduan të planifikojnë dhe të monitorojnë në mënyrë aktive rezultatet e KBZHQ-së, duke siguruar koordinim teknik, koherencë, rëndësi dhe efektivitet në bashkëpunim me palët e interesuara. E përbërë nga punonjës të lartë të programit, Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) ofroi një mekanizëm të brendshëm të sigurimit të cilësisë për zbatimin dhe monitorimin e KBZHQ-së dhe siguroi komente cilësore për zbatimin e KBZHQ-së për Ekipi e Kombeve të Bashkuara në vend dhe këshilla për mundësitë dhe sfidat në mjedisin lokal dhe rajonal në zhvillim. Grupi i Komunikimit, Grupi i Menaxhimit, Vlerësimi dhe Mësimi dhe grupet e shumta tematike të brendshme e pasuruan këtë këshillë dhe ofruan mundësi për mësim, zhvillim dhe avokim të përbashkët gjatë gjithë vitit, duke përfshirë konsultimet dhe raportin e RPU-së, si dhe Kartën e Rezultateve të Barazisë Gjinore të SWAP.

Si mekanizmi kryesor i OKB-së në vend për koordinimin dhe vendimmarrjen ndërmjet agjencive, UNCT-ja, e udhëhequr nga Koordinatorin e Përhershëm (KP), mbeti shtylla kryesore për harmonizimin e punës së OKB-së në vend, duke dhënë udhëzime strategjike dhe operacionale për zhvillimin në Maqedoninë e Veriut, pavarësisht nga prania e tyre fizike në vend. Roli udhëheqës i KP-së të OKB-së u forcua me mbështetjen aktive për reformën e sistemit të zhvillimit të OKB-së nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, dhe mbështetjen politike dhe burimet e investuara globalisht nga donatorët që nga viti 2019, duke përfshirë përmes Fondit të Mirëbesimit të OKB-së për Qëllime të Veçanta.

Avokimi i përbashkët

Përpjekjet për të rritur rezultatet e komunikimit u përqendruan në rritjen e aktiviteteve të përbashkëta të avokimit dhe komunikimit me publikun brenda familjes së OKB-së, si dhe së bashku me partnerët kryesorë të zhvillimit. Gjatë vitit 2023, u organizuan një numër dukshëm më i madh i iniciativave të përbashkëta avokuese, krahas fushatave të rregullta, si 16 Ditët e Aktivizmit Kundër

– Dhunës me Bazë Gjinore.

U krijuan mekanizma të përmirësuar koordinimi me takimet mujore të Grupit të Komunikimit të OKB-së (UNCG) dhe takimet tremujore të UNCG-së me kolegët e komunikimit nga partnerët e zhvillimit.

Për të forcuar më tej bashkëpunimin dhe koordinimin me Delegacionin e BE-së, u organizua një takim i përbashkët rajonal i komunikimit në Shkup, ku morën pjesë zyrtarë komunikimi nga OKB-ja dhe delegacionet e BE-së nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Për të rritur dukshmërinë e OKB-së dhe për ta sjellë punën e saj më pranë njerëzve, vazhdoi të mbështetet në rrëfimin e aktiviteteve në ueb-faqen e përbashkët të OKB-së në vend (<https://northmacedonia.un.org>), mediat sociale, Buletinin e Zhvillimit të Qëndrueshëm në internet, që shpërndahet rregullisht deri në më shumë se 2.500 abonentë. Komunikimet u forcuan ndjeshëm gjatë shënimit të ditës së OKB-së, e cila këtë vit përfshinte Konferencën Vjetore të OKB-së, një ekspozitë me vizatime të fëmijëve dhe një pritje formale, të gjitha të fokusuar në të drejtat e njeriut (duke marrë parasysh 75-vjetorin e Konventës për të Drejtat e Njeriut)

Organizata e Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e pranisë dhe shtrirjes së saj në mediat sociale në vitin 2023, duke rritur bazën e fansave në Facebook dhe Twitter për më shumë se 8% në nivel vjetor.

Efikasiteti

I përfaqësuar plotësisht nga agjencitë e OKB-së me prezencë operacionale në vend, Ekipi i Menaxhimit të Operacioneve (OMT), udhëhoqi Agjendën globale të Efikasitetit të OKB-së, e fokusuar në Strategjinë e Operacioneve të Biznesit (BOS) 2.0, me të cilën vlerësohet se do të kursehen

1,3 milion dollarë amerikanë përmes eliminimit të shpenzimeve të transaksionit, kursimit të kohës së stafit dhe përfitimit nga ekonomitë e shkallës gjatë një periudhe pesëvjeçare.

Në vitin 2023, iniciativat kryesore të OMT-së përfshinin: shfrytëzimin e rezultateve të vlerësimit të qasshmërisë për të përmirësuar organizimin e ngjarjeve; inicimin e diskutimeve për çmimet e përkthyesve të gjuhës së shenjave për të përshpejtuar krijimin e ngjarjeve gjithëpërfshirëse; eksplorimin e prokurimit të përbashkët të pajisjeve të evakuimit për të përmirësuar qasshmërinë e brendshme.

Përmirësimi i ndjeshëm i pjesëmarrjes në takimet e OMT-së, çoi në një koordinim më të mirë dhe rritje të efikasitetit në përbashkët dhe detyrave si anketa DSA, Rishikimi i ambienteve të përbashkëta, Analiza e barazisë gjinore dhe menaxhimi më i mirë i proceseve të prokurimit. Organizimi fleksibël i punës dhe puna nga distanca vazhduan në raste të caktuara, të shoqëruara me kthimin në zyrë. Në fund të vitit 2022, fuqia punëtore rezidente e OKB-së në Maqedoninë e Veriut përbëhej nga një personel prej 320 të punësuarish kombëtarë dhe ndërkombëtarë – 57% gra dhe 43% burra.

Vlerësimi dhe mësimet e nxjerra

Rishikimi afatmesëm i KBZHQ-së (MTR)

Në periudhën nga fundi i prillit deri në fund të qershorit të vitit 2023, grupet qeverisëse të KBZHQ-së: EMP-ja, katër Grupet e rezultateve dhe grupi MEL, i mbështetur nga ekipi i ZKP-së, kryen një vetëvlerësim afatmesëm mbi zbatimin e KBZHQ-së 2021-25.

Gjetjet kryesore:

KBZHQ 2021-2025 u hartua në fillim të pandemisë së COVID-19 dhe u zbatua kryesisht në një kontekst të krizave të ndërlidhura globale dhe rajonale që ndikuan rëndë në progresin e qëndrueshëm të zhvillimit të vendit deri në vitin 2020 dhe në disa nga fushat e rezultateve të KBZHQ-së.

Duke pasur parasysh mungesën e konsiderueshme të të dhënave dhe ndikimin nga faktorë të jashtëm p.sh. të dhënat e punës në kontekstin e emigrimit të fortë jashtë vendit, vlerësimi i treguesve duhet parë vetëm si një tregues se ku ndodhet vendi në listën e përzgjedhur të treguesve, duke ofruar një bazë të mirë për diskutim dhe programim të mëtejshëm.

Me 124 milionë dollarë nga 178 milionë dollarët e kërkuar në fund të vitit 2022, mobilizimi i burimeve për KBZHQ-në është i kënaqshëm, me probabilitet të mirë që mbi 90% e burimeve të kërkuara për periudhën pesëvjeçare të KBZHQ-së do të mobilizohen deri në vitin 2025. Përpjekjet e mëtejshme për mobilizimin e burimeve do të ishin të rëndësishme në Rezultatet 2 dhe 3. Për sa i përket cilësisë së financimit, burimet e financimit u diversifikuan nëpërmjet rritjes së bashkëfinancimit të qeverisë dhe financimit nga fondit me shumë partnerë.

Në përgjithësi, ka progres pozitiv në të katër fushat e rezultateve, por secila me një ritëm të ndryshëm. Konkretisht:

Prosperiteti gjithëpërfshirës – ka të ngjarë të arrijë rezultatet e pritura, madje edhe kur standardi i jetesës është nën presion

për shkak të krizës ekonomike, inflacionit kanosës dhe pasigurisë për shkak të luftës në Ukrainë.

Shërbimet cilësore për të gjithë – ka të ngjarë të arrijë pjesërisht rezultatet e pritura, duke qenë fusha që ka vuajtur ndjeshëm nga krizat e ndërlidhura.

Mjedisi jetësor i shëndetshëm – me mundësi të mirë për të arritur pjesërisht rezultatet e pritura, pavarësisht nga konteksti i pafavorshëm/supozimet e ndryshuara për shkak të krizave.

Qeverisja e mirë - ka të ngjarë të arrijë rezultatet e pritura, me disa nën-rezultate që ngecin. Pavarësisht fillimit të procesit të shqyrtimit të anëtarësimit në BE, vonesat dhe lëshimet e mëparshme të rëndësishme të pritshme nga vendi, intensifikuan polarizimin politik dhe ulën mbështetjen e përgjithshme për anëtarësimin në BE.


Mësimet e nxjerra

KBZHQ-ja është e vlefshme dhe e rëndësishme, zbatimi duhet të vazhdojë pa ndryshime të rezultateve, me disa përshtatje të mundshme:

- Disa nga rezultatet mund të përfitojnë nga përmirësimi i mëtejshëm i formulimit, nëse grupet e Rezultateve arrijnë në përfundimin se kjo do të ishte në dobi të planifikimit të përbashkët të punës për dy vitet e mbetura. Të miratohet bashkimi i rezultatit 4.5 në 4.1

- Të konsiderohen disa tregues shtesë të rezultateve për fushat ku mungojnë tregues të matshëm për të kontribuar në progresin e KBZHQ-së.

- Të tërhiqet vëmendja e Komitetit të Përbashkët Drejtues për diskutimin për MTR dhe temat relevante dhe të tërhiqet vëmendje e përkatëse në vëmendjen e partnerëve kombëtarë për diskutime të thelluara gjatë punëtorive JWP 2024/APR që do të mbahen në tetor. Të identifikohen fushat për punë të përbashkët që potencialisht mund të përshpejtojnë arritjen e rezultateve.



Financimi dhe mobilizimi i burimeve

Pasqyra financiare

Në vitin 2022, 32,4 milionë dollarë u vunë në dispozicion të OKB-së në Maqedoninë e Veriut, nga të cilat 30,5 milionë dollarë u shpenzuan, duke rezultuar me shkallën e realizimit prej 94%. Duke parë rezultatet e KBZHQ-së, qeverisja e mirë (11,6 milionë dollarë të shpenzuar) dhe mjedisi i jetësor i shëndetshëm (9,5 milionë dollarë) ishin më intensive në aspekt të burimeve, të ndjekura nga prosperiteti gjithëpërfshirës (6,0 milionë dollarë) dhe shërbimet cilësore për të gjithë (3,3 milionë dollarë).


OKB-ja mobilizoi me sukses 72% të burimeve të kërkuara (të buxhetuara) për vitin e tretë të KBZHQ-së, duke mundur zbatimin e papenguar, krahasuar me planifikimin në fillim të vitit. Mjetet financiare për zbatimin e aktiviteteve të OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023 u pranuan nga 32 burime.

Pjesa më e madhe e mjeteve financiare në dispozicion u pranuan në formën e financimit të projekteve dhe programeve specifike (46%), të ndjekura nga fondet e bashkuara (17%), financimi i qeverisë (17%) dhe financimi bazë (16%), dhe nga fondet tematike (2%) dhe vertikale (2%).


Dhjetë burimet kryesore të financimit jo-thelbësor/jo-tematik në bazë të shpenzimeve në vitin 2022 për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut ishin Maqedonia e Veriut, Bashkimi Evropian, Zvicra, Suedia, Fondi i Përbashkët i QZHQ-së, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Fondi i Mirëbesimit me Shumë Partnerë për Udhërrëfyesin për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor, Fondi i Mirëbesimit me Shumë Partnerë për Migracionin dhe Norvegjia.

Burimet e kërkuara dhe në dispozicion, dhe shpenzimet në vitin 2023

Të dhënat e datës 9 mars 2024, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2023, në miliona \$




2023 expenditures per UN entity



Shpenzimet në vitin 2023 sipas burimit të financimit

Të dhënat e datës 9 mars 2024, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2023, në miliona \$



Burimi: OKB në Maqedoninë e Veriut 2024. Mjete financiare në dispozicion dhe shpenzimet bazohen në agjencitë e OKB-së; informacioni nga sistemi financiar ose nga pasqyrat financiare deri më 9 mars të vitit 2024. Duke pasur parasysh ciklin e mëvonshëm të raportimit financiar që përfundon në mars, shpenzimet e UNHCR-së për vitin 2023 janë llogaritur që nga nëntori i vitit 2023.

Mobilizimi i burimeve

Strategjia e Mobilizimit të Burimeve dhe Partneritetit (SMBP) e KBZhQ-së, i përvijon objektivat e Ekipit të OKB-së në mobilizimin e përbashkët të burimeve dhe partneriteteve dhe e përcakton fokusin e aktiviteteve dhe qasjet për të siguruar një qasje më koherente, më të efektshme dhe transparente. Për mobilizimin e burimeve, u përcaktuan katër objektiva sasiore dhe dy qasje. Më poshtë është dhënë raportimi mbi progresin në arritjen e këtyre objektivave për KBZhQ-në për periudhën 2021 – 2025, deri në fundin e vitit të tretë.

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut është kryesisht në rrugën e duhur në mobilizimin e mjeteve të nevojshme financiare për përmbushjen e rezultateve të planifikuara sipas KBZhQ-së 2021-2025 (Objektivi 1 i SMBP-së). Në fund të vitit 2022, 150,3 milionë dollarë ishin në dispozicion për aktivitete në periudhën pesëvjeçare, ose 84% e financimit të kërkuar prej 178,2 milionë dollarësh. Në nivel vjetor, 72% e resurseve të kërkuara për vitin 2022 janë mobilizuar dhe janë vënë në dispozicion, ndërsa 58% e burimeve të kërkuara për vitin 2024 janë mobilizuar para fillimit të vitit. Për kohëzgjatjen pesëvjeçare të KBZhQ-së, mbetet për t'u mobilizuar një boshllëk i përgjithshëm i financimit prej 27,9 milionë ose 16% e financimit të përgjithshëm të kërkuar.


Për sa i përket cilësisë së financimit/përzjerjes së financimit, shumica e mjeteve që janë marrë deri më tani janë në formën e burimeve jo-thelbësore (133,3 milionë dollarë, 89%). Në mesin e burimeve jo-thelbësore të financimit, shumica e kontributeve vijnë nga financimi i projekteve dhe programeve specifike (54%), i ndjekur nga fondet qeveritare (16%), fondet e bashkuara (9%), fondet vertikale (6%), fondet tematike (4%) dhe fondet simbolike të sektorit privat (më pak se 1%). OKB-ja tashmë ka arritur ta rrisë bashkë-financimin e qeverisë dhe fondet e bashkuara dhe ato

vertikale dhe ta zvogëlojë mbështetjen në financimin e projekteve dhe programeve të caktuara, duke rezultuar në një përzjerje të përmirësuar të financimit. Në fund të vitit 2022, 10 burimet kryesore të financimit jo-thelbësor për periudhën 2021-2025 ishin Bashkimi Evropian, Maqedonia e Veriut, Zvicra, Suedia, Fondi i Përbashkët i QZhQ-së, Mbretëria e Bashkuar, Fondi Global i Mjedisit Jetësor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Norvegjia dhe Fondi i Përshtatjes.

OKB-ja e Maqedonisë së Veriut vazhdoi punën e saj të përkushtuar për mobilizimin e burimeve për programim të përbashkët (me shumë agjenci). Me 7 programe të përbashkëta të financuara deri më sot në kuadër të KBZhQ-së 2021-2025, ajo tashmë ka arritur synimin kumulativ pesë-vjeçar të përcaktuar sipas Objektivit 3 të SMBP-së. Për sa i përket koncepteve të reja në vitin 2023, u zhvilluan katër koncepte për programe të përbashkëta (dy në lidhje me sigurinë njerëzore, një për paqen dhe të drejtat e njeriut/të rinjtë dhe një për gatishmërinë dhe reagimin ndaj pandemive), duke rritur numrin kumulativ për periudhën 2021-2025 të koncept ideve të zhvilluara për programe të përbashkëta në 13. Asnjë program i ri i përbashkët nuk u financua/filloi në vitin 2023. Kjo pasqyron disponueshmërinë më të kufizuar të fondeve për programe të përbashkëta, veçanërisht për sa i përket numrit dukshëm më të vogël të thirrjeve të hapura nga fondet e mirëbesimit me shumë partnerë. Ndër gjashtë programet e përbashkëta të zbatuara, dy ishin programe specifike për të rinjtë me fonde të shfrytëzuara prej 0,48 milionë dollarë amerikanë për të rinjtë në vitin 2023. Integrimi i aspekteve të gjinisë dhe të aftësisë së kufizuar sigurohet brenda gjithë programeve të përbashkëta, me kontribut të rëndësishëm në këto tema.


Burimet e kërkuara dhe në dispozicion për KBZhQ-në 2021-2025

Të dhënat e datës 9 mars 2024, për periudhën 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2025, në miliona \$



Fondet e mobilizuara për periudhën 2021-2025 sipas modalitetit të financimit dhe burimit të financimit

Të dhënat e datës 9 mars 2024, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor të vitit 2023, në miliona \$



Burimi: OKB në Maqedoninë e Veriut, 2024; Mjetet financiare në dispozicion dhe shpenzimet bazohen në agjencitë e OKB-së; informacioni nga sistemi financiar ose nga pasqyrat financiare deri më 9 mars të vitit 2024

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023

Në vitin 2024, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do të veprojë në kuadër të Planeve të Përbashkëta të Punës të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Në të katër rezultatet, ndërhyrjet e OKB-së do të jenë të lidhura fort me një ose më shumë nga gjashtë fushat e tranzicionit, me fokus të fortë në parimin për të mos lënë askënd pas, si gur themel i angazhimit të OKB-së.

Për të rritur prosperitetin gjithëpërfshirës, OKB-ja do të vazhdojë të ndihmojë Qeverinë për të krijuar vende pune dhe për të reduktuar papunësinë duke rritur modernizimin, qëndrueshmërinë dhe konkurrencën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke përfshirë sektorët kulturorë dhe kreativë dhe duke u bazuar në tranzicionin drejtë dhe ekonominë rrethore. Si kusht paraprak, OKB-ja do të rrisë shkaktësitë dhe aftësitë për punësim të grupeve të cenueshme, si të rinjtë dhe njerëzit që e kanë të vështirë për t'u punësuar me fokus tek gratë, përmes zbatimit të Garancisë për të Rinjtë, masave aktive të tregut të punës, modeleve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe reformës sociale për njerëzit me aftësi të kufizuara. Mjedisi i punës, rregulloret dhe shërbimet e përgjegjshme ndaj gjinisë dhe progresive do të përmirësohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së, duke favorizuar rritjen e gjelbër, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe nevojat e tregut në të ardhmen, duke eksploruar gjithashtu modele alternative për punësim transformues. Në dritën e emigrimit të fortë, OKB-ja do të vazhdojë të mbështesë iniciativat për angazhim produktiv të diasporës në vend. Puna për menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe konsolidimin e tokës do të vazhdojë, duke përfshirë gjininë në politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural, duke përfshirë strategjinë kombëtare për transformimin digjital të sektorit bujqësor.

Për të trajtuar erozionin e kapitalit njerëzor, OKB-ja do të mbështesë aktivitetet në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes sociale. Në mënyrë të veçantë, OKB-ja do të trajtojë barazinë shëndetësore, do të përmirësojë aspektet shëndetësore në arsim dhe do të mbështesë zhvillimin e politikave shëndetësore, duke përfshirë reformën e shëndetit parësor, strategjinë kombëtare të fuqisë punëtore, programet për të moshuarit, shëndetin e nënave dhe të porsalindurve. Plan-programet e shkollave fillore dhe rregulloret për shkollat e mesme do të forcohen dhe nxënësit do të sensibilizohen për dhunën me bazë gjinore, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe aftësitë e kufizuara. Do të përmirësohet edukimi digjital dhe produktet e të mësuarit digjital, ndërkohë që do të forcohet mbrojtja në internet për fëmijët, kohezioni social dhe përfshirja e komunitetit në shkolla. Mësuesit dhe stafi i shkollës në arsimin (para)shkollor do të aftësohen duke përfshirë edhe për mirëqenien mendore, mbështetjen e refugjatëve, azilkerkuesve dhe emigrantëve të cenueshëm. Me ndihmën e OKB-së në vitin 2024 janë planifikuar të miratohen qasje që i marrin parasysh rreziqet dhe reagimet ndaj situatave emergjente, si dhe zbatimi i plotë i sistemit të vlerësimit funksional i bazuar në KNF për fëmijët dhe të rinjtë. Sistemi i kujdesit ndaj fëmijëve, duke përfshirë kujdestarinë dhe kujdesin e fëmijëve sipas lidhjes fafëfisnore, do të forcohet më tej, po ashtu do të funksionalizohet edhe Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, me kapacitete të zgjeruara për reagim multi-sektorial ndaj të gjitha formave të dhunës. OKB-ja do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e politikave dhe monitorimin e ndryshimeve klimatike; të rrisë qasjen në financa për të përshpejtuar kalimin në energji të rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë; të forcojë rezistencën multi-sektoriale dhe integrimin e ndryshimeve klimatike në politikat dhe plan-programet kombëtare të arsimit. Menaxhimi i burimeve natyrore do të forcohet me qasjen e përmirësuar në financa; mbrojtjen e tokës,

pyjeve dhe ujërave duke përfshirë liqenet dhe infrastrukturën e mbeturinave dhe ujërave të zeza; gjelbërimin e bujqësisë lokale me turizëm të qëndrueshëm dhe bashkëpunim të forcuar ndërkufitar. Do të ofrohet ndihmë këshillimore në tetë qytete që përballen me ndotje të konsiderueshme të ajrit me qëllim të ngrohjes më të pastër të ndërtesave publike, transportit, industrisë, bujqësisë dhe menaxhimit më të pastër të mbeturinave, monitorimit të ndotjes së ajrit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit. Gjithashtu janë planifikuar aktivitete të synuara për edukim, ndërgjegjësim dhe mobilizim për ndotjen e ajrit me fëmijët dhe të rinjtë. Do të mbështetet reduktimi i rreziqit nga vërshimet në Pollog dhe në pellgun e lumit Drin, si dhe do të mbështeten aktivitetet për gatishmëri më të madhe për situatat emergjente shëndetësore. Do të vazhdojë mbështetja e konsiderueshme për pastrimin e mbeturinave në pikat e nxehta ekologjike dhe për përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta në rajonin e Liqenit të Prespës dhe në Qendrat e Përkohshme të Pranimit të Emigrantëve.

Do të vazhdojë ndihma në harmonizimin e ligjeve dhe politikave kombëtare me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së, duke përmirësuar qëndrimet pozitive të publikut ndaj gjinisë dhe grupeve të cenueshme, duke konsoliduar njëkohësisht kapacitetet institucionale për të promovuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive të drejtat themelore, si dhe për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi. Reformat në sistemin e drejtësisë penale dhe në sistemin e drejtësisë së të miturve do të sigurojnë një qasje të përqendruar te viktimat dhe fëmijët, ndërsa organet e zbatimit të ligjit do të fitojnë aftësi të specializuara për të trajtuar në mënyrë proaktive krimet seksuale digjitale, rastet e dhunës në familje me përdorim të armëve të zjarrit, trafikimit dhe qenieve njerëzore, kontrabandën e emigrantëve dhe krime të tjera ndërkombëtare dhe krimin e organizuar. Do të vazhdojë qasja progresive dhe e bazuar në të dhënat në menaxhimin e migracionit, ndërsa pushtetit qendror dhe lokal do t'i ofrohet ndihmë në zbatimin e buxhetimit dhe revizionit të përgjegjshëm gjinor dhe në rritjen e efikasitetit fiskal. Vetëqeverisjet lokale do të përmirësojnë bashkëpunimin ndërkomunal, do të digjitalizojnë shërbimet e tyre dhe do të jenë në gjendje të zbatojnë projekte të OSHC-ve dhe të organizatave rinore në mënyrë transparente dhe në bazë të meritave. Rregullisht do të komunikohen informacione për rezultatet e regjistrimit, si dhe për punën me këshillat rinore dhe mediat për të adresuar narrativet përçarëse, gjuhën e urrejtjes, mashkulloritetet dhe normat gjinore.



Një nga vizatimet fituese të ofruara nga fëmijët në konkursin e vizatimit të fëmijëve për të Drejtat e Njeriut të OKB-së përpara Ditës së OKB-së

Shtojcat

[1] Partnerët e OKB-së në Maqedoninë e Veriut

Qeveria dhe agjencitë shtetërore

Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Gjykata Administrative
Agjencia për Kadastër të Patundshmërive Agjencia për Planifikim Hapësinor Agjencia për Rini dhe Sport
Komisioni kundër Diskriminimit:
Bashkësia e Njëjve të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Byroja për Zhvillimin Rajonal
Kabineti i Zëvendëskryeminitristit përgjegjës për Çështjet Ekonomike, Koordinimin e Sektorëve Ekonomikë dhe Investime Kabineti i Zëvendëskryeminitristit përgjegjës për Integrimin Evropian dhe Euroatlantike Kabineti i Zëvendëskryeminitristit përgjegjës për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndëretnike Kabineti i Zëvendëskryeminitristit përgjegjës për Politika të Qeverisjes së Mirë
Qendrat për Zhvillimin e Rajoneve Planifikuese Qendra për Punë Sociale Qyteti i Shkupit
Qendra për Menaxhimin e Krizave Drejtoria Doganore
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtoria për E-shëndetësi Agjencia e Punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik
Fondi i Sigurimit Shëndetësor
Gjykata e Lartë Administrative Enti për Veprimtari Sociale
Grupi Ndërmintor i Punës për Miratimin e Politikës së Migracionit
Grupi Ndërmintor i Punës për Planin Urbanistik Bregdetar të Liqenit të Ohrit
Gjyqësori
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave Ministria e Kulturës
Ministria e Mbrojtjes Ministria e Ekonomisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor Ministria e Financave
Ministria e Punëve të Jashtme Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve Qendrat Komunale për Punë Sociale (QKPS) Komunitet
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Komisioni Kombëtar për Parandalimin dhe Zbulimin e Hershëm të Kancerit të Qafës së Mitrës
Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Grupi Ndërinstitucional i Punës për Riintegrim
Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e KDPAK-së
Agjencia Kombëtare për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit Parlament
Kabineti i Presidentit Kabineti i Kryeminitristit Prokuroria Publike
Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit Drejtoria e të Ardhurave Publike

Zyrat Rajonale të Punësimit
Komiteti i Mëmësisë së Sigurt Sekretariati i Çështjeve Evropiane Enti Shtetëror i Revizionit
Inspektorati Shtetëror i Punës Enti Shtetëror i Statistikave Institutet për Trajnim Profesional

Organizatet e shoqërisë civile

Akcija Zdruzhenka
Shoqata e Punonjësve Financiarë Shoqata e Gazetarëve (SHGM)
Shoqata e Punëtorëve Socialë Shoqata e Edukatorëve Specialë
Bashkësia e Njëjve të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) Shoqata MAI
Shoqata për Zhvillimin dhe Avancimin e Komunitetit Rom – ROMANO CACIPE
Shoqata për Zhvillimin e Përgjithshëm në Bashkësi dhe Zhvillimin e Cilësisë së Jetës – MOJOT PAT Shkup Shoqata për Integrim, Zhvillim dhe Arsim – PROGRES 23 Likovë Shoqata për Mbrojtjen dhe Edukimin e Fëmijëve dhe të Rinjve Romë - PROGRES
Shoqata e Prindërve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara
Shoqata e Personave me Paralizë Cerebrale dhe Aftësi të Tjera të Fufzuara - Veles
Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara - Bravura
Kooperativa Shoqata e Personave me Invaliditet
Trupor - Mobilnost Makedonija Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale - PORAKA Negotinë
Shoqata e Ofruesve të Shërbimeve Sociale - STARTER PLUS
Shoqata e të Verbërve dhe Personave me Shikimi të Dëmtuar
Shoqata e të Shurdhëve dhe Personave me Dëgjim të Dëmtuar,
Fondacioni Balkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm
Qendra për Hulumtim dhe Hartim të Politikave (QHHP) Dhomat e Tregtisë
Organizatet e shoqërisë civile
Bashkimi i Vlerave të Natyrës me Njerëzit - Zyra
Këshilli për Parandalimin e Delikencës së të Miturve - SPPMD Shoqëria Ekologjike - ZDRAVEC 2002
Organizatet e punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut ESSA Sinergji Shkup
Shoqatat e fermerëve
Projekti Opsionet për Jetë të Shëndetshme Shkup (HOPS)
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut IZBOR STRUMICE
Shoqata e Gjinekologëve dhe Obstetërve të Maqedonisë Shoqata Ekologjike e Maqedonisë
Shoqata e Mjekëve të Maqedonisë Kryqi i Kuq i Maqedonisë
Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë - SHJRM
Federata Kombëtare e Fermerëve
Qendra Kombëtare e Romëve
Delegati Kombëtar i të Rinjve në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore SEGA PRILEP
Avokati i Popullit
Hapni dritarë
Organizatet dhe Grupet e Personave me Aftësi të Kufizuara Polio Plus
Shoqatat Profesionale Rrjeti i Zhvillimit Rural Sindikatat
Këshilli Rinor Kombëtar i Maqedonisë Forumi Arsimit Rinor

Komuniteti akademik

Shoqata për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim
Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit Fakulteti i Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompiuterike Fakulteti i Shkencave Pjore
Fakulteti Juridik "Justinianus Primus" (Justiniani i Parë)
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim Enti i Bujqësisë
Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë, Fakulteti i Mjekësisë Shkup
Universiteti i Evropës Juglindore Instituti Shtetëror i Bujqësisë
Klinika Universitare e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës
Klinika Universitare e Psikiatrisë
Universiteti "Goce Delçev", Shtip Universiteti i Southamptonit

Këshillat me shumë partnerë

Këshilli Ekonomik dhe Social i Maqedonisë së Veriut Komisioni Kombëtar për UNESCO-n
Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Mospërfllija Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore
Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikencës së Fëmijëve

Partnerët ndërkombëtarë

Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) Qeveria e Austrisë
Qeveria e Kanadasë Qeveria e Danimarkës Qeveria e Estonisë
Qeveria e Francës Qeveria e Gjermanisë Qeveria e Italisë
Qeveria e Norvegjisë Qeveria e Republikës së Sllovakisë
Qeveria e Suedisë Qeveria e Zvicrës Qeveria e Holandës
Qeveria e Republikës së Koresë Qeveria e Ukrainës
Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Bashkimi Evropian
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Partneriteti Global për Ujin - Mesdheu
Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD) Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, Zyra Rajonale për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (IUCN – ECARO)
Interpoli
Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI) Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS)
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)
Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor
Grupi i Ekspertëve të UNECE për Efikasitetin e Energjisë
Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

Sektori privat dhe të tjerët

A1 Telekom Maqedoni Telekom i Maqedonisë
Konfederata e Biznesit e Maqedonisë Diaspora
Dhoma e Mjekëve të Maqedonisë
Entet e Mbrojtjes Parësore Shëndetësore Zyra e "Roche"
në Maqedoninë e Veriut Kompani të ndryshme

[2] UN joint programmes implemented in 2023

Nga Njohuritë dhe Angazhimi - deri te Fuqizimi dhe Pjesëmarrja (KEEP)

financuar nga UN PRPD dhe zbatuar nga UNDP, UNICEF dhe UNFPA, 400.000 dollarë, 36 muaj (shkurt 2021 – shkurt 2024)

Fondi i Financimit të Gjelbër për të Luftuar Ndryshimet Klimatike dhe Ndotjen e Ajrit,

financuar nga Fondi i Përbashkët i QZHQ-së, zbatuar nga UNDP, IOM dhe UNECE, 7,97 milionë dollarë / financim i përgjithshëm prej 46 milionë dollarë (prill 2022 – mars 2026)

Të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim

financuar nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes, zbatuar nga UNDP, UNFPA, UN Women dhe UNICEF, 4,5 milionë dollarë amerikanë, nga të cilat 0,65 milionë dollarë për aktivitetet në Maqedoninë e Veriut (maj 2022 – maj 2024)

Bio-hack Bota Ime

financuar nga "Green Shark Challenge", zbatuar nga UNDP dhe UNICEF, 0,25 milion dollarë, maj 2022 – maj 2023.

Identifikimi i Rrugëve Sistematike për t'iu Përgjigjur Krizës Globale të Ushqimit, Energjisë dhe Financave në Maqedoninë e Veriut

financuar nga Fondi i Përbashkët i QZHQ-së, zbatuar nga UNDP, UNICEF dhe FAO, 0,25 milionë dollarë amerikanë, korrik 2022-shkurt 2023

[3] SDCF outcome indicator trends

OUTCOME INDICATOR	CATEGORY	BASELINE	BASELINE YEAR	TARGET(2025)	ACHIEVED (2022)	LATEST VALUE	TREND
Inclusive prosperity							
<i>Employment rate (20-64)</i>	Total (20-64 years)	59.2	2019	63.1	61.8	57.1	↘
	Female	48.4	2019	49.2	51.7	50.2	↘
	Male	69.8	2019	74.3	71.8	64.1	↘
	Youth (15-29) Total	34.4	2019	34.9	34.4	33.0	↘
	Female	28	2019	28.2	28.5	26.8	↘
	Male	40.4	2019	41.8	40.2	38.9	↘
<i>Proportion of informal employment in total economy</i>	Total	16.1	2019	14	12.3	12.3 (Q3)	↔
	Female	13	2019	not set	9.2	11.97	↘
	Male	18.1	2019	not set	14.5	4.77	↗
	Youth (15-24) total	24.01	2019	not set	17.8	17.8	↔
<i>Percentage of young people neither in employment nor in education and training</i>	15-29 years	24.5	2019	22	22.8	24.63	↘
	Female	28.3	2019	28.2	24.5	20.3	↗
	Male	20.9	2019	20	21.1	21.93	↘
	15-24 years	18.1	2019	15.8	18	20.56	↘
	Female	19.2	2019	19.1	18.4	27.48	↘
	Male	17.1	2019	16.9	17.6	21.05	↘
	25-29 years	34.9	2019	33.3	31.6	41.16	↘
	Female	43.1	2019	43	35.8	47.07	↘
Male	27.1	2019	25.6	27.6	35.55	↘	
<i>Annual growth rate of real GDP per employed person</i>		-1.3	2019	2.7	2.4	1.22 (Q3)	↘
<i>Global Competitiveness Index 4.0</i>	Rank	82/141	2019	67	Not pub-lished	82	↔
	Points	57.3	2019	not set		/	↔
<i>Working Poverty rate</i>	Total	8.8	2019	7	12.5	/	↔
	Female	6	2019	not set	8.9	/	↔
	Male	10.6	2019	not set	15.1	/	↔
Quality services for all							
<i>Percentage of children age 36-59 months attending an early childhood education program (attendance rate)</i>	Total	39.8	2019	60	41	44	↗
	Girls	47.76	2019	60	47	not avail-able	↗
	Boys	52.24	2019	60	53	not avail-able	↗
<i>Proportion of children and young people at the end of lower secondary education, achieving at least minimum proficiency level</i>	Reading	45	2018	55	45	26	↘
	Numeracy	39	2018	49	39	34	↘
<i>Self-reported unmet need for medical examination and care, % of population aged 16 and over</i>	Total	2.3	2018	2	1.7 (2020)	1.7 (2020)	↔
	Female	2.6	2018	2.2	1.8	1.8	↔
	Male	2	2018	1.8	1.7	1.7	↔
<i>Proportion of the target population covered by all vaccines included in their national programme</i>	All vaccines coverage	95	2018	>95	<90 (2021)	<90	↗
	3 doses of DTP3	92.5	2018	95	80.9	83.9	↗
	Second dose of MCV2	74.8	2018	95	80.4	89.2	↗
<i>Probability of dying from any of cardiovascular diseases (CVD), cancer, diabetes, chronic respiratory diseases (CRD) between age 30 and exact age 70</i>		20.3	2016	18.5	22.73	22.73	↔
<i>Modern contraceptive prevalence rate</i>		14	2018	next survey in 2023	No data	No data	↔
<i>Neonatal mortality rate</i>		3.8	2019	3.5	4.5 (2021)	1.4	↗
<i>Proportion of households covered by social protection cash transfers</i>		8	2019	14.5	44.4	not avail-able	↔

OUTCOME INDICATOR	CATEGORY	BASELINE	BASELINE YEAR	TARGET(2025)	ACHIEVED (2022)	LATEST VALUE	TREND
Human Development Index	Index points	0.759	2019	0.78	0.77	0.77 (2022)	↔
	Rank	82/189	2019	not set	78	78 (2022)	↔
Proportion of population living below the national poverty line	Total	21.9	2018	15.5	21.8 (2020)	21.8 (2020)	↔
	Female	22	2018	16.8	21.9	21.9	↔
	Male	21.8	2018	14.2	21.7	21.7	↔
	0-17 years old	29.3	2018	not set	30.3	30.3	↔
	Youth (15-24)	29.7	2018	not set	28.6	28.6	↔
	Adult (16+)	20.6	2018	not set	20.1	20.1	↔
	25+	19.2	2018	not set	21.1	21.1	↔



Healthy environment

Greenhouse Gas Emissions (Gg CO2-eq)		8,021	2016	6196	Biannual data	N/A	↔
Proportion of a country designated total area that is protected		10.34	2019	15	13.9	13.9	↔
Annual mean levels of fine particulate matter PM10 (µg/m3)		51.32	2019	<40	35.91	37.44	↘
INFORM Risk Index (2020) (on a scale from 1 to 10 where 1 is very low and 10 is very high)	Points	2.6	2020	2	2.4	2.5	↘
	Risk level	low	2020	very low	Low	Low	↔
System for integrated pest management in place		no system in place	2020	system fully functional	no	no	↔
Average use of pesticide per area of cropland (kg/ha)		0.22	2017	EU average: 3.14	0.3	N/A	↔
Degree of integrated water resources management implementation (0-100)	Points	33	2020	60	40	40	↔
	Level	medium-low	2020	medium-high	medium-low	medium-low	↔
Renewable energy share in the total gross final	Energy consumption	18.18	2018	29	17.29	31.45	↘
	Electricity consumption	24.84	2018	46	21.53	31.45	↘



Good governance

Rule of law index (overall, on a scale from 0 to 1)		0.53	2020	not set	0.53	0.53	↔
Gender equality index		62	2019	65	64.5	64.5	↔
Level of establishment of permanent national child rights coordinating mechanism		weak	2020	established	weak	In pro-cess	↔
The country has a system in place to track and make public allocations for gender equality and women's empowerment		no	2020	yes	No	No	↔
Worldwide Governance Indicators	Average	49.72	2018	>60	52.36	52.36	↔
	Voice & accountability				52.17	/	↔
	Political stability & absence of violence/terrorism				50	/	↔
	Government effectiveness				50	/	↔
	Regulatory quality				66.35	/	↔
	Rule of law				52.4	/	↔
	Control of corruption				43.27	/	↔
Open Budget Index	Transparency	41	2019	>=45	36	36	↔
Percentage of official statistics aligned with EU acquis		67	2019	95	67	64	↔
Level of general satisfaction with public services at the local level (on a scale from 1 to 5)	Total	3.07	2020	3.5	3.2	3.04	↘
	Female	3.12	2020	3.6	3.21	3.1	↘
	Male	3.02	2020	3.4	3.19	3	↘
	Urban	3.09	2020	3.5	3.26	3	↘
	Rural	3.05	2020	3.5	3.16	3	↘
The level of the alignment of the refugee protection and migration systems with the international and EU standards		partially aligned	2020	fully aligned	Mostly aligned	Mostly aligned	↔
Proportion of population who believe decision-making is inclusive and responsive		19.8	2020	25	23.6	24	↗

Global indicators

SDG	#	GLOBAL INDICATOR	BASELINE (2021)	TARGET (2022)	ACHIEVED (2022)	TARGET (2023)	ACHIEVED (2023)	TREND
SDG1	IN1.1	Number of new or revised national social protection policies to extend coverage, enhance comprehensiveness and/or increase adequacy of benefits, with UN support	11	5	7	7	3	↘
SDG1	IN1.4	Number of people accessing basic services, with UN support	30,495	26,642	38,114	27,842	23,530	↘
SDG1	IN1.5	Number of people benefiting from income generating activities with UN support	10,967	7,284	17,086	10,982	9,587	↘
SDG2	IN2.2	Number of rural organizations, government institutions and other relevant stakeholders with enhanced capacities for designing and implementing policies that improve productivity, net income and working conditions within the agrifood system	7	7	7	7	7	↔
SDG2	IN2.3	Number of governmental and non-governmental institutions having increased capacity to design, implement and fund policies preventing and reducing malnutrition and promoting healthy diets, with UN support.	2	3	4	8	16	↗
SDG3	IN3.1	Number of national policies on health (including overall health or specific health areas such as sexual and reproductive health, non-communicable and communicable diseases), in accordance with human rights standards are developed and adopted, supported by the UN	5	4	4	5	5	↗
SDG4	IN4.2	Number of technical and vocational education and training (TVET) institutions with improved capacity to deliver training and assessments with UN support	29	40	79	20	48	↘
SDG4	IN4.3	Number of people directly benefiting from improved access to skills and lifelong learning programmes, including for comprehensive sexuality education (CSE), developed and implemented with UN support	2,012	215	1,115	533	3,297	↗
SDG5	IN5.1	Number of laws and regulations, based on international human rights norms and standards, developed with UN support to: a) Eliminate violence against women and girls (EVAWG) including harmful practices (HP); b) promote equal access to sexual and reproductive health (SRH) care, information and education	0	8	8	3	4	↘
SDG5	IN5.2	Number of measures implemented with UN support to: a) Eliminate gender-based discrimination and segregation in labour market; b) Increase women's access to and use of digital technologies, digital finance, e-commerce and digital value chains; c) Ensure women's economic security and empowerment; d) Address discriminatory gender and social norms, stereotypes and practices; and e)	3	8	8	11	12	↗
SDG5	IN5.3	Extent that measures developed/implemented with UN support advance women's and girl's leadership and equal participation in decision-making, with UN support, in: a) Public institutions; b) Elected positions, including parliaments; c) Judiciary; d) Private sector; e) Mediation, reconciliation and peacebuilding mechanisms; and f) Natural resource management	3	4	4	5	0	↘
SDG5	IN5.4	Existence of national or subnational mechanism to address discriminatory gender and social norms, stereotypes, practices and power relations at the individual, social and institutional levels related to gender equality and the empowerment of women, with support of the UN	No	Yes	Yes	Yes	Yes	↔
SDG5	IN5.8	Number of children and adults who have access to a safe and accessible channels to report sexual exploitation and abuse by humanitarian, development, protection and/or other personnel who provide assistance to affected populations, with UN support	20,000	23,000	30,207	25,500	13,949	↘
SDG6	IN6.2	Number of transboundary water bodies in which cooperation and joint management is strengthened with UN support: a) River and lake basins; and b) Aquifers	1	2	2	3	1	↘
SDG7	IN7.1	Amount of energy saved (in megajoule), with UN support	0	/	/	8,280,000 MJ (2,300 MWh)	/	↔
SDG7	IN7.2	Capacity (in megawatt) in installed renewable energy capacity per technology, with UN support: a) Solar; b) Wind; c) Biomass; d) Hydro; e) Geothermal; f) Other	0	/	/	0	/	↔
SDG1	IN7.3	Number of people who, with UN support: a) Gained access to clean, affordable, and sustainable energy; and b) Benefitted from services from clean, affordable, and sustainable energy	0	0	0	30	0	↔

SDG	#	GLOBAL INDICATOR	BASELINE (2021)	TARGET (2022)	ACHIEVED (2022)	TARGET (2023)	ACHIEVED (2023)	TREND
SDG8	IN8.1	A legal framework giving effect to international human rights norms and standards in the world of work, including fundamental principles and rights at work, is developed with UN support	1	1	1	4	1	↔
SDG8	IN8.2	Number of private sector entities (including micro, small, and medium-sized enterprises (MSMEs)) with improved performance, business transactions, and/or income generation as a result of UN support	500	500	502	300	737	↗
SDG8	IN8.3	Number of cases in which business support organizations, workers' organizations and employers and business membership organizations have increased capacity to provide services to their members/ clients to promote economic development, productive employment and decent work, as a result of UN support	4	4	4	5	3	↘
SDG8	IN8.4	Number of people that benefited from programmes to prevent and address child labour, trafficking, and forced labour strengthened by the UN	48	9	9	7	7	↔
SDG9	IN9.2	Number of private sector entities (including micro, small and medium-sized enterprises (MSMEs)) that innovated their business practices, by mainstreaming environmental, social or economic sustainability elements, with UN support	0 (2022)	/	/	3	115	↗
SDG9	IN9.3	Number of additional people with improved access to quality, reliable, sustainable and resilient infrastructure/infrastructure-related services (including digital infrastructure), with UN support	8,624	214	214	0	369	↗
SDG10	IN10.1	Number of local financial institutions that provide financial services by integrating Poverty-Environment and Gender Nexus considerations with a human rights approach, supported by the UN	0	/	/	2	0	↔
SDG10	IN10.2	Bilateral, national, and local development and sectoral policies that integrate migration and recognize migrants as contributors to sustainable development developed with UN support and implemented by the Government	No	Yes	Yes	Yes	Yes	↔
SDG10	IN10.3	Number of people who are internally displaced, migrants, refugees or part of the host communities, or communities left or affected populations, benefiting from integrated and targeted interventions, including on strengthening social cohesion, with UN support	20,000	21,300	28,399	23,500	12,686	↘
SDG12	IN12.2	Hazardous waste treated, by type of treatment, with UN support	0	690,000	957,250	525,000	525,000	↘
SDG15	IN15.1	Number of entities at the national level that have developed integrated approaches and tools for enhanced coordination, cooperation, and synergies for the coherent implementation of multilateral environmental agreements, supported by the UN	1	2	2	13	/	↔
SDG16	IN16.3	Number of gender-responsive, conflict-sensitive development institutions, policies, plans, or cross-border initiatives in place, with UN support that, promote and protect human rights, prevent systemic human rights violations to: a) Address conflict drivers; b) Strengthen social cohesion; c) Prevent risk of conflict, including climate security; and d) End all forms of violence, promote the rule of law, and ensure equal access to justice for all	2	7	10	31	24	↗
SDG16	IN16.5	Number of new people registered with legal identity, with UN support	420	120	190	453	204	↗
SDG16	IN16.6	Number of people supported, who have access to justice, with UN support	0	1,010	3,264	2,420	444	↘
SDG17	IN17.2	Degree of alignment of national budgeting system with Sustainable Development Goals (SDGs) that enable tracking of budget allocation for the SDGs, including through gender-responsive budgeting, supported by the UN	Limited	Limited	Limited	Limited	Limited	↔
SDG17	IN17.3	Data collection and analysis mechanisms/initiatives providing disaggregated data to monitor progress towards the Sustainable Development Goals (SDGs) and enhancing policy coherence for sustainable development, established/implemented with UN support	Low	Low	Low	Moderate	Low	↔

[4] Acronyms & abbreviations

AAC	Alternative and augmentative communication	MLSP	Ministry of Labour and Social Policy
ALMM	Active Labour Market Measures	MSME	Micro, small and medium enterprises
BOS	Business Operations Strategy	MoES	Ministry of Education and Science
CAP	Common Agricultural Policy	MoEPP	Ministry of Environment and Physical Planning
CEDAW	Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women	MRV	Monitoring, Reporting and Verification
COP	Conference of Parties	NDS	National Development Strategy
CSA	Climate-smart agriculture	NEET	Youth Not in Education, Employment or Training
CSE	Comprehensive sexuality education	NES	National Employment Strategy
CSW	Centres for social work	NHRIs	National Human Rights Institutions
DV	Domestic violence	OBL	Organic Budget Law
DRR	Disaster risk reduction	OG	SDCF Outcome group
DPPI SEE	Disaster Preparedness and Prevention Initiative for South-East Europe	OPDs	Organizations of persons with disabilities
eNDC	Enhanced nationally determined contribution	PAs	Protected areas
4th NC	4th National Communication to UNFCCC	PMT	UN Programme Management Team
ECI	Early childhood intervention	PSD	Partnership for Sustainable Development
EPC	Effective perinatal care	PWD	Person with disabilities
EPR	Environmental Performance Review	RE	renewable energy
ESA	Employment Support Agency	EE	energy efficiency
ESC	Economic and Social Council	RC	Resident Coordinator
EU	European Union	RCO	UN Resident Coordinator's Office
GCF	Green Climate Fund	RMPS	Resource Mobilization and Partnership Strategy
GFF	Green Finance Facility	SDCF	Sustainable Development Cooperation Framework
GHG	Greenhouse gas	SDGs	Sustainable Development Goals
GRB	Gender-responsive budgeting	SEEU	South-East European University
GREVIO	Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence	SEL	Social and emotional learning
HCFCs	Hydrochlorofluorocarbons (refrigerants, ozone depleting substances)	SSO	State Statistical Office
HCH	Hexachlorocyclohexane (lindane)	UN	United Nations
HDI	Human Development Index	UNCT	United Nations Country Team
HORECA	Hotels, restaurants, and cafes	UNFCCC	United Nations Framework Convention on Climate Change
HOTAM	Association of employers in hotel and catering	VAW	Violence against women
HWS	Health Workforce Strategy	VET	Vocational education and training
ICF	International classification of Functioning, Disability and Health		
IFMIS	Financial Management Information System		
ILS	International Labour Standards		
JSC	Joint Government-UN SDCF Steering Committee		
MAFWE	Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy		
MAP	Modified atmosphere packaging		



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



northmacedonia.un.org

www.facebook.com/1un.mk

www.twitter.com/1UN_MK

Shtojcë:

2023

**Rezultatet
tona, storjet
tona**



PRODHIM MË I MIRË, USHQIM MË I MIRË, MJE- DIS JETËSOR MË I MIRË DHE JETË MË E MIRË



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Radica dhe Martini janë kushërinj të parë që kanë trashëguar tokën bujqësore nga nënat e tyre dhe tani bashkërisht kultivojnë grurë dhe luledielli. Si familje, ata kanë 284 hektarë (ha) tokë në fshatin Dabjan, nga gjysmë për secilin prej tyre. Deri vonë, toka e tyre ishte e copëtuar në 278 parcela të veçanta dhe të shpërndara prej rreth 1.02 ha secila, duke e bërë punën e tyre bujqësore joefikase dhe sfiduese. Gjithçka ndryshoi kur me mbështetjen Bashkimit Evropian (BE) dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) u bë konsolidimi i tokës në 48 parcela më të mëdha dhe me formë më të mirë, secila me madhësi mesatarisht 5,91 ha, kurse para konsolidimit të tokës secila kishte vetëm 1.02 ha, gjë që mundësoi përmirësim të ndjeshëm të produktivitetit. Toka e Radicës dhe Martinit gjithashtu ka qasje më të mirë në infrastrukturën bujqësore, tani

që një projekt që financohet nga BE-ja e që zbatohet nga FAO dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU), po e përmirëson infrastrukturën bujqësore në Dabjan. Po punohet për të përmirësuar dhe për të ndërtuar rrugë qasjeje për të lehtësuar transportin dhe për të përmirësuar qasjen në fusha. Radica dhe Martini presin që këto përmirësime të rrisin efikasitetin e përdorimit të tokës dhe të ndihmojnë në rigjallërimin e prodhimit të tyre bujqësor.



©FAO/Martin Savevski



©FAO/Radica Gruevska

SI FUNKSIONON FAO

EKONOMI RURALE E QËNDRUESHME DHE KONKURRUESE E HARMONIZUAR ME STANDARDET E BE-së

FAO promovon zhvillimin ekonomik dhe social gjithëpërfshirës duke fuqizuar fermerët e vegjël dhe duke mbështetur politika të bazuara në fakte. Përpjekjet janë fokusuar në përmirësimin e strukturave të tokës bujqësore, lëvizshmërinë e tregut bujqësor dhe produktivitetin dhe kanë për qëllim rritjen e standardit të jetesës në zonat rurale dhe nxitjen e konkurrencës.

REZULTATET KRYESORE NË VITIN 2023:

- U zhvillua një kornizë gjithëpërfshirëse për Strategjinë e parë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes dhe u krijua një mekanizëm kombëtar ndërsektorial për koordinim për sigurinë ushqimore.
- Analiza e kryer për tokën e braktisur bujqësore, (që përbën 32% të tokës së punueshme të vendit), kontribuoi për ndryshimet në Ligjin për Tokën Bujqësore, Ligjin për Privatizimin e Tokës në Pronësi Shtetërore dhe ligje të tjera të lidhura me to.
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Maqedonisë së Veriut u mbështet për të harmonizuar Sistemin Kombëtar të Shëndetit të Kafshëve dhe Sigurisë Ushqimore me standardet e BE-së.
- U ofrua ndihmë për MBPEU-në për të iniciuar përgatitjen e Strategjisë së re Kombëtare për Konsolidimin e Tokës Bujqësore për periudhën 2024-2034, dhe për të përforcuar ngritjen e kapaciteteve. U arrit përparim në Programin Kombëtar të Konsolidimit të Tokës
- U hartua Plani i Rishpërndarjes së Tokës, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës bujqësore për 156 hektarë në fshatin [Çiflik](#), nga e cila [përfituan](#) 404 pronarë tokash. Filluan punimet ndërtimore në fshatin [Dabjan](#) për të përmirësuar kullimin dhe rrjetin e rrugëve për 742 hektarë tokë bujqësore, nga të cilat përfituan 85 pronarë tokash bujqësore.



©FAO

Gjendja aktuale në Çiflik



©FAO

Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore në Dabjan

RITJE E VEPRIMEVE KLIMATIKE, MENAXHIM I QËNDRUESHËM I BURIMEVE DHË REDUKTİM I RREZIKUT PËR BUJQËSINË

FAO mbështet veprimin klimatik në nivel kombëtar, duke përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, rezistencën bujqësore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Prioritet është rritja e rezistencës klimatike të fermerëve të vegjël përmes praktikave të qëndrueshme, qasjes në të dhëna dhe përmirësimeve të sistemeve të ujitjes.

REZULTATET KRYESORE NË VITIN 2023:

- U lehtësua qasja e qeverisë në burimet financiare për klimën nga Fondi i Gjellbër i Klimës, që kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve kombëtare për një ekonomi rezistente ndaj klimës dhe me nivel të ulët të karbonit.
- Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi u mbështet përmes [sistemeve të përmirësuar të qëndrueshme të farës](#), menaxhimit dhe ruajtjes së cilësisë së farës dhe një vlerësimi të Sistemit Kombëtar të Farës.
- U vlerësuan sistemet në pronësi shtetërore të ujitjes dhe kullimit në rajonin e Radovishit për të ofruar ndihmë në përpjekjet për modernizim, me qëllim të rritjes së kapacitetit të fermerëve lokalë për t'u përshtatur ndryshimeve klimatike.
- FAO bashkëpunoi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Fakultetin e Shkencave Pyjore për të rritur monitorimin e dëmtimit të pyjeve, planifikimin e restaurimit dhe bashkëpunimin rajonal.



©FAO/Silvana Manastevska Simikj

Mbjellja e specave në një fushë për demonstrim në Koçan

REZULTATET

FAKTE KRYESORE

2,550

fermerë të vegjël u përfshinë në mbështetjen për konsolidimin e tokës(2017-2023)

U mbështetën ndryshimet në Ligjin për Tokën Bujqësore, Ligjin për Privatizimin e Tokës në Pronësi

U mbështetën

2

strategji kombëtare për të adresuar menaxhimin e tokës bujqësore, sigurinë ushqimore, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, sistemet e ujitjes, sistemet e farës, ripyllëzimin.

11

U përgatitën dokumente të politikave dhe vlerësime në lidhje me menaxhimin e tokës bujqësore, sigurinë ushqimore, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, ujitjen, sistemet e farës dhe pylltarinë.

U mbështet qasja në mjetet financiare të FGJK-së

Transformimi i sistemeve bujqësore-ushqimore për njerëzit dhe planetin

Komuna rurale e Dollnenit ndodhet në Pellagoni, rajonin më të madh për prodhimin e drithërave në Maqedoninë e Veriut, e njohur për prodhimin e begatshëm të grurit, perimeve, kulturave industriale dhe qumështit. Në zemër të saj ndodhet fshati Dabjan, vendi i projektit më të madh për konsolidimin e tokës në vend që është në realizim e sipër dhe që përfshin 742 hektarë tokë bujqësore, në pronësi të 85 pronarëve privatë (435 hektarë) dhe në pronësi të shtetit (307 hektarë). Satki Miftaroski, shef i Njësisë së Inspektoratit në Komunën e Dollnenit, thekson përfitimet e rëndësishme që i presin fermerët lokalë dhe komunitetin rural në fshatin Dabjan. Nëpërmjet mbështetjes së BE-së dhe FAO-s, peizazhi bujqësor i Dabjanit pësoi një transformim të jashtëzakonshëm. Procesi i konsolidimit të tokës të tokës nga 602 në 127, duke rezultuar në parcela më të mëdha dhe me formë më të mirë, me madhësi mesatare prej 5,84 hektarë, një rritje e konsiderueshme nga mesatarja e mëparshme prej 1,23 hektarësh. Për më tepër, një projekt në realizim e sipër i financuar nga BE-ja, dhe i zbatuar nga FAO dhe Ministria e Bujqësisë, është duke përforcuar infrastrukturën bujqësore të Dabjanit, duke përfshirë rehabilitimin e rrugëve ekzistuese për qasje dhe ndërtimin e rrugëve të reja për të përmirësuar transportin dhe qasjen në fushat bujqësore.



©FAO/Satki Miftaroski

Satkiu thekson se këto zhvillime do të rrisin efikasitetin bujqësor, duke mundësuar praktika bujqësore më moderne dhe të mekanizuara për të rritur produktivitetin e fermave. Për më tepër, ai parashikon se këto përmirësime do të tërheqin fermerët e rinj ta fusin sërish në përdorim tokën e braktisur, duke nxitur zhvillimin e komunitetit lokal dhe duke ofruar mundësi për të diversifikuar dhe për të zgjeruar prodhimin bujqësor, gjë që në fund do të çojë në hyrje në tregje të reja.

NABIL GANGI

Zëvendës Përfaqësues Rajonal i FAO-s për Evropën dhe Azinë Qendrore dhe de facto Shef i FAO-s në Maqedoninë e Veriut

Si një agjenci e specializuar e OKB-së që udhëheq përpjekjet ndërkombëtare që adresojnë sfidat globale të ushqimit dhe bujqësisë, FAO ka mbështetur Maqedoninë e Veriut në transformimin e sistemeve ushqimore dhe përaftrimin e bujqësisë me standardet e BE-së dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Duke punuar krah për krah me Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, përpjekjet tona fokusohen në avancimin e zhvillimit të bujqësisë, fuqizimin e pronarëve të vegjël dhe fermave familjare, si dhe në investimin në një ekonomi rurale të qëndrueshme dhe rezistente.

Në vitin 2023, FAO punoi për të nxitur një ekonomi rurale konkurruese duke mbështetur qeverinë në përmirësimin e politikave, legjisllacionit dhe masave në fusha të ndryshme duke përfshirë sigurinë ushqimore, përdorimin dhe menaxhimin e tokës,

sistemet kombëtare të farës, pylltarinë, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në bujqësi, shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore. Për më tepër, në bashkëpunim me partnerët tanë, siguroam fonde për investime të përgjegjshme në transformimin rural.

Rritja e produktivitetit, konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së bujqësisë së Maqedonisë së Veriut ka qenë thelbësore në përpjekjet tona bashkëpunuese me BE-në dhe MBPEU-në. Së bashku, të udhëhequr nga Ministria, ne kemi funksionalizuar Programin Kombëtar të Konsolidimit të Tokës dhe kemi zgjeruar fushëveprimin e tij. FAO ka forcuar bashkëpunimin me Fondin e Gjellbër të Klimës, duke ndihmuar Qeverinë e Maqedonisë së Veriut që të ketë qasje në burimet e FGJK-së për të rritur kapacitetet kombëtare për ndërtimin e një shoqërie me emetim të ulët të karbonit dhe të qëndrueshme ndaj klimës.

Falënderoj dhe përgëzoj të gjithë kolegët dhe partnerët e FAO-s në Maqedoninë e Veriut. Bashkëpunimi ynë me qeverinë, si dhe me BE-në, agjencitë e OKB-së, komunitetin akademik, shoqatat e fermerëve, sektorin privat dhe shoqërinë civile, ka nxitur përparimin drejt një ekonomie rurale konkurruese dhe rezistente.

Le të vazhdojmë me këtë veprim kolektiv në transformimin e sistemeve tona bujqësore-ushqimore për prodhim më të mirë, ushqyerje më të mirë, një mjedis jetësor më të mirë dhe një jetë më të mirë, duke mos lënë askënd pas.

E ardhmja e ushqimit është në duart tona!



MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË MAQEDONINË E VERIUT

TREGIMI I AMIRËS



©IOM North Macedonia

Amira* 14-vjeçare, e cila vinte nga një familje jofunksionale dhe më parë ishte e regjistruar si fëmijë rruge, u detyrua nga një anëtar i familjes të hynte në lidhje jashtëmartesore me një mashkull të rritur. Ekipet mobile të IOM-it së për identifikimin, ndihmën dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit e identifikuan vajzën gjatë punës së tyre në terren në komunitetin e saj.

Ajo u vendos në Qendrën për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbështetje psiko-sociale, aktivitete arsimore dhe të tjera. Amira u përfshi në programin e risocializimit dhe është në pritje të vendosjes së saj në një familje kujdestare.

*Emri është ndryshuar për mbrojtjen e identitetit

ÇFARË PUNE BËN IOM-I

NDIHMË HUMANITARE


IOM-i u është përgjigjur nevojave të njerëzve të prekur nga kriza duke ofruar ndihmë humanitare për 12.842 emigrantë të cenusëm. Ndihma përfshinte kujdesin shëndetësor, shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale, parandalimin dhe mbrojtjen nga COVID-19, mbështetjen për arsim, si dhe kthimin vullnetar të asistuar dhe riintegrimin. IOM-i vazhdoi të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të aktorëve relevantë në fushën e menaxhimit të migracionit dhe mbrojtjes së kategorive të cenushme të emigrantëve.



Ofrimi i ndihmës shëndetësore për emigrantët e cenusëm.

QËNDRUESHMËRI

IOM-i u përpoq të përmirësonte qëndrueshmërinë e emigrantëve në situata të cenusmërisë, duke mbështetur kapacitetet institucionale, njohuritë, aftësitë dhe burimet për të mbrojtur të drejtat e emigrantëve në situata të cenushme, duke përfshirë fëmijët emigrantë dhe viktimat aktuale dhe të mundshme të trafikimit. Kjo përfshinte mbështetjen e pesë ekipeve të lëvizshme për identifikimin, ndihmën dhe referimin e 562 viktimave aktuale dhe të mundshme të trafikimit dhe kategorive të tjera të cenushme. IOM-i ka punuar në mënyrë aktive në përfshirjen e diasporës përmes transferimit të njohurive dhe shkathtësive. IOM-i ka forcuar qëndrueshmërinë e të rinjve ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes të menduarit kritik, aftësive për jetën, edukimit mediatic dhe nismave të udhëhequra nga të rinjtë në 6 komunitete lokale. Gjithashtu, janë mbledhur dëshmi për ndikimin e ndotjes së ajrit mbi grupe të ndryshme të popullsisë migratore përmes studimit paraprak të fushëveprimit të projektit, të kryer mbi ndërlidhjet midis ndotjes së ajrit dhe lëvizshmërisë së njerëzve.



Iniciativë për komunitetin e udhëhequr nga të rinjtë në komunën e Butelit

LËVIZSHMËRI DHE QEVERISJE

IOM-i ka mbështetur qeverinë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qeverisjes së migracionit. Pothuajse 100 aktorë institucionalë u mbështetën nga IOM-i në trajtimin e kimit të organizuar transnacional, si p.sh. kontrabandimi i emigrantëve dhe trafikimi i qenieve njerëzore, dhe mbrojtja e kategorive të cenushme të emigrantëve. IOM-i ka punuar për të forcuar kapacitetet dhe sistemet kombëtare për mbledhjen, shkëmbimin dhe analizën efektive dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave të migracionit dhe përafrimin me standardet e BE-së, duke përfshirë pilotimin e Modullit të parë të Migracionit në Anketën e Fuqisë Punëtore. IOM-i siguron disponueshmërinë, qasjen dhe analizën e të dhënave të migracionit përmes Iniciativës së vazhdueshme të Matricës së Gjurmimit të Zhvendosjeve të IOM-it për të gjurmuar lëvizshmërinë dhe nevojat në zhvillim të grupeve të popullsisë që janë në lëvizje. IOM-i ka punuar edhe me partnerët kombëtarë për integrimin e mundësive që lidhen me lëvizshmërinë njerëzore në kontekstin e ndryshimeve klimatike nëpërmjet Instrumentit të Financimit të Gjellbër.

Trajnimi i palëve të interesuara për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve



REZULTATET

FAKTE KRYESORE

11,248

emigrantëve u është ofruar mbështetje humanitare.

Fthimi i sigurt dhe riintegrimi përmes Programit për Kthim Vullnetar të Asistuar dhe Riintegrim të IOM-it

Daniela dhe familja e saj janë kthyer në Maqedoninë e Veriut me mbështetjen e IOM-it përmes Programit për Kthim Vullnetar të Asistuar dhe Riintegrim (PKVAR).

“Jam përballur me shumë vështirësi në jetën time,” tha Daniela. “Së pari, jetoja me një prind që po luftonte me varësinë, e më pas përjetova varfërinë dhe luftën e përditshme për të mbijetuar me burrin dhe fëmijën tim në një vend të huaj.”

Programi PKVAR na ndihmoi për t’u kthyer në mënyrë të sigurt në vendin tonë dhe, ajo që është më e rëndësishmja, e lehtësoi riintegrimin e fëmijës tonë në arsimin formal.



562

viktima, viktima të mundshme të trafikimit dhe kategori të tjera të cenueshme që janë identifikuar, janë ndihmuar dhe janë referuar.

Iniciativë për komunitetin e udhëhequr nga të rinjtë në komunën e Butelit



Sara, Muhamedi dhe Aleksandri ndjekin mësimin në të njëjtën shkollë në komunën e Butelit, ku fusha e sportit u rinovua me mbështetjen e IOM-it përmes iniciativës së tyre.

Sporti ofroi një mundësi të fuqishme dhe pozitive për ta dhe bashkëmoshatarët e tyre, duke u mundësuar atyre të kultivojnë aftësi dhe vlera të rëndësishme për jetën. Përfundimisht për shëndetin fizik, mundësia për të pasur një hapësirë për t’u angazhuar në sport u ndihmoi atyre të zhvillonin aftësitë sociale dhe komunikuese, mirëqenien emocionale dhe vlera të tjera pozitive si p.sh. sjellja korrekte në garat sportive, loja e ndershme dhe respekti për të tjerët.

Fusha sportive i bashkoi ata, u ofroi mundësi për ndërveprim social dhe e forcoi ndjenjën e përkatësisë së tyre në komunitet.

U mbështetën

6

iniciativa të të rinjve për komunitetin.

SONJA BOZHINOVSKA PETRUSHEVSKA

IOM Shef i zyrës në Maqedoninë e Veriut

Si një organizatë udhëheqëse ndërqeveritare në fushën e migracionit, IOM-i në Maqedoninë e Veriut ka mbështetur vendin për të ofruar mbështetje humanitare për emigrantët e cenueshëm, mbështetje në identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e migracionit, statistikën e migracionit dhe digjitalizimin në fushën e menaxhimit të migracionit. Ne jemi krenarë për mbështetjen që u kemi dhënë të rinjve si udhëheqës të shumë iniciativave për komunitetin në Maqedoninë e Veriut, si dhe për të nisur iniciativa ekologjike dhe zhvillimore që e mbështesin angazhimin e diasporës.

IOM-i do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë e Veriut në promovimin e qasjeve gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt zgjidhjeve për të menaxhuar migracionin në mënyrë efektive dhe për të shfrytëzuar potencialin e saj zhvillimor drejt arrijtes së qëllimeve të QZHQ-së dhe duke mos lënë askënd pas.

Deri

100

palë të interesuara me kapacitete të ngritura në fusha të ndryshme të



PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE NË MAQEDONINË E VERIUT

REZULTATET E MBËSHTETURA NGA ILO NË VITIN 2023



International
Labour
Organization



Qeveria e Maqedonisë së Veriut, sindikatat, organizatat e punëdhënësve dhe ILO kanë nënshkruar Programin e ri të Punës së Denjë për Vendin (PPDV) për periudhën 2023-2025. Krijimi i më shumë vendeve të punës dhe i vendeve më të mira të punës, përmirësimi i mundësive të punësimit për gratë e reja dhe burrat e rinj dhe promovimi i një tregu gjithëpërfshirës të punës nëpërmjet dialogut të forcuar social janë prioritetet kryesore të PPDV-së.

Qeveria dhe partnerët socialë u fokusuan në Strategjinë Kombëtare të Punësimit (SKP) 2021-2027, e cila përfshin një sërë veprimesh të përbashkëta të politikave që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnimin, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sipërmarrjeve dhe politikat e tregut të punës, për të trajtuar sfidat e shkaktuara nga krizat e shumta. ILO mbetet i vetmi partner institucional i Maqedonisë së Veriut në iniciimin dhe zbatimin e Garancisë për të Rinjtë. Plani i ri i Zbatimit për periudhën 2023-2026 i Garancisë për të Rinjtë, i miratuar më 5 prill të vitit 2023, bazohet në rezultatet e planit të mëparshëm, i cili çoi në rënie të numrit të të rinjve që nuk janë të angazhuar në arsim, punësim apo trajnim (NEET), rritje të shkallës së punësimit dhe ulje të shkallës së papunësisë në vend, përkundër efekteve negative të krizës së KOVID 19, luftës në Ukrainë dhe krizës ekonomike dhe energjetike.

Roli më i spikatur i sindikatave si mbrojtës të të drejtave të punëtorëve ishte i dukshëm. Ato ishin kundërshtarë të fortë të veprimeve të

aktuara të qeverisë për të minuar pozitën e Këshillit Ekonomik dhe Social, siç është ndryshimi i orarit të punës në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, të cilat u miratuan pa konsultime paraprake me partnerët socialë. Këto ndryshime u kundërshtuan ashpër nga të gjitha sindikatat si shkelje flagrante e të drejtës për një orar të denjë pune dhe janë kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese.

Më 14 qershor 2023 Kuvendi i Maqedonisë ratifikoi Konventën e ILO-s Nr. 190 mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, pas rekomandimit të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe të Qeverisë. Në nivel dypalësh, pas 15 vitesh, më 18 korrik të vitit 2023 u nënshkrua Marrëveshja e parë e Përgjithshme Kolektive për Sektorin Publik.

Zgjidhja miqësore e disa rasteve të profilit të lartë të kontesteve kolektive të punës dëshmoi rëndësinë e mekanizmit të krijuar për zgjidhjen miqësore të kontesteve të punës (ZMKP) dhe ndikoi në rritjen e besimit në efektivitetin e sistemit. Këto raste kanë nxjerrë në pah disa nga mangësitë e sistemit ekzistues. Prandaj, aktorët nga Maqedonia e Veriut vendosën të përdorin mjetin e ri të ILO-s për vetë-vlerësimin e mekanizmave për zgjidhjen e kontesteve të punës. Ata identifikuan anët e forta dhe të dobëta të mekanizmit ZMKP, dhe në bazë të gjetjeve, më pas zhvilluan Planin e Veprimit për reformën dhe avancimin e zgjidhjes



REZULTATET KRYESORE

GARANCIA PËR TË RINJTË

8038 (4109 GRA) TË RINJ

got employed within 4 months from their u punësuan brenda 4 muajve nga regjistrimi i tyre në Garancinë për të Rinjtë.

DIALOGU JETËN

131.009 PUNËTORË

në sektorin publik përfituan rritje të rrogave dhe kushte më të mira pune pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për Sektorin Publik.

PËRMIRËSON

QASJA NË DREJTËSINË E PUNËS

10.534 PUNËTORË

morën ndihmë juridike përmes aplikacionit celular të Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë.

1.729 PUNËTORË

të prekur nga rastet e kontesteve të punës përfituan nga zgjidhja miqësore e kontesteve në vitin 2023.

PRITJA MBAROI – IDENTITETI LIGJOR PËR TË GJITHË PO BËHET REALITET REZULTATET E MBËSHTETURA NGA UNHCR-ja NË VITIN 2023



Një atmosferë solemne në Zyrën e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë në Shkup, kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut, para ngjarjes së organizuar për të shënuar progresin e arritur për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi në Maqedoninë e Veriut dhe për të dorëzuar një grup të ri të certifikatave të lindjes.



©UNHCR/Brashnarska

Njëra prej tyre është znj. Zulfija Amza, një grua pesëdhjetë e pesë vjeçare, e lindur në Shkup, e cila nuk ka vizituar kurrë mjek në jetën e saj. Mospasja e shtetësisë e ka detyruar atë të lyp gjatë gjithë jetës së saj për ushqim dhe për të mbijetuar, pasi ajo nuk ka mundur të marrë as ndihmë sociale pa letërnjoftim apo pa pasaportë. Motra e Zulfijes ndërroi jetë dhe i la fëmijët jetimë dhe në të njëjtën gjendje të vështirë për të kaluar jetën pa identitet ligjor.

Bile edhe para se të fliste kryeministri Kovaçevski, Zulfija lëshoi një gulçim të madh dhe me shumë emocion falënderoi të gjithë personat përgjegjës që më në fund ua dhanë certifikatat e lindjes.

Kryeministri Kovaçevski tha se këta persona, të cilët deri më tani kanë qenë jashtë tregut të punës, tani do të mund të punësohen, të hapin kompanitë e tyre, t'i shfrytëzojnë të gjitha përfitimet që ua ofron Kushtetuta dhe ligjet e vendit, të martohen ligjërisht, dhe fëmijët e tyre të regjistrohen në Librat Amë pa asnjë problem.

Nuk ishte aspak një mision i lehtë të arrinin këtu. Z. Gabriel Gualano de Godoy, Përfaqësues i UNHCR-së, Agjencisë së OKB-së për Refugjatët, së cilës i është besuar detyra t'i ndihmojë shtetet t'i japin fund problemit të njerëzve pa shtetësi në mbarë botën, tha: "Ky përparim i madh është në përputhje me standardet kryesore ndërkombëtare: Konventat e OKB-së të vitit 1954 dhe 1961 lidhur me problemin e njerëzve pa shtetësi, si dhe me Agjendën 2030 dhe Qëllimin e saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm 16.9, mbi regjistrimin universal të lindjeve dhe identitetin ligjor për të gjithë. Ato buzëqeshje dhe mundësia që këta fëmijë të thonë #IBelong janë rezultat i bashkëpunimit të Kuvendit dhe Qeverisë për të mos lënë askënd pas".

Rreth 20 persona të cilët nuk kanë pasur numra amë të qytetarit dhe për rrjedhojë asnjë dokument gjatë gjithë jetës së tyre, po prisnin me durim që herët në mëngjes edhe pse ceremonia nuk do të fillonte në tre orët e ardhshme. UNHCR-ja dhe punonjësit partnerë i pyetën ata nëse mund t'u ndihmonin t'i ndiheshin më të rehatshëm gjatë pritjes e ata njëzëri thanë: "Ne kemi pritur gjithë jetën, kështu që të presim edhe disa orë të tjera nuk është asgjë për ne".

REZULTATET KRYESORE

218

raste të njerëzve pa shtetësi janë zgjidhur gjatë këtij viti.

511

nga 786 persona që dihej e janë në rrezik nga problemi i mospasjes së shtetësisë morën letërnjoftimet e tyre të para në Maqedoninë e Veriut duke i zgjidhur rastet e tyre.

1,743

persona kanë marrë ndihmë juridike falas për procedurën e azilit dhe për marrjen e identitetit ligjor dhe shtetësisë nga personat që nuk kishin shtetësi.

235

persona me nevoja të veçanta janë mbështetur me aktivitete psiko-sociale, kulturore, gjuhësore dhe të zhvillimit të

Gabriel Gualano de Godoy

Përfaqësues i UNHCR-së në Maqedoninë e Veriut

Unë jam vërtet mirënjohës për aleancën e gjerë që kemi krijuar për të bërë një shtytje të fortë për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi në Maqedoninë e Veriut. UNHCR-ja ka punuar krah për krah me Kuvendin, institucionet qeveritare dhe ministrinë, DBE-në, OSBE-në, Këshillin e Evropës, USAID-in, ambasadat dhe organizatat e shoqërisë civile.

Problemi i njerëzve pa shtetësi mund të kishte vazhduar të pengonte jetën e njerëzve po të mos ishte puna e rëndësishme e bërë nga Kuvendi, e udhëhequr nga tre deputete veçanërisht të përkushtuara – znj. Sonja Mirakovska, znj. Shezhana Kaleska – Vançeva dhe znj. Latife Shikovska – të cilat u angazhuan që të plotësohen dhe të korrigjohen të gjitha boshllëqet ligjore në disa ligje.

Zbatimi i ligjeve të ndryshuara është një kontribut historik për t'i dhënë fund problemit të njerëzve pa shtetësi në Evropën Juglindore, një zotim nga Forumi Global i Refugjatëve, i mbajtur në vitin 2023.



SIGURIMI I TË ARDHMES SË RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

REZULTATET E MBËSHTETURA NGA UNEP-I NË VITIN 2023



Me votimin unanim në Konferencën e Palëve të Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (CMS) në shkurt të vitit 2024 në Uzbekistan, CMS-ja pasurohet edhe me Rrëqebullin Euroaziatik në Shtojcën II dhe nënspecien e rrezikuar në mënyrë kritike të Rrëqebullit të Ballkanit në Shtojcën I. Propozimi u prit shumë pozitivisht nga të gjitha vendet anëtare të CMS-së dhe vendet ku jetojnë këto specie, duke përfshirë një deklaratë shumë pozitive nga BE-ja dhe shumë organizata ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës. "Nënspecia e Rrëqebullit Ballkanik është simboli kombëtar

publikut për mbështetjen e iniciativës sonë", thonë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Nga mesi i vitit 2023, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Maqedonisë së Veriut, së bashku me ministritë përkatëse të mjedisit jetësor të Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Uzbekistanit, kanë dorëzuar një propozim për listën e mundshme të Rrëqebullit Euroaziatik në Shtojcën II dhe të nënspecieve të rrezikuara në mënyrë kritike të Rrëqebullit Ballkanik si shtesë në Shtojcën I të Konventës për Ruajtjen e Specieve Migratore të Kafshëve të Egra (CMS/Konventa e Bonit).

Lista e propozuar u iniciua dhe u koordinua nga Sekretariati i Konventës së Karpateve/Ekipi i UNEP-it në Vjenë së bashku me Grupin e Specialistëve Grupit në kuadër të Komisionit të Mbijetesës së Llojeve (SSC) të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

"Nënder përfitimet e tjera, pranimi i Rrëqebullit të Ballkanit në CMS nënkupton një angazhim të qartë midis vendeve ku jetojnë këto specie për të punuar së bashku dhe për të ndërtuar një strategji ruajtjeje që do të fokusohet në veprimet e menjëhershme për të mbrojtur popullsinë. Jam shumë krenar që Maqedonia e Veriut ishte propozuesi kryesor sepse kjo tregon se edhe vendet e vogla mund të kontribuojnë në ruajtjen globale – siç është rasti me Rrëqebullin Euroaziatik që është renditur në Shtojcën 2 të Konventës", thotë Dime Melovski, ekspert kombëtar.


I gjithë procesi ishte një përvojë unike bashkëpunimi që ndihmoi në bashkimin e autoriteteve kombëtare, shkencëtarëve dhe organizatave të ruajtjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të rishikuar gjendjen momentale dhe për të diskutuar për mënyrat për të vazhduar përpara. Pritet që kjo të rrisë ndërgjegjësimin në përmasa të gjera për statusin e ruajtjes së specieve dhe nënspecieve, të kontribuojë në përbushjen e objektivave të përcaktuara me strategjitë kombëtare të mbrojtjes së natyrës, QZHQ-të, Konventën e Karpateve, Kornizën Globale të Biodiversitetit, Konventën mbi Diversitetin Biologjik, dhe marrëveshje të tjera shumëpalëshe ekologjike. Gjithashtu, ka potencial për të tërhequr më shumë fonde për zbatimin e masave të mëtejshme të ruajtjes, si dhe për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkufitar midis vendeve fqinje ku jetojnë këto specie, veçanërisht në rajonin e PK të Korabit/Koritnikut/Mavrovës/PK të Malit Sharr – që është habitati natyror i Rrëqebullit të Ballkanit të rrezikuar në mënyrë kritike.



©UNEP Vienna Programme Office/ Secretariat of the Carpathian Convention

i Maqedonisë së Veriut, i mbrojtur me ligj. Njësia e Natyrës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është shumë krenare që Konferenca e fundit e Palëve e Konventës për Ruajtjen e Specieve (CMS) ka pranuar propozimin tonë për të renditur Rrëqebullin Euroaziatik në Shtojcën II dhe Rrëqebullin e Ballkanit (si nënspecie të Rrëqebullit Euroaziatik) në Shtojcën I të Konventës CMS. Kjo pritet të kontribuojë shumë në ruajtjen e këtyre specieve, veçanërisht në aspektin e mbrojtjes në nivel politik, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërkufitar midis vendeve fqinje dhe ka potencial për të tërhequr më shumë fonde për zbatimin e masave të mëtejshme të ruajtjes.

Në shprehim mirënjohje të sinqertë për Zyrën e Programit të UNEP-it në Vjenë, ekspertëve të Grupit të Specialistëve në kuadër të Komisionit të Mbijetesës së Llojeve (SSC) të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), si dhe të gjitha institucioneve kombëtare, ekspertëve vendas dhe të huaj dhe



TRIUMFI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT

Ndërtimi i përbashkët i së nesërme – Të bashkuar në diversitet formësojmë fatin e kombit tonë



Duke punuar së bashku me partnerët tanë, arritëm sukses që të marrim mbështetje të gjerë për këtë dokument vizionar, duke formësuar trajktoren e vendit për dekadat e ardhshme.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit mbetet një testament i bashkëpunimit të shkëlqyer, duke bashkuar deputetë nga partitë opozitare dhe ato qeveritare, përfaqësues të institucioneve, ministrave, qytetarë, grupe të marginalizuara, ekspertë, organizata "think tank", dhoma të tregtisë, OJQ dhe grupe të shoqërisë civile.

Arritja më e dukshme ishte miratimi i paradokohshëm unanim i Ligjit për SKZH-në nga Kuvendi, i mbështetur nga 62 deputetë të pranishëm, duke i tejkaluar vijat partiake. Ky moment i rëndësishëm pasqyron një vizion të përbashkët dhe një konsensus mbi trajktoren e kombit tonë për 20 vitet e ardhshme, duke theksuar fuqinë e qeverisjes gjithëpërfshirëse dhe përpjekjeve bashkëpunuese.

Në thelb, SKZH-ja shërben si model për

planifikimin strategjik, duke shfaqur forcën e demokracisë sonë dhe potencialin e zhbllkuar kur perspektivat e ndryshme bashkohen për një vizion kolektiv.

Suksesi i SKZH-së nuk është vetëm një histori e politikëbërjes; është një dëshmi e ndikimit transformues të unitetit në formësimin e një të ardhmeje më gjithëpërfshirëse dhe premtuese për vendin tonë.

Reagimet dërrmuese pozitive për strategjinë dhe drita e gjelbër për miratimin nga Kuvendi janë dëshmi për konsensusin e arritur.

U mor vendimi për krijimin e organeve mbështetëse të Këshillit Kombëtar për Zhvillim: Komisioni i Punës me katër nëngrupe (i bazuar në modelin e heliksit të katërfishtë) dhe një Këshill Drejtues, që tregon përkushtimin ndaj një qasjeje bashkëpunuese në përputhje me perspektivat e ndryshme.

Njësia e SKZH-së, pjesë e Sekretariatit të Përgjithshëm, është kompletuar plotësisht për të udhëhequr procesin e zbatimit, monitorimin e strategjisë dhe vlerësimin e saj.

Muajin e kaluar u mbajt mbledhja inauguruese e Këshillit Kombëtar për Zhvillim, të kryesuar nga Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këshilli është një qendër e perspektivave të ndryshme, ku bashkohen palë të interesuara nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë qeverinë, kabinetin e Presidentit, Kuvendin, rajonet dhe komunat, komunitetin akademik të Maqedonisë së Veriut, universitetet, odat ekonomike, sindikatat, shoqërinë civile dhe të rinjtë.



ÇFARË PUNE BËN UNDP-JA

QEVERISJA DEMOKRATIKE

Njësia e Qeverisjes Demokratike (QD) e UNDP-së është e përkushtuar për të përmirësuar reformat e qeverisjes nëpërmjet veprimeve kolektive, një qasjeje të transformimit të sistemit dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë. Kjo njësi i lehtëson dhe i koordinon proceset e hartimit të politikave në fusha të ndryshme të politikave, të niveleve qeveritare (kombëtare dhe lokale) dhe të palëve të interesuara (publike, private, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të zhvillimit). Programi kryesor i QD-së fokusohet në mbështetjen e vendit për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH), një dokument vizionar që e përshkruan rrugën e zhvillimit për 20 vitet e ardhshme.

PROSPERITETI GJITHËPËRFSHIRËS

UNDP-ja punon për t'u mundësuar grave dhe burrave të përjashtuar nga shoqëria, të përmirësojnë jetën e tyre duke u ndihmuar përmes zgjerimit të mundësive të tyre dhe rritjes së qasjes në shërbime cilësore dhe punësimit në fusha të shumta. Përpjekjet më të mëdha bëhen për krijimin e vendeve të denja të punës dhe për uljen e papunësisë si një hap thelbësor në rritjen e përfshirjes sociale. Pjesa më e madhe e mbështetjes është përqendruar në zhvillimin e masave për rritje të qëndrueshme ekonomike, duke nxitur kapitalin rinor përmes prezantimit të mekanizmave të rinj inovativë për (ri) integrimin e personave të papunë për një kohë gjatë dhe të grupeve të tjera të cenushme.



Loreta Roguzarova, grua 48-vjeçare gjatë pa asnjë përvojë të mëparshme formale profesionale. Pas ndjekjes së trajnimit për kujdestari për personat me aftësi të kufizuara në kuadër të Programit Ekonomia e Kujdesit, për herë të parë në jetën e saj ajo është formalisht e punësuar dhe pavarur financiarisht.

MENAXHIMI I MJEDISIT JETËSOR, ENERGJISË DHE RREZIKUT NGA FATKEQËSITË

Njësia e UNDP-së për energjinë, mjedisin jetësor dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë është e përkushtuar për të ndihmuar vendimmarrësit për të përfshirë veprimet kundër ndryshimeve klimatike, humbjes së biodiversitetit, varësisë nga energjia, në punën e institucioneve të tyre. Investimi sot, promovon shëndetin e njerëzve, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e jetës, por gjithashtu mund të sjellë përfitime financiare në të ardhmen. Ne e ndihmojmë vendin në përbushjen dhe rritjen e Kontributeve të Përcaktuara Kombëtare (KPK) sipas Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike. Një nga gur themelet e njësies mbetet angazhimi i saj për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.



Stabilizimi i rrëshqitjeve është vetëm një aspekt i projektit "Përmirësimi i Rezistencës ndaj Vërshimeve në Rajonin e Pollogut" me vlerë prej 12 milionë franga zvicerane, të financuar nga Zvicra, e të cilin e zbaton UNDP-ja në partneritet me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe 9 komuna në rajonin e Pollogut.

PORTOFOLI I GJELBËR

Portofoli i Gjelbër kombinon elemente të ndryshme programore për të lehtësuar planifikimin dhe zbatimin holistik. Ai fokusohet në mekanizmat inovativë të financimit për të avancuar agjendën e gjelbër, veçanërisht për të ofruar mundësi për NVM-të dhe amvisëritë në Maqedoninë e Veriut për të pasur qasje në energjinë e rinovueshme dhe për të reduktuar emetimet e tyre të gazrave serra. Ai mbështet institucionet kombëtare dhe lokale në adresimin e sfidave të zhvillimit dhe të mjedisit jetësor, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Kjo përfshin planifikimin e zhvillimit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirës, transparencën dhe përfshirjen më të madhe të sektorit privat dhe të OSHK-ve në drejtimin e zhvillimit të komunitetit.



Projekti synonte të demonstronte një ndërhyrje të shumëanshme në trajtimin e ndotjes së ajrit në qytetin e Shkupit që lidhet me sektorin e banimit. U zhvillua sistemi i monitorimit për zonën pilot në vendbanimin e Lisiçes, së bashku me një sërë masash dhe ndryshimesh të politikave për adresimin e shkaqeve të ndotjes.



Ne ndërtojmë kapacitetet institucionale dhe të sektorit të shoqërisë civile për të parandaluar dhunën, për të promovuar mjedise pa dhunë dhe për të mbështetur të mbijetuarit.

REZULTATET

Opsione të reja për kredi “të gjelbra” për NVM-të dhe individët që nuk kanë shërbime të mjaftueshme në Maqedoninë e Veriut

Opsionet e reja të kredive me Pagesa të Bazuara në Performancë (PBP) do të vihen në dispozicion për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe shtatë grupet e synuara të individëve/amvisërive nga Maqedonia e Veriut që kanë aftësi huamarrëse, por që nuk kanë shërbime të mjaftueshme. Kreditë duhet të përdoren për investime në energji të rinovueshme (RE) dhe për zgjidhje për efikasitetin e energjisë (EE), si p.sh.: fotovoltaike,

pompa për ngrohje, inverterë, panele diellore, sisteme efikase të ngrohjes etj. Projekti “Instrumenti i Financimit të Gjelbër” zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), së bashku me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).



Thyerja e zinxhirëve të dhunës në familje



“Në fillim mendova se këto ishin vetëm shpërthime të përkohshme agresioni. Mendova se ai nuk do ta humbiste durimin përsëri. Por, filloi të ndodhte gjithnjë e më shpesh dhe përfundimisht u kthye në rutinë. Shpresoni se një ditë do të ndalet, por e keni gabim, nuk do të ndalet kurrë, thjesht situata bëhet gjithnjë e më e keqe dhe më serioze. Dhe përfundoni duke përjetuar gjithnjë e më shumë dhunë.” Kjo grua e re hezitoi për disa javë përpara se të vendoste nëse do ta tregonte historinë e saj të dhunës që e përjetonte nga duart e të burrit të saj. Më në fund, ajo na telefonoi duke shprehur gatishmërinë ta bënte këtë sepse donte të dërgonte një mesazh te gratë që janë bllokuara

në “kafazin e dhunës në familje”. “Dhuna ushtrohet vazhdimisht dhe po përqësohet.” Ajo u përball me viktimizimin edhe jashtë shtëpisë. Atë e tallnin, e përgojonin, kurse disa nga përpjekjet e saj për ta raportuar dhunën u shoqëruan me tallje. Kjo grua është një nga mijëra gra në Maqedoninë e Veriut që përjetojnë dhunë me bazë gjinore. Të dhënat zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme thonë se në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 1.117 krime të lidhura me dhunën në familje, që është një rritje prej 6% krahasuar me vitin 2021.

Rehabilitimi i rrëshqitjes së dheut në Pirok - nuk ka nevojë për “shtëpi me rrota”

Dy herë në jetën e tij, Nagip Fetahu, mësues në pension nga Piroku, dhe familja e tij, kanë përjetuar frikën dhe ankthin e shkaktuar nga rrëshqitjet e rrezikshme të dheut. Ai kujton me emocion herën e parë, vitin 1985, kur jetonin me frikë të vazhdueshme se shtëpia e tyre, e cila ishte mjaft e dëmtuar nga rrëshqitja e dheut, do të shembet. Shtëpia u plasarit, por jo edhe kujtimet. Më shumë se 33 vjet më vonë, shtëpia e mësuesit u rrezikua sërish nga rrëshqitja e dheut. “Nëse përsëritet, nëse shemben këto dy shtëpi, atëherë kemi menduar të ndërtojmë një

shtëpi me rrota, që të mund ta zhvendosim sepse kemi hapësirë të mjaftueshme” - thotë Fetahu si me shaka. Mësuesi në pension i mbi 10 gjeneratave të nxënësve të shkollës fillore “Sami Frashëri” në Pirok, në ndërhyrjet për stabilizimin e rrëshqitjeve të tokës sheh shpesh për një të ardhme më të sigurt për veten e tij, fqinjët dhe më e rëndësishmja, për fëmijët e vegjël që ndjekin mësimin në shkollën ku la gjurmë si një nga mësuesit më të dashur.



BioHack my World



UNDP-ja së bashku me Qytetin e Shkupit dhe UNICEF-in krijuan një laborator bashkëkohor për biohakim (biohacking), i cili është i hapur për publikun dhe e bën shkencën më të afërt për komunitetin e sipërmarrësve, sektorin privat, hulumtuesit e rinj dhe kompanitë fillestare (startup-et). Laboratori për biohakim ofron një ndryshim në narrativet rreth mbeturinave biologjike dhe shërben si një iniciator për transformimin e sistemit që do të frymëzojë të rinjtë të zhvendosin fokusin e tyre të interesit në

hulumtimet STEAM dhe në të ardhmen e afërt të krijojnë mundësi ekonomike duke përfshirë kompanitë fillestare (startup-et), sektorin privat, kompanitë e ndara nga kompania amë (spin off-et) që do të punësojnë fuqi punëtore shumë të kualifikuara, veçanërisht të rinjtë dhe nxënësit e shkollave të mesme. Projekti “BioHack MyWorld” është vetëm një nga shumë projekte të menaxhuara nga ekipi i #AcceleratorLab nga Maqedonia e Veriut, i cili është krijuar në tetor të vitit 2020 dhe që atëherë ka punuar si ekip brenda zyrës së UNDP-së në vend.

FAKTE KRYESORE

35

gra morën ndihmë në qendrën e këshillimit për DHBGJ në Radovich.

14,000

njerëz u konsultuan për SKZH-në nëpërmjet punëtorëve vizionarë.

129

amvisëri në Lisiçe i zëvendësuan sistemet e vjetra të ngrohjes me sisteme të reja me efikasitet energjetik.

ARMEN GRIGORYAN

Përfaqësues i UNDP-së

Si UNDP, ne mbështesim në mënyrë aktive proceset e zhvillimit në aspektet kyçe të jetës sociale, politike dhe ekonomike të vendit. Një arritje e dukshme është bashkëpunimi ynë në krijimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, duke siguruar mbështetje të gjerë për këtë dokument largpamës, duke formësuar trajektoren e vendit për dekadat në vijim.

Fokusi ynë i vazhdueshëm përfshin fuqizimin e të rinjve, grave dhe njerëzve me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e natyrës, përmirësimin e qeverisjes lokale, respektimin e sundimit të ligjit, adresimin e ndryshimeve klimatike, luftimin e ndotjes së ajrit, digitalizimin dhe reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. Me një përkushtim ndaj qasjeve inovative, ne aspirojmë të përmirësojmë kushtet e jetesës dhe të nxisim shoqëritë gjithëpërfshirëse dhe të barabarta.

UNDP në Maqedoninë e Veriut ndërton partneritete të forta me Qeverinë, Kuvendin, komunat, komunitetin akademik, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara, duke i bashkuar përpjekjet për të avancuar një agjendë të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse për zhvillim social dhe ekonomik, dhe duke punuar drejt arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.



NDRYSHIMI I JETËS SË GRAVE QË KANË MBIJETUAR DHUNËN NË MAQEDONINË E VERIUT

UNFPA-ja mbështet Qeverinë e Maqedonisë së Veriut në zbatimin e një politike të integruar kundër dhunës me bazë gjinore.



“Në strehimore, ne gjetëm paqe dhe mundëm të bënim gjumë të mirë”, tha Ana, e cila qëndroi për një vit me dy fëmijët e saj në një nga strehimoret për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Maqedoninë e Veriut.

dhunës me bazë gjinore në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit dhe për të promovuar shërbimet që janë në dispozicion të grave dhe vajzave të mbijetuara.

“Dhuna ndaj grave shpesh mbetet e pa shprehur dhe e pa raportuar. Është problem i shoqërisë në tërësi, kurse shteti dhe institucionet janë të përkushtuar që ta parandalojnë atë dhe t’i mbrojnë të mbijetuarit, të mbështesin riintegrimin e tyre në shoqëri, të dënojnë autorët e këtyre veprave dhe të ndihmojnë në risocializimin e të mbijetuarve”, tha Svetlana Cvetkovska, Udhëheqëse e Sektorit për Mundësi të Barabarta pranë Ministrisë.

Në nëntor të vitit 2022, Qeveria miratoi ndryshime në Kodin Penal për të qenë në përputhje me Konventën e Stambollit, e cila përfshin një përkufizim të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe inkriminim të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore.

“Me partnerët tanë – Ambasadën Britanike dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale – ne e mbështetëm qeverinë për të funksionalizuar kornizën ligjore, për të zgjeruar shërbimet dhe për të përmirësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave”, tha Zhaklina Geshtakovska-Aleksovska, Analiste e Programit Gjinor të UNFPA-së në Maqedoninë e Veriut.



Falë ekipit nga qendra e strehimit, tani ndihem shumë më e fortë, kam më shumë besim dhe fëmijët e mi ecin me krenari, me kokën lart.”

UNFPA-ja punon për të promovuar shërbimet e disponueshme për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ndaj grave dhe për mbrojtjen e të mbijetuarve duke kontribuar në përmirësimin e jetës së grave.

Agjencia e OKB-së mbështet Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për të integruar dhe për të zbatuar politika të integruara në mbarë shtetin kundër

ÇFARË PUNE BËN UNFPA-ja

PROGRAMI I SHËNDETIT SEKSUAL DHE RIPODHUES

Klinikat e lëvizshme gjinekologjike të krijuara me mbështetjen e UNFPA-së si përgjigje ndaj Covid-19 janë njohur nga Ministria e Shëndetësisë si alternativa më e mirë për të arritur tek gratë dhe vajzat më të cenueshme; Ministria e Shëndetësisë për të tretin vit radhazi i rrit fondet për shërbimet e ekzaminimit përmes klinikave të lëvizshme. Rritja e fundit është 18% (2.000.000 denarë në vitin 2024, krahasuar me 1.700.000 denarë në vitin 2023).

PROGRAMI I DINAMIKËS SË POPULLSISË

UNFPA-ja drejton integrimin e parimeve të qëndrueshmërisë demografike në zhvillimin e politikave të ardhshme në Maqedoninë e Veriut, duke formësuar versionin draft të Strategjisë së re Demografike për periudhën 2024-2044, që fokusohet në plakjen aktive, migrimin dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. U përfunduan parashikimet e popullsisë për 50 vitet e ardhshme dhe, për herë të parë pas 25 vjetësh, u bë një rillogaritje e vlerësimeve të përgjithshme të popullsisë midis dy rretheve të regjistrimit të fundit të popullsisë.

PROGRAMI I TË RINJVE PROGRAMI GJINOR

U zhvillua Strategjia Kombëtare për të Rinjtë 2023-2027 duke përfshirë tema të Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual në procesin formal arsimor, prezantimin e indekseve për të rinjtë, shëndetin mendor dhe mirëqenien e përgjithshme të të rinjve dhe të tjerëve. Bashkëpunimi kombëtar dhe rajonal i të rinjve u forcua përmes shkëmbimit të përvojave dhe iniciativave për ngritjen e kapaciteteve, si për shembull përmes punës me Këshillat Rinorë Lokalë, partneritetit me Olimpiadën Speciale, bashkëpunimit institucional dhe trajnimit të trajnerëve dhe punëtorive rinore lokale.

Për të funksionalizuar plotësisht Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, UNFPA-ja mbështeti autoritetet që në mënyrë gjithëpërfshirëse të zhvillojnë dhe të miratojnë një Protokoll të Ri për një përgjigje multi-sektoriale të përqendruar te viktimat e dhunës ndaj grave/dhunës në familje, si dhe të krijojnë listën e parë të 33 trajnuesve të certifikuar për DHBGJ/DHF nga të gjitha institucionet dhe OSHC-të. Protokollin siguron funksionalizimin e përgjigjes multi-sektoriale të përqendruar te viktimat ndaj dhunës me bazë gjinore.



Klinikat e lëvizshme të UNFPA-së duke vizituar zona të largëta në të gjithë Maqedoninë e Veriut.



U përfunduan parashikimet e popullsisë për 50 vitet e ardhshme – Manastir, Maqedonia e Veriut



Trajnimi i trajnerëve.



Material promovues për parandalimin dhe Mbrojtjen nga DHBGJ-ja u shpërnda në komunitetet lokale në Maqedoninë e Veriut

REZULTATET

560 gra në zona të largëta morën shërbime të SHSR-së

"Ndjenja kur shpëton edhe një jetë është më e fuqishme se çdo çmim në këtë botë. Ky është motivimi im kryesor", tha Dr. Jasminka Ajtovska, specialiste e mjekësisë familjare në fshatin Çeshinovë, e cila pa pushim ka mobilizuar gratë në fshat që të bëjnë kontrolle për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në klinikat e lëvizshme.

Nëpërmjet klinikave të lëvizshme gjinekologjike të krijuara me mbështetjen e UNFPA-së, 560 gra në zona të largëta pa gjinekolog, duke përfshirë 40 gra në burgje, klinika psikiatrike dhe përdoruese të drogës, kanë marrë shërbime të SHSR-së dhe depistime për kancerin e qafës së mitrës në vitin 2023.

"Këto gra rrallë bëjnë kontrolle gjinekologjike, sepse komuna e tyre nuk ka pasur asnjëherë gjinekolog familjar", tha Dr. Ajtovska.

Modeli i Shëndetit Seksual dhe Riprodhues (ShSR), i prezantuar fillimisht nga UNFPA-ja, me klinika të lëvizshme gjinekologjike, merr vazhdimisht financim më të madh shtetëror, duke përfshirë shumën prej 18% në vitin 2024. Gjithashtu, në kuadër të Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, në vitin 2023 janë kontrolluar 53.340 gra që nuk janë kontrolluar në 3 vitet e fundit, që paraqet një rritje prej shtatëfish nga viti 2022. Ky investim paraqet vazhdimësi të përpjekjeve të UNFPA-së në terren.



Promovimi i fjalorit @bodyright - zotëroni trupin tuaj në internet



"Kur isha 16 vjeç u përballa për herë të parë me ngacmime në internet. Nuk dija si të reagoja dhe më pas mendova se ishte faji im", e nis rrëfimin e saj aktivistja rinore, Rita Behadini nga Tetova e Maqedonisë së Veriut. "Çfarë kam bërë që ky njeri të më shkruante në këtë mënyrë?", shtoi ajo. "Pas disa vitesh kuptova se ishte ngacim, ishte dhunë dhe se kisha pasojë prej saj."

Fjalori @bodyright në gjuhët lokale synon të rrisë ndërgjegjësimin për dhunën me bazë gjinore duke përdorur teknologjinë në kuadër të fushatës globale

@bodyright të UNFPA-së. Fjalori u promovua si pjesë e fushatës së lokalizuar në Maqedoninë e Veriut ku rreth

11 influencues kombëtarë morën pjesë në aktivitete në mediat sociale duke prezantuar një të drejtë të re autoriale për trupin e njeriut. "Një fjalor mund të ndihmojë, sepse kur tregon për diçka, e mposht turpin. Çdo bisedë është një hap drejt mposhtjes së turpit, e nëse mposhtet turpi, atëherë raportimi i dhunës dhe të gjitha proceset tjera do të shkojnë më shpejt", tha Ana Vasileva, feministe dhe aktiviste.

UNFPA-ja ndër themeluesit e grupit të burimeve për punonjësit me aftësi të kufizuara

UNFPA-ja parashikon një botë të përfshirjes dhe të mundësive të barabarta, ku njerëzit do të jenë të mbrojtur nga dhuna. Në qendër të këtyre përpjekjeve në Maqedoninë e Veriut qëndron kolegu ynë, Vangell Tërkaljanov, vetë një person me aftësi të kufizuara. "Suksesi është i dukshëm kur mjediset e punës nxisin në mënyrë aktive një kulturë gjithëpërfshirëse, ku talentet unike dhe perspektivat e punonjësve me aftësi të kufizuara vlerësohen dhe shfrytëzohen", thotë Vangelli.

Duke njohur fuqinë e përvojës së përbashkët, ai kontribuoi në krijimin e një grupi burimesh për punonjësit me aftësi të kufizuara,

duke theksuar një qasje bashkëpunuese ndaj qasshmërisë dhe ndërgjegjësimin në gjithë mjedisin e punës.

"Suksesi është i vërtetë, kur organizatat i japin përparësi qasshmërisë, kur ofrojnë përshtatjen e nevojshme dhe kur mbështesin në mënyrë aktive mundësitë për zhvillim profesional të përshtatura me nevojat e punonjësve me aftësi të kufizuara," shpjegon ai. Puna e Vangellit ndryshon narrativën - personat me aftësi të kufizuara jo vetëm që janë të përfshirë, por ata e nxisin përparimin.



FAKTE KRYESORE

265

të rinj diskutuan për gjithëpërfshirjen, barazinë, dhe besimin, në 13 punëtori lokale në 10 komuna.

AFRODITA SHALJA

Shefe e Zyrës së UNFPA-së në Maqedoninë e Veriut

Misioni ynë për të ndërtuar një botë ku çdo shtazëni është e dëshiruar, çdo lindje e fëmijës është e sigurt dhe potenciali i çdo të riu/reje është i përmbyshur, është një kontribues kritik në prioritetet globale, rajonale dhe kombëtare. Ne kemi bërë përparim të rëndësishëm në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe në ofrimin e shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues (SHSR) për gratë dhe vajzat në zonat me shërbime të pamjaftueshme. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë 2023-2027, veçanërisht edukimi gjithëpërfshirës seksual, shëndeti mendor dhe mirëqenia e përgjithshme ishin prioritetet i lartë.

UNFPA-ja është në ballë të integritimit të rezistencës demografike në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2024-2044 dhe në zhvillimin e Strategjisë së re Demografike 2024-2044. Parashikimet tona të popullsisë për një periudhë 50-vjeçare dhe analiza e të dhënave ofrojnë njohuri kritike për vendimmarrjen e bazuar në prova për çështjet që lidhen me plakjen, migrimin dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Sukseset tona kolektive në vitin 2023, së bashku me partnerët tanë, tregojnë përkushtimin tonë të palodhshëm për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Ato nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen e palëkundur të Qeverisë, Zyrës së Presidentit, Kuvendit dhe partneriteteve të forta strategjike me OSHC-të, komunitetin akademik, sektorin privat, agjencitë e OKB-së dhe mbështetës të tjerë. Ne mbetemi fuqishëm të përkushtuar për të vazhduar të formësojmë vendin tonë në një vend të zgjedhur për shumë njerëz.



30 VITE PËR ÇDO FËMIJË

SË BASHKU ME PARTNERËT, UNICEF-i MBETET EDHE MË I PËRKUSHTUAR PËR TË AVANGUAR TË DREJTAT DHE REZULTATET, PËR ÇDO FËMIJË

unicef 
for every child



Një nga prioritetet e Rrjetit, duke përfshirë tani edhe laboratorin e Bioteknologjisë, është të sjellë më afër nxënësve dhe mësimdhënësve aktivitetet praktike të lidhura me shkencën dhe mjedisin jetësor.



Rrjeti për Mësim përmes Përvojës e sjell shkencën dhe aktivitetet praktike më afër nxënësve dhe mësimdhënësve.

Në bashkëpunim të ngushtë me Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe me mbështetjen e UNICEF-it, në vitin 2023 u krijua zyrtarisht Rrjeti për Mësim përmes Përvojës – një rrjet institucionesh për të sjellë shkencën dhe mjedisin jetësor më afër mësimin të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Rrjeti, i cili përfshin Shoqatën Ekologjike të Maqedonisë, Kopshtin Botanik – Shkup, Institutin Hidrobiologjik – Ohër, Qendrën Arsimore – Negrevë, Teknikën Kombëtare dhe Parkun Kombëtar – Galiçicë, ka zhvilluar dhe zbatuar një program arsimor jashtë-mësimor që i mbulon të gjitha klasat e arsimit fillor dhe të mesëm.

Deri më sot, rreth 6.000 mësimdhënësve u është ofruar mbështetje e vazhdueshme për mësimin përmes përvojës dhe mundësi për zhvillim profesional, ndërsa mbi 1.200 nxënës nga i gjithë vendi kanë marrë pjesë në punëtoritë e ofruara nga Rrjeti për Mësim përmes Përvojës.


Së fundmi, Laboratori i Bioteknologjisë i menaxhuar nga Qyteti i Shkupit dhe Drislla, janë pajtuar që t'i bashkohen Rrjetit dhe po bëhen përpjekje për të përfshirë specializimin e tyre për bioteknologjinë në programin arsimor që ofrohet për studentët në baza të rregullta.

ÇFARË PUNE BËN UNICEF-i

KUJDESI DHE PËRKUJDESJA

Rezultati i pritshëm: fëmijët dhe familjet kanë qasje të barabartë në shërbime cilësore sociale dhe shëndetësore, kujdes dhe përkujdesje dhe mbrojtje nga fatkeqësitë. Rezultatet kryesore në vitin 2023 përfshijnë:

- Mbulimi në nivel kombëtar i imunizimit rutinor u rrit për katër pikë falë forcimit të vazhdueshëm të sistemit shëndetësor.
- 17.000 përdorues aktivë të aplikacionit për prindërim Bebo dhe u siguroa qëndrueshmëri e Linjës së Ndhmës për Prindërit që ofron shërbime këshillimi
- U forcuan shërbimet për familjet kujdestare dhe u përfshinë mbi 500.000 persona përmes fushatës në rrjetet sociale, për të rritur interesin e familjeve të reja kujdestare.



U lëshuar në përdorim platforma e parë në internet me informacione mbi shërbimet shëndetësore dhe imunizimin rutinor gjatë fëmijërisë në një vend.

ZHVILLIMI PËR PËRPARIM

Rezultati i pritshëm: fëmijët dhe të rinjtë zhvillohen dhe përparojnë përmes arsimit cilësor që merr parasysh traumën dhe që është gjithëpërfshirës, si dhe përmes mbrojtjes dhe pjesëmarrjes. Rezultatet kryesore në vitin 2023 përfshijnë:

- 1.000 profesionistë morën pjesë në zhvillimin e planit kombëtar të veprimit dhe i vendosën themelet për përmirësimin e shëndetit mendor të adoleshentëve.
- Rreth 1.000 fëmijë dhe të rinj morën pjesë në programet e zhvillimit të aftësive dhe krijuan 139 produkte, politika dhe veprime në komunitet.
- 69 psikologë të shkollave, gjyqtarë, prokurorë dhe ndërmjetësues të tjerë fituan njohuri për qasjen që merr parasysh traumën, nëpërmjet trajnimit të trajnerëve, duke siguruar kështu qëndrueshmëri.



Të rinjve iu dhanë fonde fillestare për të zbatuar zgjidhje digjitale për të mbrojtur ujin, ajrin, tokën dhe burimet e energjisë.

BARAZIA DHE FUQIZIMI

Rezultati i pritshëm: mjedisi i favorshëm me fëmijën në qendër që i avancoi të drejtat e fëmijëve dhe i trajton efektet e varfërisë, fatkeqësisë dhe përjashtimit. Rezultatet në vitin 2023 përfshijnë:

- 80 plane për optimizimin e rrjetit të shkollave fillore dhe një kornizë e re financimi e zhvilluar në konsultim me palët e interesuara komunale dhe kombëtare.
- Prova kritike dhe udhëzime për reformën e politikave të krijuara për të përmirësuar imunizimin dhe shërbimet e vizitave në shtëpi.
- U krijua korniza politike për të integruar Sistemin e Menaxhimit të Keqinformimit në Ministrinë e Shëndetësisë.



Nevoja për reformimin e financimit të arsimit fillor dhe optimizimin e rrjetit të shkollave është miratuar dhe është përfshirë në Strategjinë Fiskale Kombëtare.

RIKONFIRMIMI I ANGAZHIMIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

FAKTE KRYESORE

Zbuloni më shumë rreth Vëzhgimeve Përmblyëse të Komisionit për të Drejtat e Fëmijëve

Kujdestaria dhe kujdesi ndaj fëmijëve, së bashku me shtëpitë e grupeve të vogla, janë bërë alternativat kryesore të ngjashme me familjen për fëmijët pa kujdes prindëror, pas deinstitutionalizimit të suksesshëm të fëmijëve nga institucionet e përmasave të gjera në vitin 2019.

Vetëm 13 komuna (16%) në vend përmbushin standardin ligjor të klasave me të paktën 20 nxënës. - 43% e fëmijëve në shkollat territoriale mësojnë në klasa të vogla ku kombinohen fëmijë të klasave të ndryshme, duke rezultuar me të mësuar jo-optimal.

FËMIJËT E MARRIN PËRSIPËR KUVENDIN

"Zonja dhe zotërinj deputetë, po e hap seancën e Kuvendit "Fëmijët e marrin përsipër Kuvendin" – Anisija Ugrinovska, në rolin e kryetares së Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, zyrtarisht e hapi seancën kushtuar të drejtave të fëmijëve, ku morën pjesë rreth 50 fëmijë nga i gjithë vendi, dhe udhëhoqi diskutimin mbi çështjet dhe shqetësimet e tyre më urgjente. Ngjarja u organizua në Ditën Botërore të Fëmijëve, për të shënuar 30 vjetorin që kur Maqedonia e Veriut ratifikoi KDF-në dhe ishte një mundësi për Kuvendin që të riafirmonte përkushtimin e tij ndërpartiak për të punuar drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve



TË JESH PRIND KUJDESTAR DO TË THOTË TË KUJDESESH PËR FËMIJËN SIKUR ËSHTË PJESË E FAMILJES TËNDE



Majlinda dhe bashkëshorti i saj Donço janë ndër kujdestarët e paktë në Maqedoninë e Veriut që kujdesen për foshnja. Për një periudhë prej disa muajsh, ata sigurojnë që foshnja të rritet në një mjedis të dashur familjar, derisa sistemi të gjejë një zgjidhje të përhershme, siç është ribashkimi i fëmijës me familjen e tij biologjike ose gjetja e një familje birësuese. Zbuloni më shumë rreth mbështetjes së UNICEF-it për kujdesin alternativ të bazuar në familje.

PSE DUHET TË RIORGANIZOHEN BURIMET E SHKOLLAVE FILLORE

Zhivko në mënyrë të pavarur mëson krah për krah me bashkëmoshatarët e tij në shkollën fillore "Risto Shuklev" në f. Negorci, falë shkathtësisë së shkollës për të gjetur zgjidhje për të përmirësuar qasshmërinë. Megjithatë, shumica e shkollave fillore kanë fonde të pamjaftueshme për shpenzimet e vazhdueshme të renovimit dhe të mirëmbajtjes së objekteve në gjendje të mirë dhe për të mundësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve. UNICEF-i e mbështet Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, komunat, komunitetet lokale të shkollave, nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit për të zhvilluar plane të detajuara komunale me të cilat do të përshtatet rrjeti i shkollave në përputhje me numrin e nxënësve, do të sigurohet një shpërndarje më të mirë e punonjësve dhe do të krijohen kushte adekuate për mësim. UNICEF-i gjithashtu mbështeti rishikimin e sistemit të

financimit të shkollave, për të mundësuar sigurimin e kushteve adekuate për mësim në çdo shkollë dhe përdorimin efikas të burimeve.



PATRIZIA DIGIOVANNI

Përfaqësuese e UNICEF-it në Maqedoninë e Veriut

Viti 2023 shënoi një vit të rëndësishëm për fëmijët në vend – ishte viti për të festuar 30 vjetorin që kur vendi ratifikoi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe 30 vjet që kur UNICEF-i vendosi zyrtarisht bashkëpunimin pasi vendi u bë shtet i pavarur.

Përderisa reflektojmë mbi progresin e arritur për fëmijët, duam të falënderojmë qeverinë dhe të gjithë partnerët për angazhimin e tyre për të siguruar që çdo fëmijë të ketë një të ardhme më të mirë dhe një shans të mirëfilltë për të zhvilluar potencialin e tij të plotë.



LUFTA KUNDËR DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR NË NIVEL KOMBËTAR DHE GLOBAL

VEPRIMI KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT EKONOMIK



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime



Për të forcur kapacitetet e rikuperimit të aseteve të autoriteteve përkatëse nga Maqedonia e Veriut, UNODC ka mbështetur zhvillimin e Udhëzuesit për reagim të shpejtë (FARG) për rikuperimin e aseteve. Udhëzuesi u ofron autoriteteve përkatëse kombëtare një mjet të thjeshtë që u mundëson atyre të kenë një pasqyrë të shpejtë të elementeve ligjore dhe operacionale që duhet të merren parasysh për të kryer hetime penale dhe paralele financiare.

Udhëzuesi i zhvilluar do t'u mundësojë praktikuesve përkatës të identifikojnë në mënyrë më efektive opsionet praktike të disponueshme për ta pas zbulimit të një veprë penale dhe të përcaktojnë veprimet, burimet dhe mjetet e duhura të nevojshme për kryerjen e hetimeve dhe rikuperimin e të ardhurave nga krimi. Udhëzuesi fokusohet në nevojat specifike ligjore, rregullatore dhe

operacionale që kërkohen për të sekuestruar në mënyrë efektive asetet me synimin për konfiskimin e tyre në të ardhmen. Për këtë qëllim, udhëzuesi përshkruan hapat që do të duhet të ndërmerren në nivel operacional, duke e kryqëzuar atë me dispozitat ligjore dhe rregullatore përkatëse.

Procesi i rikuperimit të aseteve është punë komplekse, që kërkon burime dhe kërkon kohë për praktikuesit e specializuar. Ai kërkon bashkëpunim dhe koordinim të përhershëm midis autoriteteve kombëtare përkatëse (p.sh., agjencitë e inteligjencës, autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët), si dhe me homologët e tyre të huaj. Përpjekjet shpesh pengohen nga, ndër të tjera, sfida e identifikimit të të ardhurave dhe instrumenteve të krimit, tejkalimi i kërkesave ligjore të paqëndrueshme ose të rënda që mund të ekzistojnë në nivel kombëtar ose përtej kufijve, dhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Shumë nga këto sfida mund të zbuten me një qasje konsistente dhe të harmonizuar në nivel kombëtar me legjislacionin dhe rregulloret ekzistuese.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të "Strategjisë kombëtare për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimit financiar dhe rikuperimit të aseteve 2021-2023", zbatimi i së cilës koordinohet nga Kabineti i Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë, nëpërmjet Komisioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, me mbështetjen e UNODC.

SI FUNKSIONON UNODC

REZULTATE KRYESORE

UNODC zbatoi 16 konferenca, punëtori, trajnime dhe simulime kombëtare dhe rajonale që përfshinin 128 palë të interesuara multidisiplinare nga Maqedonia e Veriut. Vendi tani posedon kapacitete të zgjeruara për identifikimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të trafikimit të personave dhe kontrabandës së migrantëve me fokus viktimat dhe traumat, shoqëruar me mbrojtje dhe ndihmë të përmirësuar në nivel kombëtar.

PERGJIGJET NDAJ TRAFIKIMIT TË NJEREZVE DHE KONTRABANDËS TË MIGRANTËVE

Seksioni i Trafikimit të Njerëzve dhe Kontrabandës së migrantëve mbështet vendet dhe komunitetin ndërkombëtar në zhvillimin dhe zbatimin e përgjigjeve efektive ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së migrantëve, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe në respekt të plotë të të drejtave të njeriut.

Sofçe Gavrilova Efremova, ka qenë aktive në gjyqësorin në Maqedoninë e Veriut për më shumë se 11 vjet. Për gjashtë vitet e fundit, ajo ka punuar si gjyqtare penale në një departament të specializuar që merret me çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.


Ne vazhdimisht kemi të bëjmë me raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Po shohim një rritje të rasteve që kanë të bëjnë me fëmijët, veçanërisht ato që përfshijnë prindërit e tyre apo të afërm të tjerë. Ka edhe raste trafikimi që kryhen online dhe nëpërmjet përdorimit të mediave sociale.

Si gjykatë që merret me rastet e krimit të organizuar, është shumë e rëndësishme për ne që të bashkëpunojmë me organizata ndërkombëtare, si UNODC. Ekspertët atje na ndihmojnë të përmirësojmë njohuritë tona në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Kjo është e rëndësishme sepse ky krim është shumë specifik dhe i ndryshëm nga format e tjera të krimit. Kemi të bëjmë me të rinj dhe fëmijë dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm në qasjen tonë për të punuar me ta.

Bashkëpunimi është gjithashtu shumë i dobishëm sepse përmes ngjarjeve që organizon UNODC, ne mund të takojmë aktorë të tjerë dhe homologë tanë nga vende të tjera. Në këtë mënyrë ne mësojmë se si vendet e tjera reagojnë ndaj krimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Kemi mundësinë të takohemi dhe të shkëmbejmë përvoja me kolegët dhe të ndajmë njohuritë.

Këto ngjarje janë thelbësore për të krijuar kontakte. Në disa raste duhet të kërkojmë ndihmë reciproke juridike nga një vend tjetër. Ndonjëherë një viktimë është kthyer në shtëpi dhe ne duhet të organizojmë një dëshmi përmes lidhjes video, dhe për këtë duhet të bashkëpunojmë me gjykatat e vendeve të tjera.



Negru Alex

REZULTATET

SIGURIMI I QIELLIT DHE KUFIJVE NJË QASJE DINAMIKE PËR LUFTIMIN E KRIMIT

Që nga viti 2020, UNODC ka udhëhequr procesin e krijimit dhe funksionalizimit të grupeve të përbashkëta ndërinstitucionale të aeroportit të përbëra nga Task Forcat e Përbashkëta të Ndalimit të Aeroportit (JAITF) me fokus pasagjerët dhe Njësitë e Kontrollit të Transportit Ajror (ACCU) që fokusohen në ngarkesat në aeroportet ndërkombëtare të Shkupit. Sarajeva dhe Beogradi janë kuadri i veprimit të përbashkët BE-UNODC për promovimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të synuara të kontrollit kufitar në portet dhe aeroportet në Evropën Juglindore, të financuara bujarisht nga Bashkimi Evropian. Aksioni zbatohet nga UNODC-WCO Programi i Kontrollit të Kontejnerëve (CCP) dhe UNODC-INTERPOL-WCO Projekti i Komunikimit të Aeroportit (AIRCOP) në bashkëpunim me Programin Rajonal për Evropën Juglindore ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të autoriteteve në Ballkanin Perëndimor, për të luftuar krimin e organizuar duke mbështetur reagime më efektive dhe të koordinuara ndaj trafikimit të paligjshëm të zbatuar nga forcat e zbatimit të ligjit kufitar në pikat e kalimit kufitar tokësor dhe portual dhe aeroportet ndërkombëtare në rajon. Në Maqedoninë e Veriut, grupi ndërinstitucional i aeroportit AIRCOP/CCP i udhëhequr nga projekti i parë i quajtur Njësia Ndërinstitucionale Kufitare (BIU) u hap zyrtarisht në prill 2022 në aeroportin ndërkombëtar të Shkupit dhe është një ent i njohur brenda strukturës së sigurisë së vendit.



Që nga fillimi i aksionit, UNODC ka mbështetur policinë kufitare dhe doganierët për të qenë pjesë e grupeve ndërinstitucionale me ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve, mentorimin dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal. Si pjesë e kësaj mbështetjeje, UNODC realizoi një vizitë të përbashkët mentoruese njëjavore në BIU në aeroportin e Shkupit në mars, të realizuar së bashku me WCO dhe Administratën Doganore të Republikës Çeke. Gjatë këtij aktiviteti, në bashkëpunim me Doganën, BIU sekuestroi 43 kg bizhuteri floriri një pasagjeri që mbërriti me një fluturim nga Stambolli. Me vlerësim të përgjithshëm prej 2,3 mil. Euro nga mallrat e sekuestruara, sekuestrimi është regjistruar si më i madhi në Maqedoninë e Veriut.

BALLAFAQIMI ME FINANCIJMIN TERRORIZMIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE



Projekti i UNODC-së ndihmoi gjyqtarët dhe prokurorët e Maqedonisë së Veriut që në mënyrë më efektive të hetojnë, arrestojnë, ndjekin penalisht, dënojnë dhe pengojnë terroristët, rrjetet terroriste dhe grupet e krimin të organizuar të lidhur me pastrimin e parave. Gjatë gjithë kursit, pjesëmarrësit trajnohen duke përdorur skenarë të lokalizuar që pasqyrojnë çështjet që zakonisht do të

lindin në juridiksionin e Maqedonisë së Veriut. Materialet e kursit përfshijnë gjithashtu kornizën legjislative vendase të përdorur gjatë ndjekjes penale dhe kërkimit të dënimeve për terroristët dhe rrjetet terroriste. Prokurorët mund të vërtetojnë më mirë veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në gjykatë dhe gjyqtarët janë më të pajisur për të gjykuar raste të tilla.

LUFTIMI I FLUKSEVE FINANCIARE TË PALIGJSHME TË LIDHUR ME KRIMIN E ORGANIZUAR

Në një përpjekje për të forcuar mbrojtjen kolektive të Shteteve Anëtare kundër kërcënimeve kriminale që rrjedhin nga krimi i organizuar, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) kreu një seri kursesh trajnimit gjithëpërfshirëse për të rritur aftësitë e pjesëmarrësve në luftën kundër pastrimit të parave (ML) dhe përçarja e grupeve të krimin të organizuar (OCG).

UNODC pajisi pjesëmarrësit me aftësi dhe njohuri të avancuara për të rritur efektivitetin e tyre në luftën kundër pastrimit të parave dhe përçarjes së grupeve të krimin të organizuar, me fokus në analizimin e hetimeve paralele financiare dhe përdorimin e profileve financiare, identifikimin e treguesve të efektivitetit në ndërprerjen e aktiviteteve kriminale, nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimin e ligjit, përpjekjet.



LUFTIMI I DROGES DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR



UNODC vazhdon të ndërlidhet me homologët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e trafikut të drogës, trajtimin të drogës dhe parandalimit të drogës përmes iniciativave të shumta në nivel strategjik dhe operacional, duke përfshirë kërkimin e tendencave më të fundit dhe modus operandi të rrugës ballkanike dhe grupeve të krimin të organizuar, përfshirë në trafikun e paligjshëm të heroinës, kokainës, kanabisit dhe ATS dhe planifikimin e ardhshëm për ngritjen e kapaciteteve të LE në zonën e NPS dhe kërcënimin e fentanilit. Nëpërmjet Iniciativës së Paktit të Parisit të UNODC-së, vendi përfshihet

aktivisht në përpjekjet për të luftuar kundër trafikut të drogës duke ofruar informacion për Fletët e Fakteve të Vendit dhe përmes shkëmbimit të të dhënave për Pyetësorët e Raportit Vjetor, Konfiskimet Individuale të Drogës dhe Raportin Botëror të Drogës. Vendi po forcon kapacitetet e tij strategjike përmes institucioneve përkatëse nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Grupet e Punës Globale të Ekspertëve të Iniciativës së Paktit të Parisit (EWG) mbi Shtyllat IV të Deklaratës së Vjenës dhe në takimin e Grupit Konsultativ të Politikave (PCGM) ku rekomandimet e EWG-së po miratohen.

TRAJTIMI I NJË PREJ PIKAVE MË TË NGUTSHME EKOLOGJIKE NË SHKUP ANGAZHIMI LOKAL DHE MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE TRAJTOJNË KONTAMINIMIN E RREZIKSHËM



Në Shkup, i varrosur nën tokë, qëndron një kërcënim i heshtur: 50.000 ton lindan të rrezikshëm, duke ndotur tokën, ujin dhe ajrin e qytetit. Goran Stojanovski, një fermer nga Draçeva, gjithmonë kishte frikë nga pyetja e klientëve të tij: "Ku është prodhuar kjo?" Ai i teston produktet e tij rregullisht dhe cilësia e prodhimit të tij është gjithmonë e mirë, por duke qenë se ferma e tij është vetëm 5 km larg OHIS-it, klientët e tij ndonjëherë refuzojnë të blejnë prej tij. "Unë mund t'i kuptoj ata pasi nuk mund ta injorojmë rrezikun që fshihet nën këmbët tona. Kështu që, është mirë që më në fund kjo çështje po zgjidhet", theksoi Gorani. Përpjekjet për pastrim, të mbështetura tani nga BE-ja dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut, do të kontribuojnë në zgjidhjen e problemit shumëvjeçar të ekspozimit ndaj kësaj lënde toksike për zonat urbane të populluara dendësisht në kryeqytet. Pas aktiviteteve të mëparshme përgatitore të infrastrukturës, UNOPS-i organizoi largimin efektiv të 525 tonë të mbeturinave HCH dhe 210 tokë të kontaminuar me HCH në vitin 2023, ndërsa përpjekjet e rehabilitimit do të vazhdojnë në vitin 2024 me mbështetjen të mëtejshme nga BE-ja.

ÇFARË PUNE BËN UNOPS-I

MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN E MAQEDONISË SË VERIUT NË BE

Projekti "Mbështetje për Anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE", i financuar nga Suedia dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut gjatë 14 muajve, synon të lehtësojë anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Ai fokusohet në aktivitetet që mbështesin shqyrtimet dypalëshe, harmonizimin e legjislacionit me standardet e BE-së, ofrimin e asistencës teknike dhe avancimin e reformave themelore. Projekti synon të forcojë kapacitetet institucionale, të përmirësojë funksionet e Sekretariatit për Çështjet Evropiane, të promovojë qeverisjen e mirë, të luftojë korrupsionin dhe të përmirësojë komunikimin publik për të mbështetur përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për integrim në BE.



Përfaqësuesit e OSHC-ve diskutojnë modalitetet për pjesëmarrjen e tyre në procesin e anëtarësimin në BE

BE-ja PËR AJËR TË PASTËR

Projekti i BE-së për Ajër të Pastër, i financuar me 10 milionë euro nga Bashkimi Evropian, synon të përmirësojë cilësinë e ajrit në katër qendrat urbane të Maqedonisë së Veriut gjatë 36 muajve. Ai trajton ndikimet shëndetësore dhe ekonomike të ndotjes, duke mbështetur prioritetet e zhvillimit të gjelbër. Projekti kontribuon në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, duke u fokusuar në përmirësimin e sistemeve të ngrohjes, blerjen e autobusëve që nuk e ndotin mjedisin jetësor, mbjelljen e pemëve, eksplorimin e parakushteve për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes dhe instalimin e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit.



Inspektimi i vendeve të planifikuara për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes.

FONDI EKOLOGJIK ME SHUMË PARTNERË I OHIS-it

Fondi Ekologjik me Shumë Partnerë (FESHp) që u krijua për të adresuar sfidat urgjente ekologjike të paraqitura nga ish-fabrika "OHIS" afër Shkupit, synon të mbështesë përpjekjet e qeverisë për të rehabilituar këtë pikë kritike të ndotjes. Duke mobilizuar burime financiare, si nga burimet kombëtare ashtu edhe nga ato ndërkombëtare, FESHp-ja shërben si një mjet thelbësor financiar dhe menaxhues për pastrimin sistematik të ndotjes së rrezikshme me lindan në atë lokacion. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla si gërmimi, transporti dhe asgjësimi i mbeturinave duke përdorur teknikat e dekompozimit termik në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, FESHp-ja synon të eliminojë ose minimizojë ndikimin e rëndë të vendit të ndotur në ekosistemet dhe shëndetin e njeriut.



Mbeturinat HCH dhe toka e kontaminuar duke u përgatitur për transport në vendet e djegies.

REZULTATET

FAKTE KRYESORE

500+

nëpunës civilë u trajnuan për procesin e anëtarësimit në BE.

15

gazetarë u trajnuan për raportimin mbi procesin e anëtarësimit në BE.

103

dokumente legjislative u përgatitën në mbështetje të harmonizimit me BE-në.

735

ton mbeturina dhe toka e kontaminuar janë

Raportimi nga vendngjarja - rëndësia e mediave në procesin e anëtarësimit në BE

Mbulimi i BE-së, në thelb është i vështirë për gazetarinë, veçanërisht për shkak të proceseve komplekse të anëtarësimit, që janë të vështira për t'u kuptuar nga njerëzit e zakonshëm. Gjithashtu, është sfiduese të përcillen lajme që do të ndikojnë ndjeshëm në jetën tonë të përditshme, vendime që mund të ndikojnë në komunitet në mënyrë pozitive ose negative, ose masa për të cilat do të duhen vite për të hyrë në fuqi. Është pak më ndryshe kur mund të raportoni drejtpërdrejt nga vendngjarja, tha Nermin Mulaki, një gazetarë me përvojë, një nga 15 gazetarët që ndoqën trajnime për raportim për procesin e anëtarësimit në BE në Shkup dhe në Bruksel. "Kjo përvojë ka qenë frymëzuese. Takimi me zyrtarë dhe diplomatë të BE-së, duke dëgjuar njohuritë e tyre nga dora e parë, më ka dhënë një lente të re përmes së cilës mund të shikoj rolin tonë në këtë proces." Në fakt, çdo bisedë, çdo takim, ishte një dëshmi e fuqisë së gazetarisë për të përkthyer një mesazh shumë të ndërlikuar në fjalë të thjeshta, për të sjellë më pranë publikut të tyre kompleksitetin e procesit

të anëtarësimit në BE por, edhe për të gjeneruar debat publik për detajet që janë të rëndësishme. Dhe ndërsa ktheheshin në shtëpi, të armatosur me njohuri dhe frymëzim, këta gazetarë e dinin se me vete mbanin jo vetëm storjet, por edhe përgjegjësinë për të ofruar informacion të besueshëm mbi rrugën e vendit të tyre drejt anëtarësimit në BE.



Së bashku për ajër të pastër!



Ndotja e ajrit prek gjithçka. Në qytetin e Shkupit, në Maqedoninë e Veriut, Ana u zgjua në një mëngjes tjetër me mjegull. Ndërsa shikonte nga dritarja e saj, ajo nuk mund të mos vinte re batanijen e trashë të smogut që kishte mbështjellë qytetin. Anës iu kujtuan

shumë raste kur ishte kollitur për shkak të ajrit të ndotur. Dhe si ajo nuk mund të shijonte vrapimet e saj të mëngjesit gjatë dimrit, për shkak të niveleve të larta të ndotjes së ajrit. Projekti i BE-së për Ajër të Pastër ofron mbështetje për katër qytete, Shkupin, Tetovën, Manastirin dhe Kumanovën në trajtimin e ndotjes së ajrit. Me iniciativat për futjen e burimeve të pastra të ngrohjes në ndërtesat publike dhe krijimin e brezave të gjelbër, ka një shkëndijë optimizmi për një të ardhme më të shëndetshme. Siç tha edhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, zonja Shukova kur filloi projekt - "vetëm së bashku mund t'i arrijmë qëllimet dhe të ulim ndotjen e ajrit". Megjithatë, mbështetja prej 10 milionë eurosh nga BE-ja përmes këtij projekti do të kontribuojë në një masë, por nuk do ta zgjidhë problemet e ndotjes së ajrit. Prandaj, lufta kundër ndotjes së ajrit duhet të jetë një përpjekje e vazhdueshme, e përbashkët e institucioneve, organizatave dhe qytetarëve. Pasi të gjithë thithim të njëjtin ajër.

MICHELA TELATIN

UNOPS Representative

Iniciativat tona në vitin 2023 ishin të dyfishta, duke u fokusuar në adresimin e sfidave ekologjike dhe mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE. Duke konsoliduar ekspertizën në fushat kryesore të reformës, ne forcua gatishmërinë e vendit dhe e pozicionuam atë në mënyrë të favorshme për negociatat e anëtarësimit në BE. Ne vazhduam të lehtësojmë sanimin e lokacionit të mbeturinave të rrezikshme në ish-fabrikën "OHIS" dhe nisëm një projekt për uljen e ndotjes së ajrit në katër qytete kryesore.

Këto përpjekje jo vetëm që rrisin mjetet e jetesës, por gjithashtu mundësojnë një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm. Ne jemi krenarë që bashkëpunojmë me BE-në, Mbretërinë e Suedisë dhe Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për të adresuar nevojat urgjente dhe për të kontribuar në prioritetet strategjike të përkshkuara në Kornizën aktuale të Bashkëpunimit të OKB-së.



TË DËGJOHET ZËRI I GRAVE NË VENDIMARRJEN LOKALE NË MAQEDONINË E VERIUT LOKALE NË MAQEDONINË E VERIUT FORCIMI I KAPACITETEVE TË GRAVE LOKALE PËR AVOKIM DHE RRJETËZIM



©Akcija Zdruzenska

Lejla Asanovska, një grua e re nga Papraniku i Vogël, një fshat i banuar nga pakica turke në Qendrën e Zhupës, ishte ndër aktivistet e para që e kuptoi nevojën të merret parasysh zëri i grave në vendimarrjen lokale. E mbështetur nga organizata lokale "Radika De" dhe organizata e shoqërisë civile "Akcija Zdruzenska", ajo udhëhoqi themelimin e Qendrës së Grave, një simbol i fuqizimit në komunitetin e saj. Fillimisht me një pjesëmarrje modeste, Qendra shpejt u bë një pikë tubimi për gratë me prejardhje të ndryshme, të cilat u bashkuan nga sfidat dhe aspiratat e përbashkëta. Nëpërmjet përpjekjeve bashkëpunuese dhe të mbështetura nga iniciativa si projekti i UN Women "Promovimi i Politikave dhe Buxheteve të Përgjegjshme Gjinore: Drejt Qeverisjes Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut", mijëra gra nga 25 fshatra fituan qasje në burime jetike dhe mundësi për rrjetëzim. Për Asanovskën, Qendra përfaqëson më shumë se vetëm tulla dhe llaç, ajo mishëron solidaritetin dhe përparimin.

ÇFARË PUNE BËN UN WOMEN

PLANIFIKIMI DHE BUXHETIMI KOMBËTAR

Ndërmjet viteve 2018-2023, UN Women zbatoi projektin, "Promovimi i Politikave dhe Buxheteve të Përgjegjshme Gjinore: Drejt Qeverisjes Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut", i financuar nga Zvicra dhe Suedia. Synimi i tij ishte përfshirja e grupeve më të cenueshme, përmes integritit gjinor, në të gjitha fazat e proceseve të hartimit të politikave dhe buxhetimit në nivel kombëtar dhe lokal. Nga viti 2023, UN Women zbaton projektin "Promovimi i Politikave dhe Buxheteve të Përgjegjshme Gjinore: Drejt Qeverisjes Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Faza 2", i financuar nga Zvicra, dhe programin "Promovimi i Qeverisjes së Përgjegjshme Gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut", i financuar nga Suedia. Ato fokusohen në mbështetjen e integritit gjinor në politikat fiskale dhe proceset buxhetore, rritjen e kapaciteteve të ministrive të linqës dhe të institucioneve shtetërore në hartimin e politikave të përgjegjshme gjinore, promovimin e mjeteve buxhetore të përgjegjshme gjinore në komuna, avokimin për llogaridhënien për barazi gjinore në Kuvend dhe forcimin e organizatave të shoqërisë civile.

INSTRUMENTI I BARAZISË GJINORE

Qëllimi i projektit "Shërbime Këshilluese për Integrimin Gjinor për administratën e nivelit qendror të Maqedonisë së Veriut" – Instrumenti për Barazi Gjinore (IBGJ), i financuar nga Suedia, është të mbështesë Qeverinë e Maqedonisë së Veriut në transpozimin e legjislacionit të BE-së për barazinë gjinore dhe lehtësimin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Ai është i fokusuar në iniciativat kryesore si Programi Kombëtar për Adoptimin e Legjislacionit dhe programet IPA të financuara nga BE-ja, duke rritur integrimin gjinor në proceset e planifikimit dhe zbatimit. Rezultatet kryesore të përfshira janë pajisja e njëjësive dhe organeve vendimmarrëse relevante me aftësi për programim gjithëpërfshirës gjinor dhe fuqizimi i mekanizmave kombëtarë gjinorë për të integruar gjininë në proceset e planifikimit dhe për të zbatuar legjislacionin e BE-së për barazinë gjinore. Përmes dialogut politik, ekspertizës teknike dhe partneriteteve strategjike, projekti IBGJ mbështet zbatimin e standardeve dhe legjislacionit të barazisë gjinore në përputhje me rregulloret e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare. Kjo mbështetje tani vazhdon si pjesë e programit "Promovimi i Qeverisjes së Përgjegjshme Gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut", i financuar nga Suedia.

DHËNIA FUND DHUNËS NDAJ GRAVE

Programi "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve" i financuar nga Bashkimi Evropian synonte të arrinte tre qëllime: harmonizimin e kornizës ligjore dhe të politikave me standardet ndërkombëtare për të luftuar dhunën ndaj grave dhe diskriminimin, promovimin e qëndrimeve shoqërore për të parandaluar dhunën me bazë gjinore dhe fuqizimin e grave, veçanërisht të atyre që vijnë nga grupet e marginalizuara, për të pasur qasje dhe për të avokuar për shërbime cilësore. Programi u zbatua kryesisht përmes organizatave të grave, veçanërisht atyre që u shërbejnë grupeve të pafavorizuara, duke synuar krijimin e një mjedisi të favorshëm për barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave. Pas zbatimit të programit, Maqedonia e Veriut e ndryshoi Kodin e saj Penal në shkurt të vitit 2023 për t'u përfaqësuar më tej me Konventën për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur gjithashtu si Konventa e Stambollit. Me këtë është rritur mbrojtja e grave ndaj formave të ndryshme të dhunës.



Përfaqësues nga Akcija Zdruzenska diskutojnë për nevojat, prioritetet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gratë në Komunën e Qendrës së Zhupës.



Pjesëmarrësit duke punuar në vizualizimin e të dhënave gjinore në Programin trajnues për të dhënat gjinore në Izmir, Turqi.



Ngjarja përmbyllëse e programit rajonal të EVAW "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve" në Maqedoninë e Veriut me partnerë dhe përfitues.

REZULTATET

FAKTE KRYESORE

42

punonjës të administratës shtetërore u trajnuan për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

277

përfaqësues të administratës publike dhe këshilltarë komunalë nga 33 komuna i forcan kapacitetet e tyre për BPGJ.

50

hulumtues, gazetarë, avokues gjinorë dhe aktivistë i ngritën kapacitetet e tyre për të përdorur të dhënat gjinore.

40

përfaqësues nga OSHC-të dhe komunat nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut shkëmbyen njohuritë dhe përvojat për krijimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje.

Çdo dorë e shtrirë për një grua të mbijetuar është një jetë e shpëtuar

Rrugëtimi i Stojne Mitevës mishëron qëndrueshmërinë dhe përkushtimin në luftën kundër dhunës në familje. Si psikologe në Qendrën e Strehimit dhe Këshillimit të menaxhuar nga Sky Plus, përpjekjet e saj janë ndihmuar nga programi i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga UN Women, "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve". Me këtë ndihmë, Qendra zgjeroi shërbimet e saj, duke punësuar më shumë specialistë dhe rriti kapacitetin e saj për të strehuar më shumë gra dhe fëmijë që ikin nga situata të dhunshme. Miteva, një gazetare dhe aktiviste e shoqërisë civile, aktualisht drejton qendrën më të madhe të strehimit në Maqedoninë e Veriut, duke siguruar një strehë të sigurt për deri në 12 gra dhe fëmijët e tyre. Në një botë ku viktimat shpesh ecin vetëm në shtigjet e jetës së tyre, Qendra



e Strehimit dhe Këshillimit shërben si fener shprese, falë angazhimit të vazhdueshëm të Mitevës dhe mbështetjes së iniciativave që synojnë t'i japin fund dhunës ndaj grave.

Entuziastët e të dhënave do të udhëheqin ndryshimin transformues



Stefan Tanevski, asistent universitar, parashikoi një të ardhme ku njohuritë e tij të reja mund të ndriçojnë studentët e tij, duke shpalosur ndikimin e të dhënave gjinore në klasë. Për Elena

Kočoskën, avokate për gjininë dhe aftësinë e kufizuar, të dhënat gjinore u shfaqën si një mjet i fuqishëm për ndryshime sociale, duke hedhur dritë mbi pabarazitë shoqërore dhe duke hapur rrugën për një të ardhme ku çdo individ, pavarësisht nga dallimet e tij, gëzon të drejta të barabarta. Programi trajnues (Boot-camp) për të dhënat gjinore krijoi një valë fuqizimi midis pjesëmarrësve të tij, duke shkaktuar një valë ndryshimesh për pjesëmarrësit e tij duke nxitur edukimin për përdorimin e të dhënave dhe duke shfrytëzuar fuqinë e të dhënave gjinore për të arritur barazinë gjinore. Me një grup të gjërë aktivistësh lokalë, studiuesish dhe anëtarësh të shoqërisë civile, programi trajnues u bë një qendër për bashkëpunim dhe ndarjen e aftësive. Pjesëmarrësit u thelluan në fushën e analizës së të dhënave, duke u mbështetur në ide nga burime të ndryshme, duke përfshirë Entin Shtetëror të Statistikave.

VESNA IVANVIKJ-CASTAREDE

Shefe e Zyrës së UN Women në Maqedoninë e Veriut/Specialiste

Ne, në UN Women riafirmojmë angazhimin tonë të palëkundur për të avancuar më tej fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në vend. Vazhdojnë stereotipet gjinore të rrënjosura thellë dhe sfidat e ndërlydhura, si dhe dhuna dominuese ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, ndërkohë që përfaqësimi i grave në pozitat vendimmarrëse është i ulët. I mirëpresim angazhimet e vendit për arritjen e barazisë gjinore dhe drejtësisë gjinore, me ç'rast ratifikimi i konventave të rëndësishme dhe formulimi i planeve të veprimit janë hapa shumë të rëndësishëm, andaj inkurajojmë përmirësimet dhe investimet më të mëtejshme për të pasur një progres të qëndrueshëm. Aktivitetet tona të vazhdueshme janë të fokusuar në qeverisjen dhe buxhetet e përgjegjshme gjinore, integrimin e politikave, harmonizimin me standardet e BE-së për barazinë gjinore, parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fuqizimin e grave në fusha historikisht të plotësuara kryesisht nga burrat. Ne punojmë me qeverinë dhe shoqërinë civile për të arritur ndryshime domethënëse, duke siguruar që të drejtat dhe fuqizimi i grave në çdo fushë të jetës të mbeten në krye të agjendave kombëtare.



HËNDETI ËSHTË E DREJTË E NJERIUT

OBSH-ja PROMOVON SHENDEIN PËR TË GJITHË



Për sa i përket forumeve tona në komunitet për shëndetin mendor tek fëmijët dhe adoleshentët, Zurija Memedova, aktiviste nga BIOM Shkup, tha: "Angazhimi i lidhereve femra në veprimet e bazuara në komunitet në lidhje me shëndetin mendor dhe imunizimin e fëmijëve është vendimtar. Ne rrisim ndërgjegjësimin në të gjithë komunitetin dhe avokojmë për zgjidhje adekuate. Ne i bashkohemi çdo aspekti të jetës në komunitet, duke pasur qasje të drejtpërdrejtë në popullatën më të re përmes amësisë, mësimdhënies, këshillimit, punës administrative dhe udhëheqjes. Forumet në komunitet të OBSH-së në nivel komunal fuqizojnë udhëheqësit lokalë për ndryshime të iniciuara nga komuniteti nga poshtë lart. Duke qenë vetë të zëshëm, ne i japim zë komuniteteve tona!"

ÇFARË PUNE BËN OBSH-ja

FORCIMI I MBULIMIT UNIVERSAL SHËNDETËSOR

Ndërhyrja e fundit në Mbrojtjen Parësore Shëndetësore në Maqedoninë e Veriut, e mbështetur nga OBSH-ja, tani u mundëson mjekëve të përgjithshëm të diagnostikojnë dhe të përshkruajnë terapi të cilën deri tani e jepnin vetëm mjekët specialistë, duke i reduktuar kështu udhëzimet për te mjekët specialistë. Kjo reformë, së bashku me programet e trajnimit, synon të rrisë efikasitetin dhe qasshmërinë në mbrojtjen parësore shëndetësore. Është një hap i rëndësishëm drejt ndërhyrjeve të bazuara në dëshmi dhe standardeve bazë të cilësisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ne gjithashtu i japim përparësi sigurisë së pacientëve dhe cilësisë së kujdesit, gjë që dëshmohej nga përfundimi i Planit gjithëpërfshirës Kombëtar për Sigurinë e Pacientëve në korrik të vitit 2023, me qëllim të rritjes së sigurisë së pacientëve në mbarë vendin. Trajnimet e mëvonshme për ngritjen e kapaciteteve të ofruara nga OBSH-ja u ofrojnë profesionistëve dhe menaxherëve të kujdesit shëndetësor njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të forcuar praktikën e sigurisë së pacientëve në Maqedoninë e Veriut.



Forumi Kombëtar i Shëndetit 2023.

SHËNDETI MENDOR DHE SIGURIA E PACIENTIT

OBSH-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbi 40 palë të interesuara, kanë zhvilluar një Plan gjithëpërfshirës Kombëtar të Veprimit për Sigurinë Shëndetësore që shtrihet në periudhën 2024-2025, duke integruar vlerësimet e mëparshme të rrezikut dhe duke miratuar qasjen "Një Shëndet". Tani kemi një përgjigje të koordinuar emergjente ndaj kërcënimeve shëndetësore. Është krijuar Plan i Përgatitjes, Gatishmërisë, Reagimit dhe Rimëkëmbjes për pandemitë e shkaktuara nga patogjenët e frymëmarrjes, me fokus në prioritizimin e patogjenëve brenda kornizës së Përgatitjes dhe Reagimit ndaj Emergjencave Shëndetësore. Si rezultat i drejtpërdrejtë i punës sonë, në 11 laboratorë të Shëndetit Publik janë zbatuar Planet e Veprimit për Sigurinë Biologjike dhe Mbrojtjen Biologjike, duke ulur kështu rrezikun e infeksioneve të fituara nga laboratorit dhe duke përmirësuar saktësinë diagnostike. Në laboratorët e shëndetit publik ne kemi prezantuar Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Laboratorik, duke përmirësuar gjurmimin e të dhënave në kohë reale dhe menaxhimin e hetimit brenda kornizës së e-Shëndetësisë.



Në 11 laboratorë të shëndetit publik u zbatuan planet e veprimit të sigurisë biologjike dhe mbrojtjes biologjike.

SHËNDET DHE MIRËQENIE MË E MIRË

Është bërë përparim thelbësor në rritjen e aftësive dhe njohurive të punonjësve shëndetësorë dhe të organizatave për mbikëqyrjen e vaksinave, mbulimin dhe menaxhimin e vaksinave, duke përfshirë edhe vaksinat kundër COVID-19. U kryen dy fushata të gjera "derë më derë" për imunizim të mëvonshëm për të përmirësuar qasjen në shërbimet e imunizimit dhe mbulimin e përgjithshëm të vaksinimit. Kjo fushatë u zhvillua në 40 komuna të ndryshme, në mjedise të përziera urbane dhe rurale.

U dhanë mbi 5.000 doza të vaksinave rutinë që nuk janë marrë në kohën e duhur, 2.630 vakcina të gripit sezonal dhe vakcina kundër COVID-19. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë për rëndësinë e imunizimit, u shpërndanë mbi 14.000 broshura nëpër shtëpitë e njerëzve në komunitete.



Fushatat e vaksinimit derë më derë

FAKTE KRYESORE

803

punonjës shëndetësorë u trajnuan për zbatimin e pesë protokolleve klinike për gjendjet më të përhapura që trajtohen me kujdes ambulator, duke përfshirë 623 mjekë të mbrojtjes parësore shëndetësore dhe 179 farmacistë.

562

punonjës të mbrojtjes parësore shëndetësore u trajnuan për të përdorur Udhëzuesin për Ndërhyrje të OBSH-së (mhGAP).

Mbi

45,000

fëmijë dhe adoleshentë përfituan nga forumet në komunitet për shëndetin mendor.

U dhanë mbi

5,000

doza të vaksinave rutinë që nuk janë marrë në kohën e duhur.

2,630

vaksina të gripit sezonal dhe vaksina për KOVID-19.

ÇFARË PUNE BËN OBSH-ja

SHËNDETI MENDOR TE FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT

Bashkëpunimi i OBSH-së me UNICEF-in në Maqedoninë e Veriut ka mundësuar përmirësim të dukshëm të rezultateve të shëndetit mendor te fëmijët dhe adoleshentët në vitin 2023 falë zbatimit të programit tonë të përbashkët. Kjo përpjekje u kurorëzua me përfundimin e Raportit të parë gjithëpërfshirës për Vlerësimin dhe Hartëzimin e shërbimeve të shëndetit mendor në vend, duke i hedhur bazat për një plan strategjik kombëtar multi-sektorial

për të përmirësuar rezultatet e shëndetit mendor. Për më tepër, OBSH-ja organizoi trajnimin dhe mbikëqyrjen e 563 punonjësve të mbrojtjes parësore shëndetësore, e më pas u organizuan një seri forumesh mbarëkombëtare në komunitet për të adresuar problemet më të përhapura të shëndetit mendor me mbështetje nga institucionet komunale.



ANNE JOHANSEN

Përfaqësuese Speciale e OBSH-së në Maqedoninë e Veriut

Leaving no one behind is what drives our work, day in day out.

Është parimi për të mos lënë askënd pas ai që na jep shtytje në punën tonë të përditshme.

Në vitin 2023, kemi mbështetur një sërë aktivitetesh që synojnë forcimin e funksioneve të administrimit dhe qeverisjes së Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kemi ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike për Ministrinë si pjesë e përpjekjeve të saj për të përmirësuar performancën e sistemit shëndetësor, duke përfshirë iniciimin e përpjekjeve për krijimin e sistemit të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në shëndetësi. Në fushën e imunizimit, ne mbështetëm përpjekjet e Ministrisë për të rritur shkallën e përgjithshme të vaksinimit në vitin 2023, si dhe për të rritur numrin e ofruesve të trajnuar të mbrojtjes shëndetësore për të dhënë vaksina. Përveç kësaj, ne ngritëm vetëdijen për rëndësinë e shëndetit mendor dhe të mirëqenies së fëmijëve dhe adoleshentëve në nivel komunal dhe e vendosëm në shërbim të ofruesve të mbrojtjes parësore shëndetësore mjetin origjinal diagnostikues mhGAP të OBSH-së për monitorim dhe ndërhyrje efektive.

Pas kryerjes së një studimi për aspektet e sjelljes, mësuam se shkalla e përdorimit të duhanit dhe nikotinës në vend është në nivele alarmante të larta, gjë që na inkurajoi të përfundonim studimin e analizës së kostos ekonomike të përdorimit të duhanit për ekonominë e vendit. Ndikimi ekonomik i përdorimit të duhanit në Maqedoninë e Veriut është tronditës, duke kushtuar vlerë tonë 38 miliardë denarë në vit, që është ekuivalente me 5,6 për qind të PBB-së sonë në vitin 2019.

Përmes investimit në nëntë veprime të politikave për kontrollin e duhanit nga Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit (KKKD) e OBSH-së, mund të parandalohen pothuajse 12.300 vdekje dhe të shmanget shpenzimi i 131 miliardë denarëve si kosto të mbrojtjes shëndetësore dhe humbje

ekonomike deri në vitin 2038. Për çdo denarë të investuar në nëntë veprimet e politikave për kontrollin e duhanit KKKD të OBSH-së sot, Maqedonia e Veriut do të fitojë 19 denarë në kosto të shmangura dhe humbje ekonomike deri në vitin 2038. Tani jemi duke mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë në forcimin e zbatimit të ligjeve ekzistuese kundër duhanit dhe në iniciimin e masave shtesë për kursimin e parave që shpenzohen për përdorimin e duhanit.

OBSH-ja gjithashtu mbështeti veprime të bashkërenduara për të përmirësuar sigurinë e pacientëve në spitale. Si rezultat i veprimeve tona, punonjësit shëndetësorë dhe administrata e spitaleve tani janë trajnuar për kujdesin ndaj pacientëve me qëllim të përmirësimit të rezultateve të kujdesit shëndetësor. Për më tepër, iniciuam aktivitete për të hedhur themelet e një sistemi të qëndrueshëm shëndetësor që është i përgatitur për situata emergjente, duke krijuar Plane adekuate kombëtare, si dhe standarde mbarëkombëtare për praktikatat laboratorike dhe raportimin. Së bashku, këto përpjekje synojnë të forcojnë infrastrukturën e mbrojtjes shëndetësore, të përmirësojnë kapacitetin e fuqisë punëtore dhe të optimizojnë ofrimin e kujdesit shëndetësor në Maqedoninë e Veriut. Nëpërmjet avokimit strategjik, asistencës teknike dhe konsultimeve gjithëpërfshirëse, puna jonë mbështet transformimin e vazhdueshëm drejt një sistemi modern të mbrojtjes parësore shëndetësore që shërben si gur themel i një sistemi shëndetësor që nuk lë askënd pas.



